

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPTI
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 16.3.2007

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 16.03.2007.GODINE

MARS - MART 2007

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 22 shkurtit 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vendbanim dhe vendqëndrim,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor.
6. Shqyrtimi i informatës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit lidhur me përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë
7. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave,
8. Shqyrtimi i rekomandimit për emërimin e gjyqtarëve dhe
9. Shqyrtimi i Propozim programit të punës së Kuvendit për vitin 2007, si dhe të kalendarit vjetor.
10. Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë për anëtarë të Bordit të Autoritetit Qendror Bankar

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevnog reda,
2. Usvajanje zapisnika Plenarne sednice, od 22. februara 2007 god.,
3. Vreme za parlamentarna pitanja,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o boravištu i prebivalištvu,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o prostornom planiranju,
6. Razmatranje informacije regulatornog autoritete telekomunikacije u vezi sa izborom drugog operatera mobilne telefonije na Kosovu,
7. Razmatranje Predoga odluke Vlade Kosova, o imenovanju članova Samostalnog odbora za razmatranje žalbi,
8. Razmatranje Preporuke o imenovanju sudija,
9. Razmatranje Predloga programa rada Skupštine za 2007. godinu i godišnjeg kalendara,
10. Razmatranje Predloga odluke Vlade za članove Borda centralnog bankarskog autoriteta.

SEANCA PLENARE e 16.03.2007

KRYETARI KOLË BERISHA – Mirë se keni ardhur në seancën e sotme të Kuvendit të Kosovës

Ju njoftoj se në sallë momentalisht janë 83 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet të procedohet me punë. Në pajtim me rregullat 6 dhe 23 të Rregullores së punës Kryesia e Kuvendit i ka përgatitur dhe Kuvendit i ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme plenare. Ndërkohë në pajtim me rregullën 23 Grupi Parlamentar i LDK-së i është drejtuar kryetarit me propozim që në rend të ditës të përfshihet edhe propozim-vendimi i Qeverisë për emërimin e dy anëtarëve të Bordit drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija. Nëse keni rreth rendit të ditës, i keni dy minuta kohë.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit z. kryetar, pikërisht për rendin e ditës e kemi. Me shkrim ju kemi drejtuar juve, pasi ishte koha shumë e shkurtër për t'iu drejtuar Kryesisë dhe ishte për censurimin e postës së deputetëve. Dje organizatana ka dërguar në adresën e deputetëve disa zarfe. Këto zarfe e kishin në mënyrë të qartë vulën dhe emrin e dërguesit. Gjithashtu, në mënyrë të qartë ishin të shënuar emrat e deputetëve të cilëve ju ka destinuar këto zarfe. Në dërgesë ishin shënimet për ART-në gjë e cila është edhe pikë e rendit të ditës së seancës së sotme. Por sekretaria e Kuvendit vendosi që këto materiale të mos arrijnë në duart e deputetëve, por të kthehen mbrapshtë. Pra, sekretaria mori rolin e censorit apo të filtruesit të informatave në të cilat deputetët e kanë të lejuar qasjen. Por nuk është kjo hera e parë që deputetëve u censurohen informatat. E njëjta gjë ndodhi edhe me raportin e KDI-së për punën dhe angazhimin e deputetëve në Kuvendin e Kosovës. Kjo na bën të mendojmë a thua ka pasur edhe raste të tjera të censurës së postës së deputetëve. Shtrohet pyetja: Kë po e mbron sekretaria, në këtë rast deputetët, apo ART-në? Në rastet e tjera a u servohen deputetëve vetëm gjërat e bukura që mendon sekretaria, apo deputetët duhet të kenë qasje në çdo informatë si përfaqësues të popullit. Për këtë rast dëshirojmë që kjo të jetë pikë e rendit të ditës ndoshta edhe deputetët e tjerë kanë mendime të ndryshme apo kanë informata të ndryshme, por gjithsesi, ky gjest ne mendojmë që është një gjest skandaloz që duhet të ndërpritet. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të LDK-së ta arsyetojë propozimin për pikën e rendit të ditës.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar, në njërën prej seancave të mëparshme kjo çështje ka qenë në rend të ditës dhe ne kemi kërkuar të kemi të dhëna shtesë, pasi që një prej anëtarëve të propozuar për bord është kontestuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në emër të konfliktit të interesave. sepse kandidati i propozuar është për deputet të Kuvendit të Kosovës. Në ndërkohë Qeveria e Kosovës e

ka bërë atë propozim, ne e kemi marrë propozimin dhe ju lusim ta radhitni në rend të ditës, ashtu si e kemi kërkuar me shkrim nga ana e Kryesisë së Kuvendit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! E hedh në votim propozimin e z. Gashi.

Votojmë për secilën propozim.

Kush është për propozimin e z. Gashi? Ju faleminderit.

Urdhëroni z. Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Z. kryetar, çdo respekt për propozimin, unë nuk e di për çka po bëhet fjalë dhe mendoj që në qoftë se është diçka e ngutshme për t'u futur në rendin e ditës, ne duhet ta fusim në rend të ditës, në debat, të diskutojmë rreth asaj çështjeje dhe jo pse propozoi kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së tash ta hedhim në votë menjëherë. Unë nuk po e di për veti për çka po bëhet fjalë dhe kjo nuk është vendosur në mbledhjen e Kryesisë. Ne kemi pasur edhe pardje mbledhje të Kryesisë dhe kemi mundur me diskutuar dhe me vendosur në rend të ditës. Mua nuk po më duket si çështje e ngutshme propozimi që po e bën Grupi Parlamentar i LDK-së, ose po e hapim debatin rreth kësaj, se çka është ky problem, pse po na ngutet, ose si është problemi.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI - Normalisht do të ma merrte mendja se kur nuk do të kishte nevojë të jepen shpjegime për këto punë, por meqë po lypen, atëherë duhet të jepen. Kjo materie ka qenë në një rend dite të një seance te ne, i ka kaluar gjitha procedurat e kryesisë dhe ato parlamentare. Ky Parlament për arsytet që i ka diskutuar në seancën plenare ka thënë që duhet të rimerren, meqë z. Haliti e përmend Kryesinë dhe mban në mend edhe në Kryesi unë e kam shtruar këtë çështje, sepse kam thënë se na është thënë që është çështje e ngutshme. Kanë kaluar dy javë të gjitha procedurat i ka kaluar edhe me Ligjin në fuqi me Rregulloren e Parlamentit, me shkrim është kërkuar për sot. Çdo gjë është në rregull në kuadrin e rregullave parlamentare që kemi votuar ne. Unë mendoj që nuk ka arsye që të përzihet kjo çështje me çështje që do të shtrohen dhe do të diskutohen. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Urdhëroni z. Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, z. kryeministër, të nderuar deputetë. Unë nuk kam problem as me propozimin dhe as me emrat konkretë, por duhet thënë pak fjalë për bordet dhe për ndarjen e pushteteve në Kosovë, që nuk është duke funksionuar. Në rend të parë këtu kemi deputetë që punojnë në ekzekutivin e Kosovës dhe ata që janë ekzekutiv s'mund të jenë edhe legjislativ. Këtu ka deputetë që janë anëtarë të bordeve të ndryshme të agjencive të pavarura në Qeverinë e Kosovës dhe është konflikt interesi dhe nuk mund ta ushtrojnë detyrën e deputetit dhe të anëtarit të bordeve ekzekutive. Këtu ka deputetë që janë propozuar dhe janë edhe anëtarë të bordeve në ndërmarrjet publike si në Postë, në KEK, në Aeroport dhe në bordet e tjera të ndërmarrjeve publike dhe përsëri është ndeshje pse ata janë pjesë edhe legjislativit edhe ekzekutivit. Çka është edhe më

keq, këto borde duhet të jenë të pavarura duhet të jenë anëtarët e këtyre bordeve njerëz profesionistë, njerëz që nuk janë të implikuar dhe anëtarë të kryesive politike, apo këshilltarë politikë të presidentit, të kryeministrit dhe të ministrave dhe kështu si po veprohet vërtet ne po tregojmë se nuk jemi të pjekur për t'i drejtuar institucionet dhe nuk jemi të pjekur dhe nuk dëshirojmë ta kuptojmë rolin e legjislativit dhe të ekzekutivit.

Ju lutem të nderuar deputetë pushtetet janë të ndara në shoqërinë demokratike që në shekullin e 18-të. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Urdhëro z. Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Z. kryetar, kryeministër, ministra, të nderuar deputetë. Mendoj se duhet të ndalemi dhe hollësisht të diskutojmë për mënyrën e punës së Kuvendit. Kryetari i Kuvendit po e udhëheq seancën në mënyrë jo të duhur sipas Rregullores së punës. Në qoftë se kryetari i Kuvendit me rastin e hapjes së mbledhjes thotë që kemi një propozim me shkrim për ndryshim të rendit të ditës dhe nuk e përmend edhe dy propozime të tjera që i ka në radhë ,që i ka në letra aty përpara në tavolinën e tij, ku figurojnë edhe dy propozime të tjera për ndryshim të rendit të ditës dhe pastaj e ndan fjalën sa te njeri, sa te tjetri propozues pa e pasur të qartë Kuvendi pse për çka po bëhet fjalë, mendoj se kjo mënyrë e udhëheqje së mbledhjes është skandaloze. Pra duhet të rreshtohen të tria propozimet, apo të katra, apo të pestat ,sa janë për ndryshim të rendit të ditës, të fillohet debati për pikën e parë të votohet pika e parë, kalon, s'kalon. Kalojmë në pikën e dytë, në kërkesën e dytë për ndryshim të rendit të ditës, Hapet debati, mbyllet debati, votojmë, kalon, s'kalon.

Zoti kryetar, kjo mënyrë e punës është mënyrë që lë hije shumë të keqe para qytetarëve të Kosovës, sepse këta kur ne vijmë në konfuzion ata vijnë dy herë në konfuzion më shumë se ne. Prandaj, të lutem shumë, duhet të tregohen të gjitha pikat të cilat janë kërkesa për t'u zgjeruar rendi i ditës, pastaj të fillohet një nga një ashtu si të kanë ardhur ty me protokoll, ashtu të fillohet debati për to. Dhe jo kështu të kalomë prej pikës që ka kërkuar Grupi ORA te pika që ka kërkuar i Grupi i LDK-së, mendoj që kjo mënyrë e punës askund nuk na çon, shkojmë një për një i diskutojmë një për një, e marrim vendim një për një dhe vazhdojmë mënyrën e punës sipas rendit që e miratojmë këtu. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Unë mendoj se pikërisht e kam zbatuar Rregulloren, E kam parashtruar pikën e parë të rendit të ditës, propozimin e parë që është dhënë nga Grupi Parlamentar i LDK-së ju lutem do ta marrësh fjalën edhe ti, tash po flasë unë edhe një herë.

Unë do të jap përgjigje për atë që kërkohet këtu. Për pikën e parë kemi votuar. Është një kërkesë e Grupit ORA që paraqet kërkesën për futjen në rend të ditës.

Ndalimi i vaksinave në kufi

Urdhëroni. Lus përfaqësuesin e kësaj kërkesë ta merr fjalën.

Ju lutem uluni Gani, kur të vjen radha do ta merrni fjalën.

Urdhëroni përfaqësuesi i ORA-së.

FATMIRE MULHAXHA- KOLLÇAKU – Ju faleminderit z. kryetar, z. kryeministër, Kabinet qeveritar, ju kolegë të nderuar.

Grupi Parlamentar ORA dëshiron të shprehë shqetësim lidhur me ndalimin e vaksinave në kufi. Të kontingjenteve dhe njërit kontingjent dhe të tjerave që do të arrijnë. T'ju përkujtoj se vaksinimi i obliguar i fëmijëve kundër sëmundjeve ngjitëse, vaksinë parandaluese, është e drejtë elementare e secilit fëmijë për fillimin e shëndetshëm të jetës me reduktimin dhe e vdekshmërisë së fëmijëve. Problemi qëndron në atë. Ne jemi gëzuar që dje kemi parë që shumë produkte bujqësore janë liruar nga doganat, por kemi pritur që ta shohim atë edhe për vaksina. Këtu po e shprehi njëkohësisht edhe shqetësimin e gjithë ekspertëve të shëndetësisë publike. Problemi me vaksina është prej qershorit të vitit të kaluar kur është futur dogana për vaksina dhe në vazhdimësi kemi ndalesën dhe me tek me telefonata po lëshohen kontingjentet e vaksinave që të hyjnë në Kosovë. Në qoftë se në vitin e kaluar Ministria e Shëndetësisë nuk e ka pas të paraparë buxhetin, sepse nuk e ka ditur që do të doganohen, besoj për këtë vit buxheti është dashur të jetë i paraparë dhe ose të merret vendimi i Qeverisë që të lirohen plotësisht nga doganat vaksinat, ose me kohë të sigurohen mjetet të mos vijnë në situatë që të rrezikojmë në bazë të parashikimeve të ekspertëve të shëndetësisë publike, meqenëse fruthin e kemi morbinin e kemi në Evropë, të mos rrezikojmë që ta marrë dikush në përgjegjësi nga Qeveria për paraqitjen e ndonjë epidemie me të cilën mund të ballafaqohet Kosova.

Ju lutem këto janë jo vetëm shqetësimet e Grupit Parlamentar ORA, por këtu po e ngre zërin në emër të gjithë ekspertëve të shëndetësisë publike dhe të ekspertëve të Instituti Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Prandaj, i mbetet Qeverisë që të na japë përgjigje se a ka një strategji me të cilën do ta zgjidhë një herë përgjithmonë këtë problem, së paku për këtë situatë ku Kosova, do të thotë e dimë se sa janë mundësitë për shërimin e pasojave të këtyre sëmundjeve, prandaj, besoj që është shumë ma mirë që t'i parandalojmë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! E hedh në votim propozimin, a do të jetë si pikë e rendit të ditës apo jo?.

E hedh në votim propozimin rreth ndalimit të vaksinës në kufi. Ju lutem, dua ta lexoj kërkesën.

Sipas Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës, pika 23.2 kërkojmë që në seancën plenare të 16.3.2007 të përfshihet në rend dite kjo çështje urgjente, d.m.th. me shkresë kërkon që të futet në rend dite, kurse tash del një koment.

T'i propozoj që të futet në rend dite apo! Ju lutem e hodhi në votim kërkesën. Urdhëro Alush

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar, çështja e ngritur është çështje shumë e rëndësishme. Mënyra për trajtimin e kësaj çështjeje është e paraparë me Rregullore. Nëse kjo çështje kërkohe të trajtohet mënyra si u shtrua sot kjo i takon mënyrës së

pyetjeve parlamentare. Nëse kjo çështje kërkohet trajtohet në seancë plenare si pikë e posaçme e rendit të ditës. Ne e mbështesim dhe e kërkujmë që të na jepet kohë me u përgatitur në mënyrë që ne të kontribuojmë për te që Ministria e Shëndetësisë të përgatitë raport del me propozime vizione. Kështu që si shqetësim ne e mbështesim, por si mënyrë të qasjes mendoj se shkresa dallon prej asaj çka u ngritë sot. Nëse kërkohet që të jetë në rend dite ju lutem të na jepet kohë që ne të përgatitemi si deputetë, dhe Ministria e Shëndetësisë del me raport për këtë çështje.

Prandaj, sot nuk e shohë që mund të zgjidhet kjo çështje në mënyrë se si u dha më tepër të një fushate.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Gani Koci e ka fjalën.

DEPUTETI GANI KOCI – Kërkoj falje prej kryeministrit, por ky e lëshoi lehtë vendin aty dhe kështu është e pa bazë kjo Qeveri, prandaj duhet me menduar edhe për këtë çështje pak. Unë nuk kisha vërejtje në propozimin e deputetit z. Alush Gashi, absolutisht. Krejt vërejtjet e mia qëndronin në punën dhe përgjegjësitë e administratës në dy njerëzit tuaj që i keni në anën e djathtë z. kryetar, prandaj faji dhe gabimi është i tyre dhe meqë është kështu, unë propozoj dhe dëshiroj që ky propozim imi të votohet këtu, që këtë seancë të mos e udhëheqë sot kryetari i Kuvendit Kolë Berisha bashkë me dy që i ka në anën e djathtë le ta marrë kush të dojë ,por këta dy sot të mos e udhëheqin se e kanë nisur mbrapshtë këtë çështje.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Unë e hodha në votim propozimin e z. Koci; Kush është për që Kolë Berisha të mos udhëheqë sot seancën e Kuvendit të Kosovës bashkë me dy, ju faleminderit, kush është kundër?.

Gani më fal, do ta kam kënaqësinë të punojmë bashkë edhe për shumë kohë.

E kemi propozimin e ORA që të futet si pikë e rendit të ditës urgjente.

E hedh në votim: Kush është për; Kush është kundër, ju faleminderit, konstatoj se me shumë votash nuk hyn në rend të ditës kjo çështje.

Rreth fjalës së z. Jashari, unë kam plotësisht mirëkuptim rreth asaj, ka të drejt, sepse çdo letër që hyn në Kuvend do të pranohet dhe shpërndahet sipas procedurës. Ju them se është bërë gabim atë ditë që nuk është pranuar ai material, por paska qenë një praktikë më herët për shkak të letrave që kanë ardhur të natyrave të ndryshme të ndalet kjo praktikë dhe kështu ka vepruar administrata. Ju them se tash e tutje çdo letër që vjen në Parlament do të shpërndahet dhe do të udhëzohet sipas procedurës. Deputetja Nekibe Kelmendi e ka fjalën.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Unë kundërshtoj që të na futen letrat në kutia pa kaluar Table Office dhe të kontrollohen atje se çfarë letra janë, çka përmbajnë ato, mos ka farë elementi që na rrezikon neve deputetët. Me hy letra prej jashtmit brenda menjëherë në kuti me ta dërguar qytetari ose në një organizatë tjetër pa kaluar nëpër Table Office nuk është e pranueshme.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Pajtohemi për këtë.

DEPUTETI NEXHAT DACI – Z. kryetar, kaluan gati një orë dhe po kalohet prej një çështje në tjetrën pa dhënë përgjigje për asnjërën nga pyetjet e shtruara. Esenca është e dy çështjeve të shtruara kryesore sot, ajo teknike e profesor Alush Gashit dhe e sqaruar mirë nga profesor Hamiti dhe përmbajtjesore në të cilën në një pjesë të fjalës se shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së preku çështje shumë thelbësore. Çështja që nuk përkon në realitetin është në fjalën e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së se nuk është as praktikë unike askund, që ministri nuk mund të jetë deputet, ai i përgjithësoi pa fakte dhe pa të drejtë, por është shumë substanciale dhe shumë më e rëndësishme ajo që tha konflikti interesave publike në bordet e ndërmarrjeve publike dhe gjithkund.

Krejt opinionin në Kosovë është i interesuar që ndërmarrjet publike të kthehen në një fondament në ndihmë të ekonomisë së Kosovës dhe të shoqërisë kosovare. Mënyra se si po procedojmë këto vite nuk e mundëson realizimin e këtij qëllimi. Nuk e mundëson, prandaj është mirë që ky Kuvend dhe institucionet një herë e përgjithmonë t’ju japin prioritet profesionistëve në bordet të cilët duhet..... Prandaj është në interes kësaj radhe aq sa kam informacione unë, në qoftë se Kuvendi nuk procedon me bordin e Bankës Qendrore, atëherë u merret kompetenca e organeve qeverisëse të Kosovës dhe kalon në një instancë të emërimit të Përfaqësuesit Special. Në qoftë se prolongimi është bërë pa arsye le të lypet përgjegjësia tjetërkund, prandaj, të jeni specifik dhe propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së që ishte i prof. Gashit, fillojë në procedim dhe ju nuk e përfunduat procedurën, kur të hyni në procedurë të vendimmarrjes duhet të përfundojë ajo e pastaj të kalojë në pikën tjetër.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Ne e kemi votuar atë pikë të rendit të ditës dhe vonesa prej një ore nuk është në fajin tim, por është në kërkesat e deputetëve që të paraqesin vazhdimisht. Urdhëroni z. Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Unë e di që ministrat e Qeverisë së Kosovës kanë të drejtë ta ruajnë edhe detyrën e deputetit, por jo zyrtarë të administratës publike në ministri të jenë edhe punëtorët e Ministrisë edhe të Parlamentit, edhe vlen edhe ajo që thashë për gjitha bordet pa marrë parasysh a janë borde të agjencive të pavarura të Qeverisë, apo të ndërmarrjeve publike. Prezenca ose pjesëmarrja e deputetëve në ato borde është konflikt interesi dhe nuk e ndan pushtetin ekzekutiv nga ai legjislativ. Dhe një herë po them se pushteti ekzekutiv nga legjislativ është i ndarë në shekullin 18-të, ka vazhduar në shekullin 19-të, dhe 20 dhe ne jemi në shekullin 21 Deputetët nuk mund të jenë anëtarë të bordeve mbikëqyrëse as të ekzekutivit as të ndërmarrjeve publike, deputetët nuk mund të jenë drejtorë në ministritë e Qeverisë së Kosovës. Është konflikt interesi kjo. Këto thjeshtë janë ngatërresa të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ dhe prandaj pushtetet janë të ndara z. kryetar, kjo të vlen edhe për ish kryetarin e parlamentit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Pika e dytë e rendit të ditës. Nuk keni paraqitur kërkesat me shkrim, urdhëroni z. Kuçi.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – Ju faleminderit z. kryetar. Unë i kam dy propozime. I pari mendoj që në rend të ditës nuk është e thënë të hyjë sot. Por në një ditë, apo në një seancë të ardhshme, të hyjë në rend të ditës se flas në emër të PDK-së. Çështja e përbërjes së bordeve duhet të hyjë një ditë në një seancë të rendit të ditës që është e përbërë e bordeve të gjithave agjencive në Kosovë. Pastaj shikojmë, strukturën, konfliktin e interesave, konfliktin ligjor etj. Propozimi i dytë derisa Ganiu tha që ka probleme me ju dhe me anën e djathtë, unë kam problem me anën e majtë, propozoj që profesori Sabri të largohet nga kjo seancë po më duket që ka influencë në menaxhimin e Kuvendit. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Urdhëroni profesor Sabri.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Mua nuk më është tue më pëlqyer aspak ky fillim i kësaj seance. Ka njerëz që këtë pa pëlqim e shprehin me do mënyra të veçanta të sjelljeve, që në një sjellje parlamentare do të merreshin edhe me Rregulloren e Kuvendit tri herë vërejtjet dhe do të kërkojë edhe largimin nga salla me Rregulloren në fuqi të cilën e ka ndërtuar z. Kuçi me ekipin e vet. Unë e pranoj nëse ai mendon që nuk do të duhej të jem aty sot, në të majtë, apo në të djathtë, s'ka problem, ai është vetëm një obligim , por një obligim institucional që më duhet ta kryejë, ndërsa sa për influencën, Kuçi e di mirë kur jam influent shumë ma shpejtë shkojnë puna dhe ai është i bindur po aq sa unë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Z. Kuçi replikë po.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – Unë besoj se të gjithë ne e dimë që profesori Sabri ka probleme me qenë i dyti, kështu që zakonisht ka dëshirë edhe siguria e ndikimit të tij kur e sheh që punët nuk shkojnë mirë, ka dëshirë me influencë po vërehet edhe nga ne z. profesor, kështu që kisha pas dëshirë ose me udhëheq ose me u largua prej aty. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Urdhëroni z. Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Asgjë nuk do të them z., Kuçi, unë besoj që u portreteve. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Deputetja Gjylnaze Sylja e ka fjalën.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit. I nderuari z. kryetar z. kryeministër, ministra, deputetë të nderuar. Zoti kryetar ne ju lusim që t'ia fillojmë punës ashtu si janë rregullat. Së pari rendi i ditës dihet si është caktuar. E dyta secili deputetë mund të diskutojë për rendin e ditës dy minuta. E treta është, shumica e diskutimeve nuk ishin të befshin aspak me çështjen gjegjësisht rendin e ditës. Prandaj, ju lutem, për hir të

mbarëvajtjes së punës së Kuvendit të vazhdojmë ashtu si u miratua rendi i ditës. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Prandaj vazhdojmë me rendin e ditës. Pika e dytë e rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga seanca plenare e mbajtur më 22 shkurt 2007. A ka vërejtje rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar. Urdhëro dy minuta.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAI – Është shumë e paqartë. Unë mendoj se bile këto subjektet që e kanë origjinën prej këtij Grupit të Unitetit duhet me ditë që ende kanë nevojë për unitet. Së paku Grupi i Kontaktit që është atje duhet me ua shpjeguar këtë. Shihe z. kryetar, 25 nënshkrime ju kanë drejtuar Kuvendit të Kosovës prej deputetëve më 22.2.2007 në të cilën kërkohet që në seancën e ardhshme plenare të debatohet për ngjarjet e 10 shkurtit në Prishtinë, në të cilën janë vlarë dy qytetarë. Unë për këtë dua sqarim, për këtë: Pse nuk është hyrë në rend të punës; dhe mbi të gjitha, dhe pse nuk sqaroni, çfarë kërkesa kanë ardhur në Kuvendin e Kosovës dhe këto kërkesa thuhet, ushqyer për këtë, u hodh poshtë për këtë, nuk debatohet për këtë. Na i ka ndaluar dikush, ose i kemi ndaluar ne vetë. Domethënë kjo është shumë e paqartë dhe nuk ka kuptim, kështu që në formë të paqartë të ecet. Mos harroni nuk jemi ne këtu vetëm, gjithë janë tu parë bota, si është tu u zhvilluar ngjarjet, ju lutemi si mundet kjo me kaluar kësi soji, si është e mundur zotëri të nderuar: Para 17 vjet Lëvizja Popullore e Kosovës organizatori i protestave 80-90 ka kërkuar heqjen e do funksionarëve të policisë që sot përsëri janë në krye të policisë, si është kjo e mundur me vazhduar kështu. Për këtë jemi duke kërkuar dhe ka nevojë kjo pikë dhe është e nevojshme shumë kjo pikë dhe ju lutem shumë a të hynë në rendin e punës apo jo dhe të sqarohet hollësisht kjo punë. Nuk mundet me kaluar kjo punë në këtë formë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Edhe unë e kam sqarimin për këtë. Është marrë në qëndrim që të futet në rend të ditës, po ta kemi një dokument, sot e kemi, po të tregoj ty dhe të tjerëve se sot e kemi marrë materialin nga Ministria. Kjo do të mbetet për seancën e ardhshme, sot nuk ka mundësi të diskutohet, sepse sot e kemi marrë materialin, prandaj vazhdojmë pikat tjera të rendit të ditës.

Ju lutem dy orë gati po shkojmë për rendin e ditës, vazhdojmë me rendin e ditës. Urdhëroni z. Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar ministra, kolegë deputetë. Kryesia e Kuvendit të Kosovës, kryetari i Kuvendit të Kosovës është i informuar me shkrim me datën 6.03.2007 me numër të protokollit 2023083 se Lidhja Demokratike Dardanisë ka formuar Grupin Parlamentar, andaj është e obliguar që këtë ta vejë në rendin e ditës, dhe në harmoni dhe në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren e punës së Kuvendit të Kosovës t'i informojë deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe ta trajtojë në harmoni me këtë rregullore në tërë punën e Kuvendit. Ju faleminderit

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Kërkesën e kemi marrë dhe jemi në pritje të komentimit nga ana e OSBE-së. Shkojmë më tutje.

A ka vërejtje në procesverbalin nga mbledhja 22 shkurt 2007. Urdhëro Gjergj Dedaj

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Kam vërejtje, i nderuari shumë i nderuari z. kryetar, kryeministër, ministra deputetë, shyqyr që jeni ju këtu mysafirë se ishit bërë përrallë me tupan. Domethënë kam vërejtje se nuk po na jep fjalën kur kemi të drejtë me diskutuar për rendin e ditës nga dy minuta. Vetëm atyre që po jua marrin dhunshëm po ua jep fjalën, ndërsa ne që po tregohemi liberalë dhe më korrektë asnjëherë nuk po na jep fjalën, domethënë kjo mënyrë e udhëheqjes së Kuvendit nuk ju bën nder juve z. kryetar se keni pasur çka të flas. Nëse vazhdon kështu, atëherë nuk e ndiej veten mirë këtu, prandaj duhet me lëshuar seancën, jo që bëhet nami nuk dua me dalë me bë telashe atje, por është e ndershme nëse një deputeti i jepet fjala dy minuta dhe nëse me Rregullore është obligative për rendin e ditës çdo deputeti nga dy minuta nuk mund t'i diskriminoni deputetët në bazë të shushuritjeve në vesh, ose në bazë të atyre kualifikimeve e diskriminimeve. Çka bëni atje renditjen që e bëni në kryesinë e punës? Le të jetë hera e fundit kjo z. kryetar. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! A ka vërejtje për procesverbal? Nuk ka.

Pika e tretë e rendit të ditës.

3. Koha për pyetje parlamentare, konstatime hyrëse .

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 26.1 të Rregullores së punës së Kuvendit koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë e Kosovës është e kufizuar në 50 minuta. Në afatin e përcaktuar me Rregullore janë parashtruar edhe 12 pyetje parlamentare. Pyetjet u janë dërguar Qeverisë dhe u janë shpërndarë deputetëve. Shkojmë me radhë. Deputeti Ramadan Kelmendi ka pyetje për kryeministrin Çeku. Pika ka autorizuar ministrin Veliu për përgjigje. Deputeti Kelmendi e keni fjalën, plotësoni pyetjen.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Me respektin më të madh unë e kam parashtruar pyetjen me shpresë se do të marr përgjigje. Është pyetje me interes të përgjithshëm, duke shkurtuar këtë, shtroj vetëm pyetjen.

Çka ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Universitetit të Prishtinës që pranë disa universiteteve të ndalojë dukuritë negative që përsëriten tani prej vitit në vit dhe në veçanti janë të pranishme në disa departamente të këtyre fakulteteve. Fjala është për mos mbajtjen e ligjëratave të rregullta nga disa profesorë, për një semestër të tërë, fjala është në psikologji, sociologji etj etj. I kam emrat dhe mbiemrat.

2. Shtyrja e afateve të provimeve me muaj të tërë dhe thirrja e mbajtja e provimeve në kabinete dhe problemi i Fakultetit Teknik në Mitrovicë për miton, që është e informuar Drejtoria e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit dhe

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Ftoj ministrin Veliu ta marrë fjalën.

MINISTRI AGIM VELIU- I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuar kryeministër, të nderuar deputetë, të nderuar ministra.

Për mos mbajtjen e ligjëratave me rregull dhe shtyrjen e afatit të provimeve pa arsye në MASHT nuk është paraqitur as njoftim. Nuk ka pasur asnjë kërkesë apo ankesë që Ministria e Arsimit Shkencave dhe Teknologjisë përmes inspeksionit të bëjë konstatimin e gjendjes faktike siç e obligon ligji për inspeksionin e arsimit. Tani sipas njoftimeve të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, ka raste të mos mbajtjes të ligjëratave, ose provimeve sipas orarit të përcaktuar, që është pasojë e gjendjes së trashëguar. Udhëheqja e Universitetit të Prishtinës është duke punuar në vazhdimësi për vënien e rregullit dhe të ligjit në të vetmin institucion të publik të arsimit të lartë për çka janë ndërmarrë edhe masa kohëve të fundit. Por, nuk mund të flitet për masa parandaluese deri sa nuk vërtetohen apo nuk konstatohen fakte në bazë të cilave duhet të jepen rekomandime. Për lëshimet eventuale të kësaj natyre studentët duhet t'i drejtohen dekanatit të fakultetit përkatës, Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, por edhe Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka planin e punës dhe dinamikën dhe natyrshëm që mangësitë e evidentuara do të evitohen në bashkëpunim me rektoratin. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Z. Kelmendi keni pyetje shtesë. Ramadan Kelmendi e ka fjalën.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Dëshmitë janë në fakultet. Rektorit të Universitetit, drejtorit antikorrupsion dhe Ministrisë të Arsimit të Shkencës dhe Teknologjisë dhe kryetarit të Komisionit për arsim pranë Kuvendit të Kosovës, i kanë dëshmitë , i kam edhe unë kur doni i vërtetojmë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Deputeti Kamber Kamberi ka pyetje për kryeministrin Çeku. Urdhëroni zotëri.

DEPUTETI KAMBER KAMBERI – Ju faleminderit z. kryetar. Unë kam një pyetje për kryeministrin e Kosovës. Duke pasur parasysh rëndësinë e pyetjes që do ta parashtroj para kryeministrit, meqenëse kemi të bëjmë me një çështje mjaftë të rëndësishme ,siç është realizimi i projektit të Hidrosistemit të Morinës, ose të Konushecit, për çka është fjala edhe në komunën e Gjakovës, për çka edhe ekziston projekti tash e 30 vjet.

Konsideroj se është një projekt mjaft i rëndësishëm, sepse në realizimin e këtij projekti do të furnizoheshin me ujë të pijes rreth 200.000 banorë deri në komunën e Prizrenit dhe do të ujiteshin mbi 13.000 hektarë tokë pune, çka do të plotësoheshin edhe nevojat tjera të bujqësisë dhe blegtorisë. Gjithashtu për tu shfrytëzuar potencialin energjetik që krijohet nga rrënja e ujit të këtij hidrosistemi, mund të ndërtohen edhe dy mini-

hidrocentrale çka do të furnizonin me energji elektrike një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së komunës së Gjakovës. Prandaj, pyetja për ju z. kryeministër është: A ekziston në qeverinë tuaj, nëse po, a është diskutuar ndonjë herë mundësia e realizimit të këtij projekti. Me sa jam në dijeni në komunën e Gjakovës ka qenë ky projekt ndër projektet parësore ,ndërsa për realizimin e këtij projekti ka qenë të interesuar edhe nga shteti zviceran dhe gjerman. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! z. Kryeministër urdhëroni.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Ju faleminderit për pyetjen: Po, projekti ekziston, është projekti në ministrinë e mjedisit planifikimit hapësinor, projekti për hidrosistemin e Konushecit, është një projekt shumë i dobishëm për Kosovën në tërësi por sidomos në pjesën rurale të komunës së Gjakovës, edhe të Deçanit. Projekti është i kushtueshëm, buxheti i Qeverisë apo i Ministrisë të Planifikimit Hapësinor nuk mund ta përballojë, ministri dhe Qeveria janë në kërkim të donatorëve të ndryshëm në kontakt me donatorët e ndryshëm. Nga projekti që kemi dallojnë disa shifra që i thatë. Projektin që e kemi ne në dispozicion qeveri është vërtetë dobishëm. Tash do të furnizohen me ujë, 120 mijë banorë dhe do të siguroj 175 litra ujë në ditë për kokë të banorit ky projekt, me një volum prej 40 milion metra kub, kështu që do të ujiten 8500 hektarë tokë, do të ndikojë pozitivisht në parametrat e mjedisit në përmirësimin e akukulturës në lumin Ibër ka shumë përparësi por Kosta e këtij projekti është 14.5 milion euro dhe është një shumë vërtetë që nuk mundemi ta përballojmë sot. Por si projekt ka hyrë në master planin e ujërave të Kosovës plan që është pjesë përbërëse i planit zhvillimor të Kosovës dhe i cili do të prezantohet në Konferencën e Donatorëve, nuk besoj, ne nuk do të heqim dorë nga ky projekt. Projekti është i dobishëm dhe ta shtyjme këtë projekt. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Ka pyetje plotësuese.

DEPUTETI KAMBER KAMBERI – Ju faleminderit z. kryeministër, unë një pjesë të këtij projekti e kam këtu. Nuk është aq e rëndësishme sepse mund të ndryshojnë edhe shifrat, është me rëndësi projekti të realizohet. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit!deputetja Safete Hadërgjonaj ka pyetje për kryeministrin Çeku.

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – Ju faleminderit z. kryetar. Çështja që më ka shtyrë të bëjë këtë pyetje është se në programin e Qeverisë 2004/2008 thuhet se Qeveria do të iniciojë që gjatë vitit 2005 të nxirret plani strategjik i zhvillimit ekonomik të Kosovës, i mbështetur në planet strategjike sektoriale. Ditë më parë Qeveria ka shqyrtuar një projektplan strategjik. Pyetja ime është: Kur ky projektplan do të vijë në Parlament? Sa është kostoja e këtij projektplani dhe cilat janë burimet e financimit të këtij projekti?

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Z. kryeministër ,urdhëroni e keni fjalën.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Po disa herë e kemi përmendur edhe këtu në parlament, që ne vërtetë jemi duke hartuar strategjinë e planit zhvillimor të Kosovës 2007/2013 . Ky hartim ka filluar që nga viti 2005 është e vërtetë, dhe në fund të vitit 2006 ka përfunduar drafti i parë i kësaj strategjie. Në këtë strategji ka qenë bartës, ka qenë Qeveria e Kosovës, ka pasur kontraktor “Riinvestin” dhe ka pas shumë donatorë dhe organizata tjera të involvuar në këtë, si USAID-i, DIFID-i, SIDA Suedeze, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, shoqëria civile , Organizatat joqeveritare etj. kështu që ka qenë një projekt gjithëpërfshirës(inkluziv) dhe ka rezultuar me një draft të cilin ne e kemi aprovuar. Në fund të këtij viti ka përfunduar edhe mandati i sekretariatit dhe gjitha këtyre strukturave që kanë punuar në këtë projekt, dhe projekti ka kaluar në Qeveri konkretisht në Ministrinë e Financave Departamentin e makro-ekonomik.

Këtu tani dokumenti është duke u harmonizuar me kornizën afatmesme të shpenzimeve, dhe janë duke privatizuar sektorët dhe duke u përcaktuar prioritet brenda çdo sektori. Pritet që ky dokument të jemi të gatshëm që ta prezantojmë në Konferencën e Donatorëve,në Konferencën Ndërkombëtare të Donatorëve që do të mbahet menjëherë pas statusit në Bruksel, dhe do t’i prezantojmë të gjitha këto projekte. Në muajin prill do të finalizohet, menjëherë në Qeveri, dhe do ta sjellim menjëherë pas qeverie do ta sjellim këtu në parlament. Ne do të shohim që të jemi të gatshëm që në qershor ky projekt të jetë final i aprovuar edhe nga parlamenti dhe të jemi të autorizuar që ta prezantojmë në konferencën e donatorëve.

Këtë projekt e kanë financuar; Qeveria e Kosovës, dhe donatorët. Nga Qeveria e Kosovës janë shpenzuar 256100 euro, kurse donatorët në tërësi kanë shpenzuar 813600 euro, kështu që deri më tash ne këtë projekt janë shpenzuar 1.69700 euro, kryesisht thash pjesa më e madhe nga donatorët, donatorët janë: SIDA Suedeze, DIFID-i Banka Botërore. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! deputetja Hadërgjonaj a keni ndonjë pyetje shtesë pyetje plotësuese. Fjalën e ka deputetja Hadërgjonaj.

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – Ju faleminderit për këtë përgjigje z. kryeministër. Unë kam një pyetje plotësuese: A mund të kemi ne si deputetë një raport të hollësishëm të shpenzimeve të cilat janë bërë për këtë projektplan strategjik dhe kur mund ta kemi në dispozicion ne deputetët e Parlamentit të Kosovës.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Po pa tjetër, pa dyshim ,do ta sjellim, sa më shpejtë, unë qysh sot kur të kthehem do të urdhërojë zyrën time që ta përgatisin raport dhe ta përcjellin këtu te ju.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Deputetja Sala Berisha Shala ka pyetje për kryeministrin Çeku.

DEPUTETJA SALA BERISHA SHALA – Ju faleminderit z. kryetar. Çështja që më ka shtyrë t’i shtroj pyetje kryeministrit; çështja se privatizimi i ndërmarrjeve me spinof special shihet se po ka pa rregullsi në zbatimin e marrëveshjeve dhe kontratave. Edhe Feronikeli është privatizuar përmes procedurës së spinofit special. Sipas kushteve të marrëveshjes ofertuesi përveç zotimeve në investime ka qenë i obliguar të garantojë punësimin e 1000 punëtorëve edhe fillimin e prodhimit në Kosovë në një periudhë të caktuar kohore. Meqë në bordin e AKM-së janë disa ministra nga kabinet i juaj qeveritar shtroj këtë pyetje.

A jeni të informuar sa janë duke u përfillur këto kushte të marrëveshjes në mes ALFERONIT dhe AKM-së?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Urdhëroni z. kryeministër.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Po jam i informuar, edhe nga AKM-ja, edhe nga ministrat që janë në bordin e AKM-së. Siç e dini Njuko Feronikeli ka nënshkruar kontratën me AKM-në me 20.12.2005, kjo kontratë ka hyrë në fuqi me 20 prill të vitit 2006. Sipas kësaj kontrate obligimet kanë qenë të Njuko Feronikelit ,domethënë, pronarit të ri të Feronikelit kanë qenë që dy vitet e para të investojë 20 milion euro, që fillimisht t’i punësojë 250 punëtorë, pas 6 muajve 500 punëtorë dhe pas një viti 1000 punëtorë, dhe këta punëtorë ti mbajë së paku në punë edhe një vit.

Sipas informacioneve të 31.12.2006 deri me atë ditë Feronikeli NJUKO i ka investuar 18.5 milion euro qysh në vitin e parë gati të gjitha shumën e ka investuar, i ka punësuar 450 punëtorë të përhershëm dhe 400 të tjerë me kontratë, kështu që 1000 punëtorë duhet t’i ketë deri me 20 prill.

Informacionet e sotme tregojnë që investimet janë më shumë se 20 milion, domethënë dy muajt e fundit të para të këtij viti dy muajt e parë ka investuar edhe më shumë dhe e ka përmbytur investimin që e ka pasur të bëjë për dy vjet , e ka bërë për 1 vit. Dhe sipas informacionit që kemi në muajin qershor do të fillojë prodhimi në Feronikel..

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Po kjo deputete ka prapë pyetje për kryeministrin.

DEPUTETJA SALA BERISHA- SHALA – Ju faleminderit për përgjigjen z. kryeministër. Por atje ekziston shqetësimi se xehja është duke u bartur në Kavadarë të Maqedonisë e kamufluar në emër të gjoja analizave laboratorike. Sa jeni ju në dijeni për këtë? Sa i përket kushtit për plotësimin e numrit të punëtorëve kemi njohuri se më shumë 50% e punëtorëve që momentalisht punojnë në Feronikel janë ata punëtorë që janë nënkontraktorë të NJUKO Feronikelit, por jo edhe ish- punëtorët e Feronikelit. Pastaj shqetësimi më i madh është se mbahet ende fshehët kontrata dhe aneks-kontrata në lidhje me asetet e Feronikelit . Nëse keni mundësi të na jepni ndonjë informatë shtesë.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Fjalën e ka ministri Bujar Dugolli.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI- Do t'i ndihmoj kryeministrit se i kam këto informacione. Nuk është e vërtetë se bahet xehja, sepse ajo e ka të ndaluar me kontratë të shitjes me e bartë xehen dhe kjo nuk mund të lejohet. Çështje të tjera që i ngrite , po ashtu, nuk janë të vërteta që ai po i merr, nuk ka punëtorë sipas kontratës. Është kompania e shitur me SPINOF Special që më së miri duke i përmbushur obligimet dhe para kohe është duke përmbushur obligimet, vetëm ju nuk po i përmbushni obligimet në komunën se nuk po e mbartni pronën po e shkëlpi Ligjin për kadastrat, sepse nuk keni drejtë të mos e bartni pronën private. Kjo është ajo çka unë dua të them që nga raportet që i kemi nga menaxhmenti i AKM-së. Raportet që do të verifikohen nga auditori i pavarur i jashtëm flasim që Njuko Feronikeli është investitori më serioz që ka në Kosovë në procesin e privatizimit, prandaj ne duhet të jemi të lumtur që kemi kesi investitor, dhe jo t'i bëjmë pengesa. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Keni prapë pyetje plotësuese. Deputetja Sala Shala- Berisha ka pyetje tjetër për kryeministrin Çeku.

DEPUTETJA SALA SHALA BERISHA – Z. kryetar. Unë i kam shtruar pyetje kryeministrit Çeku, për ministrin Dugolli kam të tjera pyetje, por në tjetrën seancë lidhur pikërisht me Feronikelin, unë po vazhdoj me pyetjen tjetër për kryeministrin.

Nuk është ashtu z. ministri si po thoni ju: e vërteta është ndryshe. Z. kryeministër, çështja është që kjo ditë Qeveria deklaroi që ka marrë vendim për dhënien me koncesion të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Kemi qenë dëshmitarë dhe kemi dëgjuar në media. Nga ana tjetër ministri i Transportit dhe i Postë Telekomunikacionit para Komisionit Parlamentar tha se një vendim i tillë është shtyrë për më vonë. Pyetja është :

Cila është e vërteta rreth kësaj çështjeje?

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Urdhëroni z. kryeministër.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – E vërtetë është kjo, ne jemi në përgatitje të bartjes së kalimit të kompetencave nga UNMIK-u në Qeverinë e Kosovës apo në institucionet e saj. Ne, gjithashtu, ndërmarrjet publike menaxhimi i ndërmarrjeve publike do të kalon në kompetencat tona dhe ne jemi duke kërkuar përgjigjeje, duke kërkuar zgjidhje se si do t'i menaxhojmë apo cila është e ardhmja e ndërmarrjeve publike? Në vitin 2004, shumë më herët d.m.th. ka filluar një studim i ekspertëve ndërkombëtarë për të ardhmen e Aeroportit dhe të Aviacionit në Kosovë dhe këto ditë ky grup ekspertësh ka ardhur me rekomandime, apo me avantazhe të privatizimit dhe të dhënies me koncesion. Ne e kemi trajtuar këtë propozim në Qeveri, menjëherë e kemi hedhur poshtë mundësinë e privatizimit të Aeroportit dhe jemi koncentruar në dhënien e Aeroportit në koncesion. Kështu, jo tani nuk bëhet fjalë se kemi dëgjuar se të mos ngutemi para statusit? Si do të ndodhë pas statusit do të ketë Qeveria mundësi të vendosur për të ardhmen e ndërmarrjeve publike, por jo tani, nuk është kompetencë jona, por tani jemi duke përgatitur rrugën e duhur d.m.th. në menaxhimin apo fatin e këtyre ndërmarrjeve, kështu

që ne në këtë mbledhje i kemi dhënë përparësi dhënies me koncesion dhe kemi detyruar ministrin e Transportit dhe ministrin e Financave në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtar ta zhvillojnë këtë ide, ta zhvillojnë këtë projekt dhe ky projekt vetëm zhvillimi këtij projekti do të marrë 6 deri 9 muaj. Atëherë do të merret vendim, por ti shohim cilat janë përparësitë e dhënies me koncesion domethënë e kemi hedhur poshtë privatizimin menjëherë dhënies me koncesion, cilat janë mangësitë e tilla, cilat janë kushtet në qoftë se e japim me koncesion, cilat kushte do t'i qesim domethënë partnerit tonë strategjik.

Kështu që dhënia me koncesion na u ka dukur si një zgjidhje e mirë për arsye se Aeroporti sot është ndërmarrje shpenzuese, e shpenzon edhe e ngarkon buxhetin e Kosovës, vetëm vitin e kaluar ne i kemi dhënë 12 milion euro Aeroportit të Kosovës, po kredi i kemi dhënë, po Aeroporti i Kosovës në krahasim me aeroportet e tjera të dhëna me koncesion është duke i shfrytëzuar vetëm 50% të mundësive të veta. Kështu që dhënia me koncesion është një model tani më i njohur, shumë i popullarizuar në botë, i quajtur partneriteti publiko privat dhe është normale të kuptohet, domethënë ne vetëm e sjellim në Kosovë një partner strategjik që të sjellë investime në Kosovë, të investojë domethënë në Aeroportin e Kosovës garantojë shërbimet ma të mira, më cilësore, më të sigurta ,dhe të paguajë thjeshtë qira çdo muaj buxhetit të Kosovës, kështu që me dhënien n koncesion buxheti do të përfitojë do të kemi një investitor të fuqishëm botëror, do të kemi shërbime më të mira më të shpejta thash edhe më të sigurta, por përgjigjet në këto pyetje se sa do të jetë e dobishme sa do të fitojë mund t'i marrim pas pesë ose 6 muajve Qeveria e Kosovës ka marrë vendim vetëm ta shqyrtojë hollësisht dhe ta paraqesë para Qeverisë cilat janë benofitet në qoftë se e japim me koncesion, në qoftë se s'ka normal që nuk do ta japim, kështu që nuk është normal se nuk do ta japim, nuk është marrë vendim.

KRYETARI KOLË BERISHA – Deputetja Shala a keni pyetje plotësuese.

DEPUTETJA SALA BERISHA -SHALA – Po, unë i bëj pyetjen se a ekziston Ligji mbi koncesionet? Të gjithë e dimë që jo, tjetër është a e keni ndërmend të jeni më transparente në lidhje me këtë çështje dhe se momentalisht këtu krijohet përshtypja se Qeveria me çdo kusht po tenton në këtë fazë të zë hapat minutat e fundit, në këtë fazë që po kalon Kosova të privatizojë të koncesionojë çdo gjë që është, nuk është e kuptimshme për çfarë ju duket jo urgjente aq e madhe në këtë kohë. Dhe ministrat e tuaj që i keni në bordin e AKM-ës sillen sikur super ministra duke u nisur nga përshtypja se AKM-ja është një super Qeveri në Kosovë. Ministrat që i keni në atë bord sillen si super ministra andaj shpesh jo që krijohet përshtypja por është e vërtetë që nuk ju japin llogari as juve prandaj dalin pra me mendime kontradiktore, njëri ministër thotë se nuk koncesionohet, tjetri thotë se koncesionohet.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni z. kryeministër

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Unë thashë na as nuk kemi kompetenca as mundës as s'është e pamundur që të jep me koncesion Aeroporti para statusit apo këtyre 5, 6 muajve të ardhshme. 5, 6 muajt e ardhshëm do të përfundojë vetëm studimi, a këtë studim ne e kemi bërë qe dëshirojë dhe është e domosdoshme që të kemi vizion të kemi zgjidhje, në

qoftë se më pyetni do me thanë nuk do ta sjelli veten në pozitë se më pyetni çfarë versioni ju keni, çfarë plani për aeroport unë duhet ta kem përgjigjen në këtë pyetje, për ta pasur përgjigjen në këtë pyetje ne thamë. Jemi përcaktuar që ta studiojmë më në detaje mundësin e dhënies me koncesion, nuk kemi marrë vendim që ta japim me koncesion aeroporti, se nuk kemi as kompetenca të marrim një vendim të tillë dhe assesi kjo edhe nëse ndodh nuk mund të ndodhë para një viti.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Me qenë se ministri Gjini nuk është prezentë pyetja e deputetes Selvije Halimi mbetet për radhën tjetër. Deputeti Ibush Jonuzi, ka pyetje për ministrin Qemajl Ahmeti. Z. Jonuzi keni pyetje plotësuese.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Faleminderit i nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, Kabinet Qeveritar, kolegë deputetë dhe ju të pranishëm.

I nderuri ministri Ahmeti. Në cilën fazë janë përgatitjet për punimet lidhur me ndërtimin e autostradës Merdar – Prishtinë – Durrës, edhe pse ju mjaft mirë e keni shpjeguar në Komision parlamentar këtë çështje por me gjithat kjo pyetje ka qenë më herët e shtruar, prandaj mundësisht t’u përgjigjeni. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni z. ministër e keni fjalën.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Faleminderit z. kryetar, faleminderit z. deputet. Sa i përket projektit të autostradës informojë se është hartuar projekti zbatues, është bërë studimi **fizibilitetit** të këtij aksi rrugor që njihet si korridori i shtatë ose rruga e shtatë. Jemi në fazën përfundimtare të evidentimit të pronave ku do të kalon kjo trase dhe shikimi i mundësive për gjetjen buxhetore do me thanë pas evidentimit të pronave duhet të bëhet shpronësimi që presin Ligjin për shpronësimet të dekretohet nga PSSP-ja dhe pastaj të mirën hapat për gjetjen e mjeteve financiare që këtë autostradë ta fillojmë. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Deputeti Jonuzi a keni pyetje plotësuese. Jo. Deputetja Sanije Alijaj ka pyetje për ministrin Qemajl Ahmeti. Urdhëroni z. Alijaj.

DEPUTETJA SANIJE ALIJAJ – I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, i nderuar kryeministër Çeku, të nderuari ministra të çmuar dhe të respektuar deputetë të Kuvendit. Unë e kam pyetjen drejtuar ministrit Qemajl Ahmeti, lidhur me ngecjen e realizimit të dy projekteve për rregullimin e infrastrukturës rrugore në komunën e Ferizajt.

Z. ministër, komuna e Ferizajt si çdo kund në Kosovë doli nga lufta me infrastrukturë të dobët rrugore. Edhe sot e kësaj dite nuk mund të sigurojnë nga burimet e veta vëllim të hyrave buxhetore në pajtim me nevojat që kemi për rregullimin e infrastrukturës rrugore, që është kusht për zhvillimin ekonomik në komunë të Ferizajt.

Për mirëmbajtjen e rrugëve vitin e kaluar janë ndarë 8 milion euro në kategorinë mallra shërbime, për këtë vit në Ligjin për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës janë ndarë mbi 7 milion për mallra e shërbime dhe mbi 23 milion nga shpenzimet kapitale për infrastrukturën rrugore dhe qytetarët e komunës sonë ende kanë vështirësi në qarkullimin rrugor.

Në vitin 2004 është shpallur tenderi për rrugën Ferizaj - Rahovicë – Mirash – Babushi e gjatë 18 kilometra që i lidh 12 fshatra dhe sot e kësaj dite nuk është realizuar dhe projekti Ferizaj – Dogana – Greme – Gaçkë – Bashderhane me gjatësi 12 kilometra ende i parealizuar.

Kërkoj sqarime për ngecjen e këtyre projekteve. Njëkohësisht kërkoj që këto projekte të realizohen në këtë vit se jemi komuna që shumë pak është investua në këtë drejtim dhe në çdo kontakt me qytetarët e këtyre fshatrave në nivel komunal insistohej që sa më parë të rregullohen këto rrugë se janë shumë të shkaktuara. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Faleminderit edhe një herë, faleminderit z. deputete. Fjala është për dy rrugë lokale të shpallur në vitin 2004, pra janë shpallur në tender, por procedurat janë ndërprerë për shkak të mungesës së financave pra mjeteve financiare.

Me qenë rrugë lokale unë në bazë të Ligjit për rrugë nuk kam të drejtë të fusë në prioritet ato rrugë, prandaj janë në kompetencë të komunës dhe komuna duhet të vazhdojë procedura për shpalljen dhe ndërtimin e këtyre rrugëve. Ministria do të mbështetë për aq mjete sa do të ketë në vijën buxhetore bashkëfinancim me komunat. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Keni pyetje plotësues z. Alijaj.

DEPUTETJA SANIJE ALIAJ – Këto projekte janë shpallur në koordinim të punëve me Ministrin për Transporte dhe Postë Telekomunikacion dhe natyrisht pyetja ime është bërë me qëllim që këto në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me kuvendin komunal të participohet dhe të realizohen sa më parë sepse këto projekte janë qysh nga ministri z. Zef Morina dhe kanë mbetur ende të parealizuara, natyrisht qetësimi e qytetarëve për këto ngecje janë shumë të arsyeshme. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Deputetja Selvije Halimi ka pyetje për ministrin Ibrahim Selmanaj, urdhëroni.

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI – Faleminderit z. kryetar. Z. ministër ka kohë që pensionistëve të Kosovës u është ndërprerë e drejta në marrjen e pensioneve të tyre. A mund të na jepni sqarim në lidhur me këtë çështje?

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. urdhëroni z. ministër.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ – Faleminderit z. kryetar, z. kryeministër të nderuar deputetë. Kisha lutur deputeten me qartësua pak pyetjen ta di qartë çka donë me pyet.

KRYETARI KOLË BERISHA – Selvije Halimi e ka fjalën.

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI – Z. ministër, çështja ka kaluar një kohë kur pensionistëve të Kosovës u është ndërprerë e drejta në marrjen e pensioneve të tyre të rregullta. Pyetja, a mund të na epni sqarim lidhur me ndërprerjen e dhënies së pensioneve, pyetje shumë konkrete dhe e qartë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ – Prapë është pyetja e shkurtër. Sido që të jetë unë po të japi sqarime, jam i obliguar të sqarojë se cilat janë zhvillimet edhe pse bëhet ndërprerja e pensioneve bazike.

Për fat të keq kemi ardhur deri te konstatimi se edhe pas vdekjes së pensionistëve që shfrytëzojnë pensionet familjarët kanë keqpërdorur pensionet dhe kemi marrë disa masa përmes cilave kemi vërtetuar dhe i obligojmë pensionistët që të lajmërohen se a janë gjallë dhe pensionistët a kanë bërë keqpërdorim të dokumentacionit, në mënyrë që të përfitoj edhe nga ndonjë skemë tjetër dhe këto janë ato masa të cilat i kemi marrë dhe në çdo gjatë muaj pensionisti duhet të lajmërohet se pensionisti është gjallë. Në momentin kur lajmërohet pensionisti dhe konstatohet se është gjallë ai prapë do t'i merr ato mjete të veta të cilat i takojnë në vlerën e mjeteve 40 euro.

Sa i përket pensioneve për persona me aftësi të kufizuar edhe këto janë disa masa të cilat ne i marrim në kuadër të veprimeve dhe zhvillimeve dhe komisioneve të cilat i kemi në komuna, kjo ndodh kur shfrytëzuesi vdes, kur komisioni konstaton se gjendja e tij shëndetësore ka shënuar përmirësim, rastet kur ka skaduar koha kur i është aprovuar e drejta e shfrytëzimit të pensionit invalidor prej një, tre deri pesë vite i nënshtrohet komisionit tjetër dhe në qoftë se komisioni konstaton se ky pensionist ose personi me aftësi të kufizuara invalidore çfarëdo që të jetë nuk ka të drejtë ta shfrytëzoj sepse janë masa dhe kritere përmes të cilave duhet t'i shfrytëzojnë pensionet.

Suspendimet në skemën e personave me aftësi të kufizuar ka ndodhur për shkak të një numri të caktuar pensionistëve kanë kaluar intervalin kohorë përfitimeve, janë këto periudha kohe kur jemi të obliguar që të nënshtrohemi edhe një herë atyre komisioneve dhe atyre kritereve. Është e vërtetë se është plasuar në opinion se pensionisti i cili nuk është lajmëruar supozojmë për muajin shkurt po lajmërohet në muajin mars është i gjallë se nuk ka të drejtë të shfrytëzojë ato mjete të cilat i kanë takuar për muajin shkurt. Ndërsa me një normë të veçantë e kemi rregulluar këtë çështje dhe secili pensionist i cili konstatohet se është gjallë ai ka të drejtë ta shfrytëzojë atë mundësi shfrytëzuese të vlerës 40 euro. Kjo është një përgjigje nëse keni diçka shtesë unë ju pres këtu.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, urdhëroni deputetja.

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI – Faleminderit z. ministër. Mirëpo ju keni nxjerrë një udhëzim administrativ me çka keni cenuar të drejtat e pensionistëve. Nuk do të thotë që lajmërimi i pensionistëve në çdo 6 muaj do t'i ndalë keqpërdorimet nga ana e familjarëve, sepse ai mund të vdesë ditën pas lajmërimit të ju dhe për 6 muaj familja mund ta merr këtë pension.

Ju lutem ta rishikoni vendimin dhe kjo se pensionistët që janë lajmëruar dhe u është nda pensioni nuk i kanë marrë ende të ardhurat në retroaktiv, ato pensione janë të ndara për pensionistë, janë në buxhetin e tyre, çdo vonim i mosdhënies retroaktivit nënkupton manipulim me mjete në mënyrë që ato gjatë **ciklimit** të tyre përfitoj dikush. Andaj keni kujdes sepse na keni detyruar ta shkelim ligjin këtu në emër të pensionistëve pas është aprovuar buxheti për vitin 2007, tash mos e shkelni vetë atë ligj. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ – Faleminderit për sugjerime do të jemi shumë i kujdesshëm. Më vjen mirë se keni qëndrim pozitiv ndaj pensionistëve, duke pasur parasysh ato pak mjete të cilat u takojnë vërtet do të kujdesemi që të shkojnë mjetet atyre njerëzve në mënyrën sa më të mirë dhe sa më të lehtë për ta. Faleminderit shumë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Me qenë se ministrat Haraqija dhe Gjini nuk janë prezentë dy pyetjet e deputetes Bukoshi përcillen për seancën e ardhshme. Deputetja Safete Hadrgjonaj, ka pyetje për zëvendësministrin Tomë Hajdarajn. Doni ta sqaroni pyetjen?

DEPUTETJA SAFETE HADËRGJONAJ – Faleminderit z. kryetar. Z. zëvendësministër, qytetarët e komunës së Deçanit janë të shqetësuar ngase bjeshkët e tyre po humbin identitetin që kanë pasur dikur nga prerjet ilegale të pyjeve qofshin ato prerje nga keqbërësit individual, çoftë nga prerjet legale përmes tenderëve të dhënë nga Agjensioni Pyjor Regjional dhe qendrorë. Pyetja është? Çfarë keni ndërmarrë për ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të pyjeve në këtë komunë?

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni z. zëvendësministër.

ZËVENDËSMINISTRI TOMË HAJDARAJ – Z. kryetar, z. kryeministër, të nderuar deputetë, ministra prezentë. Unë kam përgatitur një material bukur të gjatë lidhur me pasqyrën e rrjedhave , në njësinë komunale të APK-ës në Deçan për aktivitetet sfidat dhe rekomandimet, por duke u bazuar në kohën që e kemi të parapamë unë do të ndalem vetëm në pyetjen që u parashtrua nga zonja deputete e nderuar dhe pastaj unë do të jap edhe materialin për zonjën deputete ta ketë në shfrytëzim.

Masat preventivat për mbrojtjen e pyjeve që ka ndërmarrë Ministria e Bujqësisë në komunën e Deçanit. Si rezultat i asaj që rajoni i Deçanit konsiderohet si më i atakuar në

gjithë Kosovën Ministria ka bërë intervenime shtesë përkundër asaj që i ka paraparë me program të punës.

Një, vendosjen e dy punkteve përhershme kontrolli nga ana e SHPK-së në grykën e Deçanit dhe asaj të Lloçanit 24 orë ku buxhetit të Ministrisë gjegjësisht Qeverisë së Kosovës këto dy punkte i kushtojnë mbi 100 mijë euro. Shtimi i stafit për 5 punëtorë shtesë me kontratë në vepër përjashtim vetëm për Deçanin janë proceduar fletëparaqitje për keqbërësit nëpër gjykata 406 fletëparaqitje prej të cilave 273 për kundërvajtje dhe 133 për vepër penale, vlera e dëmit në masë ... ka qenë 1912 metra kub.

Katër, vendosjen e një punkti mobil në Jasiq me staf të APK-ës 24 orë kontroll.

Pesë, krijimin e grupit të punës i përbërë nga përfaqësuesit e komunës, UNMIK-ut, KFOR-it, SHPK-ës, gjykatave dhe Ministrisë, grup që kohë pas kohe është takuar dhe ka shqyrtuar rrjedhat që i ka futur në funksion koordinimit të aktiviteteve në drejtim të mbrojtjes së pyjeve në Deçan.

Gjashtë, formimin e njësitit të SHPK-ës ekskluzivisht për mbrojtjen e pyjeve, njësit i cili së bashku me stafin e APK-ës patrollojnë në gjithë sipërfaqet e pyjeve në komunën e Deçanit.

Shtatë, gjithnjë në funksion të këtij qëllimi, vitin e kaluar është ndalur prerja e rregullt tek halorët nga ana e operatorëve privat dhe planin e prerjeve të rregullta e ka kryer vetëm Gjeravica e Deçanit e cila është e specializuar dhe të njëjtin veprim do ta bëjmë edhe sivjet vetëm për Gjeravicën, ndërsa operator privat nuk do të kenë të drejtën që të marrin prerje të rregullta. Gjeravica nga e gjithë masa drusore që është prerë vjet mbi 9 mijë metra kub ka realizuar 8 mijë masë drusore nga plani operativ i prerjeve.

Tetë, gjithashtu në funksion, 37 takime me përfaqësues të ndryshëm të komunave dhe institucioneve të tjera, ku në këto takime kanë marrë pjesë edhe Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis, përfaqësuesit e lartë të Ministrisë, komunës, SHPK-ja, e KFOR-i dhe UNMIK-u.

Pajisjen e njësisë komunale të APK-ës, nëntë, me tre automjete, stafin me mjete komunikuese radio lidhje dhe me mjete tjera domosdoshme për punë. Është formuar një Komision ekspertësh do me thanë 10 që ka kryer dhe ka bërë ekspertizën e dëmtimit të pyjeve nga dëmtuesit dhe sëmudjet dhe që janë duke u zbatuar rekomandimet e këtij Komisioni dhe sot. Që nga rezultatet që kanë dalë dhe referencat nga Komisioni janë tërhequr vitin e kaluar mbi 5 mijë metra kub dru të prerë më parë por i dëmtuar, përderisa në fazën e dytë do të fillojë në prill dhe janë duke u bërë përgatitjet.

Gjithashtu edhe për trajtimin e vendosjes së kurtheve nga brejtësit gjithësisht dhe luftimit kimik të këtyre dëmtuesve.

Njëmbëdhjetë, funksion të efikasitetit përgjithësisht dhe disiplinës së personelit të personelit zyrtarë APK-ja për vitin 2005 janë ngritur 9 komisione disiplinore në vitin

2006 tetë ku janë marrë dhe proceduar një numër i konsiderueshëm i punëtorit të cilët ndaj të cilit është marrë masa prej vërejtjeve deri te largimi nga puna. Mirëpo ,duke pasur parasysh po them kohën unë kam përgatit një material për z. deputete të cilës do t'ia jap në shfrytëzim dhe ta ketë materialin.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Keni pyetje shtesë..

DEPUTETJA SAFETE HADËRGJONAJ – Faleminderit për z. zëvendësministër që ma afroji materialin por unë atë material pothuajse e kam këtu. Më vjen shumë keq nëse Ministria i ka marrë të gjitha këto masa të cilat masa i kanë kushtuar edhe Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe nuk e kanë arritur efektin e duhur ngase vetëm në bazë të të dhënave të cilat janë nga agjencia e Ministrisë së Bujqësisë shihet që plani është tejkalluar për 2 mijë metra kub që llogaritur në vlerë janë mbi 300 mijë euro, afër 300 mijë euro. Kështu që unë kam ndier shqetësimet e qytetarëve të cilat edhe unë ia kisha afruar ministrit dhe kamë edhe shumë shqetësime dhe vërejtje që i kanë dërguar shoqatat joqeveritare të cilat janë deklaruar si tepër të shqetësuara dhe kanë kërkuar që të bëhet ndërprerja përkohshme e prerjeve të pyjeve derisa Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë të dalë me një plan afatgjatë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëron z. zëvendësministër.

ZËVENDËSMINISTRI TOMË HAJDARAJ – Faleminderit z. kryetar. Ne i kemi paraparë të gjitha masat që na i lejon ligji dhe të njëjtat i kemi futur në funksion, por për vitin në vijim ne kemi paraparë disa masa të tjera që janë në materialin që e ka z. deputete, sigurisht do t'i shqyrtojë dhe do t'i japë vlerësimet.

Ndërsa sa u përket keq bërjeve, krahasuar me shkatërrimet të cilat kanë qenë para tri viteve ,ne kemi dëmtime në pyje, por shkatërrimet enorme që kanë qenë, janë ndaluar duke falënderuar institucioneve të cilat janë në funksion. Ndërsa për fat të keq të gjitha ato dëmtime që bëhen i bëjnë njerëzit e asaj ane që unë nuk desha ta sjell. I kam edhe 65 me emra e mbiemra të cilët po që se zonjës i nevojitet do t'i sjell, por ka edhe bukur shumë mbiemra ndoshta të cilët janë të ngjashëm me disa tonëve këtu. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. zëvendësministër. Me qenë se nuk ka pyetje tjera sot. Pyetjet të cilat janë drejtuar për sot dhe nuk kanë marrë përgjigje shtyhen për seancën e ardhshme.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Urdhëroni z. Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Rregulla 26 e Rregullores së punës së Kuvendit rreth pyetjeve për Qeverinë për përgjigje me gojë, përcakton edhe kohën që duhet të shfrytëzohet për këto pyetje dhe këto përgjigje. Zakonisht koha për përgjigje e ministrave është shumëfish më e gjatë se sa që është e përcaktuar me Rregullore, ndërsa deputetëve kur bëjnë pyetje u ndërpritet menjëherë. Kërkoj që kjo rregull të respektohet strikt kur

është fjala edhe për ministrat. Zoti Tomë Hajdaraj foli hiq më pak se 7 minuta në përgjigjen e tij, ndërsa është dash përgjigjet vetëm për 3 minuta.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Unë kërkoj që ta respektojmë Rregulloren bashkërisht. Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryetar, ka katër muaj që kam bërë një pyetje për kryeministrin. Nuk e kuptoj arsyen pse kjo pyetje vazhdimisht hiqet nga rendi i ditës, a është pyetje e ndaluar apo ku është arsyeja?. Pse censurohet kjo pyetje, në çdo mbledhje e hiqni nga rendi i ditës dhe e kaloni për mbledhjen tjetër dhe asnjëherë nuk bëhet. As nuk bëhet pyetja as nuk jepet përgjigjja. Unë mendoj që është pyetje me rëndësi sipas mendimit tim edhe kërkoj përgjigje.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Nëse dy herë është parashtruar pyetja dhe ministria nuk ka qenë e gatshme të japë përgjigje, shkon në Buletin - botohet.

Unë ta jap mundësinë me ardhur me e këqyrë rendin e pyetjeve këtu çka janë. Vazhdojmë më tutje.

Pika e katërt e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vendbanim dhe vendqëndrim

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 26 shkurt 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj ministrin për Punë të Brendshme z. Blerim Kuçin që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI BLERIM KUÇI – Faleminderit z. kryetar, i nderuari z. kryetar të nderuar deputetë.

Sot për prezantim dhe miratim në parim kemi Projektligjin për vendbanim dhe vendqëndrim. Ky projektligj rregullon çështjen e lajmërimit dhe çlajmërimit të vendbanimit dhe të vendqëndrimit të qytetarëve, të mysafirëve, ndërrimin e adresës së banimit, kompetencat dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave përkatëse. Nevoja për nxjerrjen e këtij ligji është rregullimi ligjor i materies që lidhen me vendbanimin dhe vendqëndrimin e qytetarëve dhe mysafirëve. Në këtë mënyrë me këtë ligj eliminohet zbrazëtirat ligjore lidhur me detyrimin e qytetarëve për t'u lajmëruar dhe çlajmëruar, kompetencën dhe mënyrën e lajmërimit, çlajmërimit, metodologjinë e mbajtjes së të dhënave në evidencës e mysafirëve, udhëheqjen dhe mbajtjen e regjistrit të vendbanimit dhe gjobat.

Projektligji ka pesë kapituj dhe njëzet e nëntë nene. Çështjet lidhur me këtë Projektligj në formë më të zgjeruar i keni në Memorandumin shpjegues të draftit fillestar

Projektligji ka deklaratën respektive të Agjencionit për Integrim Evropian dhe Deklaratën financiare të MEF-it ku shihet se është në pajtim me legjislacionin e BE-së dhe nuk ka implikime buxhetore, sepse Ministria e Punëve të Brendshme dhe SHPK-ja kanë strukturat e krijuara që përfshihen në zbatimin e këtij projektligji.

Nga arsyet e theksuara propozoj që Kuvendi i Kosovës ta miratojë në parim Projektligjin për vendbanimin dhe vendqëndrim. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. z. ministër. Përfaqësuesit e partive politike. Deputeti Agim Krasniqi, urdhëroni z. Krasniqi.

DEPUTETI AGIM KRASNIQI – Faleminderit z. kryetar. I nderuari z. kryeministër, ministra, kolegë deputetë.

Do të flas shkurtimisht lidhur me Projektligjin në fjalë dhe do t'i jap vlerësimet e mia dhe të Grupit Parlamentar të LDK-ës.

Qysh në fillim unë konstatoj se ky projektligj është i hartuar edhe i kompletuar si duhet, por megjithatë, duke qenë se asnjë projektligj, madje as ligj nuk janë përkryer dhe të kompletuar plotësisht, atëherë edhe ky Projektligj ka vend për vërejtje, plotësime e korrigjime, besoj që këtu të gjitha do të ndodhen pas në procedurën e rregullt përmes Komisionit funksional dhe komisioneve të tjera dhe deputetëve.

Unë desha të ndërlihem vetëm në disa nene të këtij projektligji.

E para, neni 5 pikë 3 i cili thotë se qytetari më i vjetër se 16 vjet sipas dispozitave të tjera ka fituar të drejtën e punësimit me orar të përgjysmuar duhet të lajmërohet dhe çlajmërohet vetë. Unë mendoj që kjo dispozitë edhe ky paragraf nuk duhet të qëndrojnë, sepse nuk do të duhej të ndërlihen me moshën 16 vjeçare dhe me punësimin e përgjysmuar apo të plotë të qytetarit të Kosovës. Kështu që mendoj që kjo është e tepërt edhe e panevojshme.

Ndërkaq neni 5, pika 5 kur është fjala te lajmërimi i vendbanimi ndërrimi i adresës së banimit bëhet në afatin prej 8 ditësh nga dita e vendosjes. Ndërsa çlajmërimi i vendbanimit bëhet para shpërnguljes. Unë jam i mendimit edhe Grupi Parlamentar i LDK-ës është që edhe këtu duhet të ekzistojë një afat kur qytetari duhet t'i paraqesë çregjistrimin, çlajmërimin e tjera.

Tjetër është edhe neni 8, pika 3, i cili gjithashtu lidhet me moshën, nëse një familje transferohet shpërngulet ajo me siguri që do t'i paraqesë të gjithë anëtarët e familjes, pa marrë parasysh moshën, a do të jenë nën moshën 16 vjeçare apo mbi moshën 16 vjeçare.

Desha disa korrigjime në emërtime në disa nene, neni 12 paragrafi a) pastaj neni 14 pika 1 dhe neni 16 pika 7 kur është fjala tek emërtimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme përmendet pas fjalës Ministri thuhet Ministria kompetente për Punë të Brendshme që nuk është e nevojshme të quhet kompetente, por është Ministri e Punëve të Brendshme.

Dhe e dyta kur përmenden Ministria e Punëve të Brendshme edhe Ministria e Mbrojtjes aty përmenden edhe fjalët rreth policisë respektivisht rreth ushtrisë, kështu që ato janë pjesë përbërëse, pjesë e strukturës së ministrive përkatëse dhe nuk ka nevojë të përmenden as policia dhe as ushtria nëse është në pyetje Ministria e Mbrojtjes.

Gjithashtu mendoj që ka vend për vërejtje, plotësime, korrigjime dhe ndryshime edhe kapitulli IV, i cili ka të bëjë me dispozitat ndëshkuese ka përzierje e interferime prej dispozitës në dispozitë. Mendoj që me një intervenim të vogël këto dispozita që kanë të bëjnë me dispozitat ndëshkuese mund të korrigjohen gjatë procesit të procedimit të rregullt në Komisionit për Siguri.

Më lejoni që në fund të konstatoj dhe të vlerësoj se ky projektligj mund të kalojë në parim dhe Grupi Parlamentar i LDK-ës është që të kalojë në parim dhe të hynë në procedurë të rregullt të mëtutjeshme. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të PDK-ës deputeti Sokol Bashota.

DEPUTETI SOKOL BASHOTA – Faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, Grupi Parlamentar i saj i jep mbështetje Projektligjit për vendbanim dhe vendqëndrim.

Miratimi i këtij ligji është i një rëndësie të veçantë në fushën e sigurisë, përse? Me këtë ligj identifikohen në parim të gjitha problemet apo bërësit e këtyre problemeve.

Kontributin tonë për këtë projektligj grupi ynë parlamentar do ta jap përmes anëtarëve të saj në Komisionin për Siguri. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Deputeti Naim Maloku e ka fjalën në emër të AAK-ës.

DEPUTETI NAIM MALOKU – Faleminderit z. kryetar, ministra të nderuar deputetë .

Ligji për vendbanim dhe vendqëndrim është një prej ligjeve të pakos që plotëson infrastrukturën ligjore të shtetit të Kosovës dhe është i një rëndësie të veçantë.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-ës jep mbështetjen në parim këtij Projektligji. Më lejoni të potencoj në emër të Grupit Parlamentar vërejtjet në katër nene.

Neni 3, gjegjësisht 3 pikë 1 ku përcaktohet me ligj obligimi që qytetari i Kosovës që e lëshon Kosovën përkohësisht- për më shumë se 3- muaj, është i obliguar ta lajmërojë policinë, mendoj se nuk është e nevojshme ose duhet të zgjatet koha për më tepër se 3 muaj.

Neni 4, gjegjësisht 4 pikë 2, më lejoni të nderuar deputetë ta citoj këtë paragraf.

Thotë kështu: Lajmërimin dhe çlajmërimin e mysafirit duhet ta bëjë qytetari që ka pritur mysafirin, në stacionin më të afërt policor. Mendoj se ky paragraf duhet të hiqet, përndryshe çdo mysafir që vjen cilido qytetar nuk është e udhës dhe nuk është mirë të obligohet me ligj ta paraqesë mysafirin në stacionin e policisë.

Neni 8 pikë 1 thotë kështu: Qytetarin që përkohësisht banon në objektin turistik hoteliere - banesor duhet ta lajmëroj, gjegjësisht ta çojë, pa marrë parasysh kohëzgjatjen e banimit. Mendoj se duhet të hiqet fjala: banesor.

Më lejoni të paraqes këtu një anomali në nenin 9 pikë 1. 9 që ka të bëjë me paragrafin 9 pikë 1 dhe 9 pikë 2 citoj projektligjin. Qytetarin që vendoset në objektin turistik apo hotelier pronari i objektit duhet ta lajmërojë gjegjësisht 12 orë pas vendosjes, respektivisht shkuarjes që mendoj se është në rregull. Por më lejoni t' ju përkujtoj se çka parasheh paragrafi 9 pikë 2 ,të huajin që vendoset në objekt banimi dhe nuk ka leje qëndrimi në Kosovë, qiradhënësi duhet ta lajmërojë respektivisht ta çlajmërojë në stacionin më të afërt policor brenda tre ditëve, pra për qytetarin e Kosovës është i obliguar brenda 12 orëve, ndërsa për të huajin që nuk ka vendqëndrim në Kosovë është i obliguar që brenda 3 ditëve paraqitja,kurse lajmërimi apo çlajmërimi pas shkuarjes së tij nga Kosova.

Grupi Parlamentar i AAK-ës i jep mbështetje këtij Projektligji dhe do ta japë kontributin e vet në përmirësimet, disa prej tyre edhe i ceka në këtë prezantim timin. Ju faleminderit z. kryetar.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari në emër të ORËS.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryetar. Shpresoj që së shpejti do të flas edhe në emër të AAK-ës. Ligji që e kemi përpara është një ligj i rëndësishëm edhe është i domosdoshëm. Është i domosdoshëm sepse koha në të cilën po jetojmë edhe situata të cilën Kosova po kalon duke u **orvatur** që ta ndërtojnë identitetin e vet shtetëror, kërkon që ligjet bazike të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e qytetarëve, siç janë ligjet të cilat po vijnë tash nga Ministria e Brendshme, Ligji për letërnjoftimin, Ligji për numrin personal dhe tash Ligji për vendbanimin dhe vendqëndrimin duhet të jenë ligje të cilat patjetër të jenë të miratuara në Kuvendin e Kosovës në mënyrë që të normalizohet komunikimi i qytetarëve me shtetin apo shteti me qytetarët.

Ligji si ligj pra nuk kemi asnjë kontestim është ligji i nevojshëm edhe i domosdoshëm. Mendoj se ligji është i punuar pak në mënyrë të vjetruar është i një mode të vjetër i një kohe të vjetër ka tepër kufizime, tepër sekcione, tepër kërkesa ndaj qytetarit dhe këto kërkesa ndaj qytetarit e bëjnë ligjin të jetë tepër burokratik dhe si i tillë mendoj se nuk është ligj modern.

Prandaj do të ishte detyrë e Komisionit që këtë ligj ta zbutë, t'ia heqë këtë egërsi që e ka brenda vetit dhe që qytetari ta vendosë një komunikim optimal me shtetin në mënyrë optimale, as të mos ketë shteti kërkesa ndaj qytetarit më shumë sa që ai të pengohet në aktivitetin e tij të përditshëm e as qytetari të mos mund të jetë shtetit në komunikimin normal me shtetin.

Vërejtja ime parimore e cila ka të bëjë me një mangësi që hartuesi i ligjit e ka paraparë që Komisioni do ta plotësojë, është te neni 6 i cili ka të bëjë me përshkrimin e asaj që duhet të përmbajë formulari i lajmërimit të ndërrimit të adresës, aty i kemi të gjithë nën a, b, c, d, të gjitha shënimet që janë të rëndësishme, nuk është një shënim që për mua është e çuditshme si nuk e kanë paraparë hartuesit e Projektligjit, nuk është futur adresa. Adresa dhe numri i banimit, si mund të rregullohet vendqëndrimi në qoftë se në dokumentacion nuk figurojnë: adresa, rruga dhe numri.. Prandaj mendoj se këtu duhet pa tjetër të përfshihet edhe ky element, përndryshe ligji nuk e rregullon materien nëse dëshiron ta rregullojë.

Pra do të ishte shumë mirë që ato kufizime që u përmendën edhe më herët nga z. Maloku lidhur me mysafirët dhe obligimet që dalin edhe nga punëtorët hotelierë për të lajmëruar dhe del që të gjitha objektet hoteliere duhet të punësojnë njerëz të cilët duhet vazhdimisht të komunikojnë në zyrat e Punëve të Brendshme për t'u njoftuar se kush erdh e kush shkoi, sepse parashihet që brenda 12 orëve edhe kallëzohet kush erdh edhe kallëzohet kush shkoi nga objektet hoteliere, prandaj më duket se ato vetëm e vështirësojnë komunikimin normal të qytetarëve të interesuar edhe me shtetin lidhur me këtë problematikë.

Pra ligji duhet të zbutet përndryshe ne e japim përkrahjen në parim me shpresë që Komisioni ka me ja heqë këtë frymë të vjetër të kohëve të cilat i kemi kaluar.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Grupit 6+ deputeti Mahir Yagcilar.

DEPUTETI MAHIR YAGCILAR – Faleminderit z. kryetar.

Sayın Başkan, sayınbakanlar ve sayın milletvekilleri

Biz 6+ Parolmenter Grubu olarak, İkamet ve Barınma Yasa önergesini özel dikkat sarfederek görüştük ve ikamet ve barınma konusunun yasayla düzenlenmesi daha doğrusu Kosova'nın daimi vatandaşları olduğu gibi Kosova'da geçici olarak barınan yani göçmenlerin de kayıtlara geçirilmesi ve adres değişikliklerinin ve göç ettikleri eski ikamet defterlerinden silinmesi konularının düzene koyulmasının gerekli olduğu sonucuna vardık. Dolayısıyla bu Yasanın kabul edilmesiyle, söz konusu alanda şu anda mevcut olan Yasadaki bazı çelişkilerin de ortadan kalkacağını düşünüyoruz.

Açıklamalı beyanatta, bu Yasanın kabul edilmesiyle söz konusu alandaki tüm konular ve süreçlerin çözüme bağlanmasının planlaştırıldığı da vurgulanıyor. Bütçeye tesiri konusuna değinirken bu belgede, bütçe masraflarına doğrudan tesiri olmayacağına da

işaret edilmektedir. Ancak biz grup olarak, sadece bu Yasadaki tüm sorunları ve konuları çözemeyeceğini düşünüyor ve aynı zamanda, bu yasanın uygulanması için nüfus ve mülk sayımları ve kayıtları ile ilgili istatistik verilerin gerekli olduğunu, adres ile semt, köy ile belediyelerin v.s. adlarının bağdaşması gerektiğini düşünüyoruz. Öyleki nüfus sayımları yapılmadan ve adres ile semt adları bağdaşmadan Yasanın pratikte uygulanması süresinde birçok sorunlar çıkacaktır diye düşünüyoruz. Bütçeye tesir edecek konuları ele alan III bölümde de ileri sürüldüğüne göre, Yasanın kabul edilmesinden sonra meydana gelecek yeni koşullara vatandaşlar hemen uyum sağlayamayacağından dolayı, suçlu olmadan suçlu durumuna düşerek ceza ödemek zorunda kalabilecektir, bundan dolayı bu cezalardan da gelirin sağlanması olasıdır.

Hernasılsa bu Yasa, hukuki ve terminolijisi açısından güzel hazırlanmış. Örneğin model olarak alınan Slovenya gibi normal koşulların hüküm sürdüğü ortamlar için bu, uygulanması çok kolay bir Yasa. Ancak, bizim yaşadığımız koşullar için bu Yasanın, gereğinden fazla vaadeden bir yasa olması itibarıyla kolay kolay uygulanamayacak bir evrak olduğunu düşünüyoruz. Yasa aslında, daha basit ve uygulanır idari süreçlerden ibaret olmalıdır.

Hernasılsa bu durumda biz bu Yasanın kabul edilmesi ile ilgili süreçlere etkin olarak katılacağız ve Yasanın, nihai şeklinin en başarılı olması, uygulanması kolay bir evrak şekline sokulması konusunda kendi katkımızı sunacağız. Prensipde biz Yasa Tasarısını kabul ediyoruz.

Dikkatiniz için teşekkürler

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Deputeti Ramadan Kelmendi e ka fjalën.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Faleminderit z. kryetar. I nderuari kryetar, të nderuar ministra, deputetë kolegë të nderuar. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e shqyrtoi këtë propozim ligj dhe mes tjerash vlerëson se Ministria e Punës dhe Punës të Brendshme, si udhëheqëse e hartimit të Propozim vendbanimit dhe vendqëndrimit dhe prezantimit të tij të sot për shqyrtim të parë shënon një sukses të madh në kompletimin e ligjeve nga fushëveprimi i vet. Me ç'rast ne përgëzojmë duke përkrahur në miratimin parimor, sepse ky Propozim ligj është i domosdoshëm dhe duhet t'i paraprijë Ligjit për letërnjoftimin dhe numrin personal të cilët u kërkuan në një formë tjetër edhe sot këtu dhe arsyeshmërinë dhe bazueshmërinë të jenë shënimet për vendbanimet dhe vendqëndrimet për shtetasit e Kosovës.

Ndonëse propozim ligji që po e shqyrtojmë sot nuk ofron edhe zgjedhjet më të avancuara të kësaj fushe që zbatohen në rajon megjithatë edhe më gjerë.

Megjithatë ky propozim ligj pa regjistrimin e popullatës dhe ekzistimin e ekonomisë familjare na paraqet pengesa të mëdha, megjithatë me vërejtjet dhe sugjerimet, si dhe amendamentet që do të vijnë më vonë ky propozim ligj do të jetë një ligj mjaftë i mirë. Ndonëse nuk janë të vështirë lajmërimi dhe çlajmërimi i vendbanimit të qytetarit,

mysafirrit, adresa tjera, problemi paraqiten dy apo tri emërtime të fshatrave, rrugëve, shesheve, besa edhe qyteteve për të arritur efektin e dëshiruar. Në këtë kuptim janë më se të nevojshëm sqarimi dhe përcaktimi definitiv i emërtimeve të rrugëve, i shesheve, toponimeve dhe vendbanimeve dhe i të gjitha dokumenteve dhe lokaliteteve gjeografike, sepse shekuj me radhë këto kanë ndryshuar dhe në veçanti gjatë kohës së okupimit të cilat UNMIK-u ka marrë si gjëra të përfunduara të pandryshuara, por edhe të papranuara, ngase popullata ku jeton për shembull në fshatin tim emërtohet Kelmend, Lipë e emra të tjerë ose kemi Përroi i Zukës që emërtohet Bubin Potok, në Zubin Potok, Mali Sokolaj që emërtohet Sokol në vend që është Mali i Sokolajve, Sokolicë e tjera. Prandaj të gjitha këto na japin të kuptojmë se duhet eliminuar këto dy kuptime edhe për emra të shumtë të vendbanimeve, vendqëndrimeve mbi bazën e institucioneve tona të mirëfillta ,të cilat duhet t'i eliminuar paraprakisht. Për përcaktimin definitiv të emërtimeve të lokaliteteve, rrugëve dhe shesheve detyra shtrohen më se të domosdoshme.

Shikuar në tërësi Propozim ligji është i mirë, i shkurtër dhe më preciz dhe formalizimi i këtyre dispozitave është obligim yni, megjithatë janë disa sugjerime.

I pari, vendqëndrimi duhet të përputhet dhe të përkufizohet me të drejtën e largimit me kilometra nga vendbanimi i përhershëm dhe vendqëndrimi me kohë duke dalluar piknikun, pushimin vjetor dhe jo ajo të jetë si qëndrim i përhershëm.

Dy, evidenca e mysafirrit nuk mund të bëhet vetëm në objektet hoteliere dhe kurrsesi në ambientet familjare, sepse kjo evidencë tingëllon me një të kaluarën të një sistemi diktatorial si dhe është ngarkesë e pajustificuar e stacioneve policore për dorëzim të ... dhe mysafirëve brenda dite kohe të shkurtër e tjera dhe nuk mërinë efektet të dëshiruara.

Tre, përveç kritereve të përcaktuara me dispozitën 6 të këtij ligji çlajmërimi i vendbanimit duhet paraparë edhe shkaqet e ndërrimit të vendbanimit si dëshmi për të ardhur deri te formularët e dëshiruar të përcaktuar vendbanimin e vërtetë dhe jo vendqëndrimin që kërkohet.

E katërta, në rastet e lajmërimit të vendbanimeve të rrejshme të cilat organet mund t'i zyrtarizojnë të fillohet një procedurë dhe nuk është konstatuar procedura për konstatimin e vendbanimit të saktë real apo atij të rrejshëm.

E pesta, lajmërimi dhe çlajmërimi shkuarja jashtë Kosovës dhe kthyrja brenda në Kosovë nuk duhet të figurojë fare, sepse kjo nuk ka të bëjë me veprime juridike që shkaktojnë pasoja të konceptit të zbutur juridik për efektet e personalitetit apo të përcjelljes së individit, sepse këto janë takime të përcjella me dokumente bazë nëpër aeroporte e agjenci e të tjera .

E shtata, në këtë propozimligj Zyra e gjendjes civile ngarkohet për punë shtesë pa kompetenca në vend që këto veprime të bëjnë zyrat vendore si institucione të pushtetit vendor lokal ku marrin kompetenca përkundrazi nuk u takojnë atyre por zyrave apo stacioneve policore e tjera.

E teta, masa ndëshkimore në shumë prej 500 deri 1500 euro të larta dhe të pajustificuara janë sipas vlerësimit për shkak se nuk përcaktohen shkalla dhe recidivisti apo keqpërdorimi i tyre.

Mbështetur në të gjitha këto sugjerime ne mendojmë se dhe rikonfirmojmë arsyeshmërinë shumë të madhe të miratimit në parim të propozim ligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin me premtim se të gjitha këto do t'i paraqesim Komisionit funksional për miratim apo amendamentim. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit Fjalën e ka deputeti Gani Koci, le të përgatitet deputetja Zyhrije Maloku.

DEPUTETI GANI KOCI – Faleminderit z. kryetar. Të gjithë e thanë se është nga ligjet e rëndësishme Ligji mbi vendbanimin dhe vendqëndrimin.

Unë do të ndalem më tepër te definimet që janë bërë në këtë ligj rreth definicionit vendbanim dhe vendqëndrim sepse duhet kuptuar se lidhja me vendbanimin ka të bëjë me një lidhje të drejtave civile të njeriut për të realizuar diçka në te dhe natyrisht me detyrimet ligjore që dalin prej saj, dhe më duket se do të duhej më ndryshe të definojë nuk po e them këtu do ta them gjatë punës së komisioneve.

Po ashtu definicioni për bashkësinë familjare nuk konsideroj se duhet të merret komplet nga Ligji mbi familjen sepse ai e sqaron se çka është bashkësia familjare. Nuk është deficioni i drejtë rreth objekteve të banimit dhe cilat janë dhe çka mund të quhet objekte të banimit.

Po ashtu janë të ngatërruara lajmërimi dhe çlajmërimi i qytetarëve vendor i qytetarëve të Kosovës shtetas të Kosovës dhe qytetarëve të huaj.

Unë konsideroj se çështja për qytetarët e huaj në Kosovë do të duhej të rregullohej me Ligjin mbi azilin dhe vendqëndrimin e përkohshme të qytetarëve të huaj në Kosovë dhe jo të ngatërrohet me këtë ligj.

Është e drejtë dhe e drejtë në praktikë në secilën shtet që vërtet të lajmërohen qytetarët e huaj që vinë me një leje të veçantë me një leje të posaçme por ajo që u tha se çdo mysafirë që thuhet çdo mysafirë duhet të lajmërohet në stacionin më të afërt të policisë atëherë do të na bëheshin neve shqiptarëve radhët shumë të gjata për të lajmëruar dhe për të çlajmëruar mysafirët, kjo duhet të kufizohet me kohën edhe duhet të kufizohet me qëllimin e qëndrimit në rastin e caktuar, këto ishin disa, por kërkoj që vërtetë Komisioni të vlerësojë qartë dhe kur ka të bëjë me shtetasit e huaj këtë pjesë t'i lihet Ligjit mbi azilin dhe statusin e qëndrimit të qytetarit të huaj këtu në Kosovë, kështu po na ngatërrohen shumë ligje dhe shumë tjera qytetarë, shtetas i Kosovës dhe i huaj, shtetas i Kosovës i ka këto obligime në ligjin e veçantë, qytetari i huaj, shtetasi i huaj ka këto obligime gjatë qëndrimit të tij në Kosovë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit Fjalën e ka deputetja Zyhrije Maloku, le të përgatitet deputeti Milazim Haliti.

DEPUTETJA ZYHRIJE MALOKU – I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra, dhe ju kolegë deputetë.

Sot në këtë seancë të Kuvendit të Kosovës kemi në shqyrtim apo në lexim të parë Projektligjin për vendbanimin dhe vendqëndrimin të hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Unë çmoj ardhjen e këtij Projektligji në Kuvend dhe konsideroj shumë të rëndësishëm për qytetarët e Kosovës.

Ky Projektligj natyrisht se ka lidhshmëri me disa ligje të miratuara më parë nga ky Kuvend siç është Ligji për letërnjoftimin për familjen e tjerë. Mirëpo unë mendoj se para hartimit të këtyre ligjeve ka qenë dash të hartohet ligji për emërtimin e vendbanimeve apo ndryshimin e toponimeve. Them kështu sepse në jetën e përditshme dëgjojmë apo lexojmë emërtime të ndryshëm për të njëjtin vendbanim qoftë ai fshat apo qytet. Kështu dy qytetarë të të njëjtit vendbanim deklarohen për shembull se njëri është nga Podujeva e tjetri nga Besiana, apo njëri vjen nga Obiliqi e tjetri nga Kastrioti e shumë e shumë shembuj të ngjashëm.

Deklarimet e tilla e vejnë në dyshim qytetarin e Kosovës se për cilin vendbanim bëhet fjalë. Kjo të hapit për vendet të cilat janë më të njohura e mos të flasim për fshatrat që janë më pak të njohura kur dëgjojnë emërtime të ndryshëm përmes mjeteve të informimit qofshin ato elektronike apo të shkruara vërtetë mbetesh pa tekst sepse bënë të dyshosh se a gjenden në Kosovë apo diku tjetër.

Andaj, mendoj se vetëm me anë të ligjit mund të rregullohet ky problem dhe ta dinë një herë e përgjithmonë qytetari i Kosovës se për cilin vendbanim fshat apo qytet bëhet fjalë.

S'ka asnjë dilemë se qytetarët e Kosovës kanë nevojë të madhe për Ligjin për vendbanimin dhe vendqëndrimin sepse mungesa e tij krijon zbrastësirë ligjore. Edhe ky Projektligj natyrisht si të gjitha projektligjet tjera nuk është i përsosur, po ashtu është bërë përpjekje nga hartuesit që të bëhet një ligj i mirë i lehtë për zbatim duke përfshirë edhe përvojat e vendeve në rajon.

Do të them disa vërejtje dhe sugjerime.

Në nenin 2 te përkufizimet. Te përkufizimi vendbanim fjala përgjithmonë në fund të tekstit duhet të zëvendësohet me një fjalë tjetër më adekuate apo më të qëlluar.

Po ashtu prapë te përkufizimet. Te përkufizimi i regjistri i banimit teksti duhet të korrigjohet apo të riformulohet të jetë më i kuptueshëm sepse fjalia e fundit është fare e pakuptimtë.

Neni 5 pikë 3 që u tha edhe nga parafolësi. Ku thuhet se qytetari më i vjetër se 16 vjet që sipas dispozitave të tjera ka fituar të drejtën e punësimit duhet të lajmërohet dhe çlajmërohet vetë. Mendoj më mirë do të ishte të jetë mosha më e vjetër se 18 vjet sepse

16 vjeçar është i mitur të lajmërohet dhe të çlajmërohet pa prezencën e prindit apo kujdestarit.

Dhe në neni 7 pikë 1 thuhet. Nëse organi kompetent dyshon se qytetari vazhdimisht banon në vendin ku ai e ka lajmëruar vendbanimin, fillon procedurë për përcaktimin e vendbanimit të vërtetë. Mendoj se nëse qytetari e ka paraqitë vendbanimin nuk ka nevojë të filloj procedura për përcaktim. Por këtu një pjesë e mohimit ia ka ndërruar kuptimin tekstit. Besoj se këtë do ta ketë parasysh komisioni funksional gjatë amendamentimit.

Projektligjin e përkrah në parim dhe do të votoj për procedim të mëtutjeshëm. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit Fjalën e ka deputeti Milazim Haliti, le të përgatitet deputeti Nexhat Rexha.

DEPUTETI MILAZIM HALITI – Faleminderit kryetar, të nderuar ministra të nderuar kolegë deputetë. Projektligji për vendbanimin dhe vendqëndrimin i propozuar nga Ministria për Punë të Brendshme është i rëndësishëm dhe ka për qëllim që të rregullojë çështjet që kanë të bëjnë me procedurën e lajmërimit, çlajmërimit të vendbanimit dhe vendqëndrimit të qytetarëve, ndërrimin e adresës së banimit dhe mbajtjen e evidencës së tyre.

Ky Projektligj ka strukturën e duhur ligjore dhe është në interes të përgjegjshëm për qytetarët e Kosovës, në këtë Projektligj eliminohet vakumi ligjor që ka qenë në Kosovën e pasluftës sepse nuk zbatoheshin fare këto procedura ndërsa në këtë Projektligj do të krijohen kushte dhe obligime për zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë këtë lëmi.

Gjithashtu parashihet procedura për lajmërimin çlajmërimin e vendbanimit dhe e vendqëndrimit si dhe obligimet e qiradhënësit që ta lajmërojnë mysafirin në organin kompetent pastaj ndërrimi i adresës së banimit metodologjia e mbajtjes së të dhënave, mbajtja e regjistrit të vendbanimit etj.

Përkundër vlerësimit pozitiv për Projektligjin në fjalë ky Projektligj nuk është pa vërejtje por besoj se gjatë fazës së amendamentimit komisioni funksional duhet të ketë parasysh në riformulimin e disa neneve që të bëhen më kuptimplota dhe bëjnë përshtatjen e terminologjisë juridike me qëllim që të mos ketë konfuzion gjatë implementimit të tij.

Unë po theksoj disa nga vërejtjet e mia te neni 6 paragrafi 5 ku thuhet Organi kompetent vërteton saktësinë e adresës në të cilën qytetari paraqitet në regjistrin përkatës kurse në rastin e lajmërimit të vendbanimit dhe ndërrimit të adresës së të huajve edhe vlefshmërinë e lejes për qëndrim të përhershëm në Kosovë mbaron paragrafi që nevojitet një riformulim i këtij neni më adekuat sepse nuk e ka kuptimin e duhur.

Pastaj neni 9, paragrafi 9 ku thuhet dispozitat e këtij ligji nuk përdoren, fjala përdoren për lajmërimin respektivisht lajmërimin e qytetarëve.

Si dhe neni 10, paragrafi 6 thuhet: për lajmërimin e vendqëndrimit përdoren dispozitat nga neni 5 dhe 6 i këtij ligji. Në këto raste që u përmendën por edhe në raste të tjera duhet të jetë terminologjia adekuate juridike, sepse për dispozitat ligjore nuk thuhet përdoren por ato zbatohen, vlejné ose aplikohen.

Edhe te neni 14 po ashtu edhe neni 16 paragrafi 2 duhet të bëhen riformulime me qëllim të kuptimit më të mirë të këtyre neneve.

Përkundër vërejtjeve të theksuara unë e mbështes në parim miratimin e këtij Projektligji duke pasur parasysh se vërejtjet e përmendura do t'i ketë në konsideratë komisioni funksional gjatë procedurës së mëtutjeshme të amendamentimit të Projektligjit në fjalë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Nexhat Rexha, le të përgatitet deputetja Teuta Sahatqija.

DEPUTETI NEXHAT REXHA – I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë. Rëndësia e këtij Projektligji është domosdoshmëri e kahershme për të ruajtur dhe mbikëqyrë qytetarin tonë në shumë aspekte.

Projektligji për vendbanimin dhe vendqëndrimin përmban në vete 29 nene në të cilat janë shtruar nevojat dhe kërkesat për qytetarët që jetojnë në Kosovë dhe ata që kalojnë një pushim apo ndërrim vendbanimi në Kosovë. Mirëpo ka nevojë që në punën e mëtutjeshme disa nene të punohen edhe më mirë, për shembull.

Neni 7 pika 7.4 nuk qartëson përmbajtjen e vet, pikërisht çështja e ndihmave materiale për qytetarin e Kosovës kërkon saktësi më të madhe për vendbanimin dhe vendqëndrimin e tij.

Neni 9 pika 9.3 edhe këtu nuk është qartësuar sa duhet qëllimi i kësaj pike por Komisioni përkatës që do të merret me punën e mëtutjeshme ka për obligim që të qartësojmë më saktë qëllimin e tij.

Pastaj neni 13 pika 13.5 është përdorë fjala shkatërroj, konsideroj se duhet të zëvendësohet me ndonjë fjalë tjetër p. sh. arkivoj apo ruajë për një afat të caktuar dokumentin në fjalë.

Në të gjitha këto 29 nene janë paraqitur nevojat e qytetarëve dhe obligimet e tyre për plotësimin e dokumentacionit përkatës por është e nevojshme që të shtohet edhe ndonjë nen lidhur me hyrjet daljet kufitare edhe për qytetarët e shteteve të tjera të cilët kalojnë Kosovën nga një pikë doganore në tjetrën edhe brenda një dite.

Do të ishte mirë të saktësohet e drejta e vendbanimit e vendqëndrimit të qytetarëve tanë, fëmijët e të cilëve kanë lindur në shtetet tjera sepse okupimi i Kosovës në të kaluarën ka ndikuar që shumë qytetarë tanë të marrin shtetësinë në shtetin ku punojnë ata. Krejt kjo është bërë me qëllim që të ikin dhunës që ushtrohej nga Serbia kur ata vinë në Kosovë.

Do të ishte mirë që në këtë shtresë të qytetarëve të Kosovës atyre të cilët vinë në Kosovë të mos konsiderohen si qytetar të huaj. Pra marrë në tërësi Projektligjin për vendbanimin dhe vendqëndrimin është punuar mirë dhe unë e përkrah në parim. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija, se të përgatitet deputeti Fetah Brisha,

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA - Ju faleminderit zoti kryetar, projektligji apo ligji i ardhshëm për vendbanim apo vendqëndrim është një ligj i cili është i nevojshëm në rrugën e Kosovës kah shtetësia, për shumë aspekte të këtij ligji, kolegët e mijë të nderuar deputet ish prehen nga aspektet e ndryshme vërejtjet e tyre dhe mendimet e tyre të lidhura me këtë ligj. Por mendoj që ka mbet edhe një çështje e cila deri tani nuk u cekë dhe nuk u shtjellua gjatë shqyrtimit të parë të këtij projektligji. Duke pasur parasysh që te ne ekzistojnë një numër i njerëzve të cilët kanë vendbanim diku, dhe kanë vendqëndrim diku tjetër, por prej këtyre njerëzve ekzistojnë ata të cilët në mënyrë të vullnetshme, me vullnet të tyre e kanë zgjedhë vendqëndrimin tjetër prej vendbanimit, por duke pasur parasysh ngjarjet të cilat kanë ndikuar që një numër i njerëzve, të ketë një vendqëndrim tjetër prej atij vendbanimi, por jo në mënyrë të vullnetshme, po të cilët kanë qenë të detyruar të qëndrojnë në një vend tjetër duhet që edhe këta njerëz të kenë vendin e tyre dhe çështje e këtyre të rregullohet me ligj.

Këta qytetarë të Kosovës, janë qytetarë të cilët janë të zhvendosur brenda Kosovës, por ka edhe të tillë që janë të zhvendosur dhe jetojnë jashtë Kosovës. Njeri prej rasteve të shumta, është edhe çështja e veriut të Kosovës, e shqiptarëve të cilët jetojnë aty dhe të cilët janë të detyruar që vendqëndrimin e tyre mos ta kenë aty ku jetojnë, po të jenë të zhvendosur dhe të jetojnë në kushte jo të mira, në vendet tjera në jug apo tjerë. Përveç atyre është edhe një numër tjetër i qytetarëve të Kosovës, të cilët janë në këtë gjendje.

Prandaj në Komisionin FunkSIONAL do të mbetet që për hir të normalizimit dhe funksionimit të bazë ligjore të jetës së Kosovës, të kihet parasysh edhe kjo kategori i njerëzve, në mënyrë që të rregullohet sa më mirë kjo çështje. Duhet të dimë që, vendet në rajon të cilat e kanë kaluar një histori të ngjashme, këtë çështje e kanë të rregulluar me këtë ligj, prandaj, do të kishte qenë e arsyeshme që Komisioni FunkSIONAL, ta ketë parasysh këtë dhe ta rregulloj. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, le të përgatitet deputetja Naxhije Doçi,

DEPUTETI, FETAH BERISHA – I nderuari zoti kryetar, te nderuar ju dy ministra që jeni këtu, te çmuar kolegë deputet, nderime për ju që e përcillni këtë seancë. Është meritë e Parlamentit tonë, i cili deri tani ka aprovuar në porim një varg projektligjesh me të cilat rregullohen fusha të ndryshme veprimi, në lëmin e legjislacionit, që Kosova ka nevojë, edhe në këtë fazë të krijimit të sajë shtet i pavarur.

Edhe Projektligji për vendbanimin dhe vendqëndrimin e përpiluar nga dhe paraqitur nga Ministria e Punëve të Brendshme, i ngjitet këtij vargu e të cilin po e shqyrtojmë sot në këtë seancë.

Ministria e Punëve të Brendshme, edhe me prezantimin e këtij Projektligji po dëshmon për sukseset e arritura brenda kësaj kohe të shkurtër nga themelimi i saj. Ky Projektligj gjithsesi ka lidhshmëri edhe me ligjin për familje, ligjin për numrin personal, ligjin për lejen e njoftimit, ligjin për gjendjen civile etj.

Po ashtu, ky projektligj është i një rëndësie e nevojë të veçantë, për Kosovën sepse, eliminon një vakum ligjor dhe ofron zgjidhje mjaftë të avancuar, në lëmin e legjislativitetit të Kosovës. Në këtë projektligj, në 5. kapitujt e tij, bëhet rregullimi ligjor, i lajmërimit dhe çlajmërimit i vendbanimit, ndërrimi i adresës së banimit, bëhet mënyra e lajmërimit, definohen procedurat për lajmërimin dhe çlajmërimin, e vendbanimit dhe vendqëndrimin, të qytetarëve të Kosovës dhe të tjerëve.

Pra qëllimi i këtij projektligji është që, të krijoj stabilitet legjislativ brenda kornizës që ai e rregullon, për interesimin e përgjithshëm të popullit të Kosovës, mirëpo, ky projektligj nuk është plotësisht i përsosur, me gjithë përpjekjet e përpiluara që të jetë i tillë, me gjithë përvojën e të tjerëve si ato shpesh dhe përpjekjet që të ketë përputhje me parimet e Bashkësisë evropiane. Unë nuk do të përsëris ato që u thanë na parafolësit, por do të them se ky projektligj, duhet të përpunohet e të përsoset, sidomos kur kalon nëpër filtrin e mendimeve të Komisionit funksional dhe ekspertëve të kësaj lëmie, e të ngjeshën fjalitë më thukët në mënyrë që të jenë më të kuptimshme, pra ka nevojë për riformulime. Gjithashtu, më thotë mendja se, ky ligj duhet të begatohet, edhe me udhëzime administrative, të cilat do të mundësojnë aplikimin e tij me më sukses, megjithatë, unë japë pëlqimin që ky projektligj, të aprovohet në parim nga Kuvendi ynë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Naxhije Doçi, diskutuesi i fundit për këtë ligj, urdhëroni

DEPUTETJA, NAXHIJE DOÇI – Ju faleminderit zotëri kryetar, i nderuari kryetar, i parlamentit të Kosovës, zoti Kolë Berisha, të nderuar ministra, kolegë të nderuar deputet dhe të gjithë ju të pranishëm në sallë!

Projektligji për vendbanimin dhe vendqëndrimin, është i një rëndësie të dalluar tek ne në Kosovë, ngase e kultivon kulturën dhe mirësjelljen tonë qytetare, për respektim të obligimeve legjislative, kur është fjala për lajmërim të ndërrimit të vendbanimit, ndërrimit të adresës së banimit, si edhe të zhvendosjes nga një lagje në tjetrën. I njëjti obligim vlen edhe për të kundërtën e lajmërimit, pra për çlajmërimin e vendbanimit, atëherë kur qytetari i Kosovës për arsye të ndryshme shpërngulet për afat të pacaktuar nga Kosova. Një lëvizje e tillë e njerëzve për ndërrim të vendbanimit është e kuptueshme dhe e tolerueshme gjithkund të botë, kur respektohen të drejtat qytetare dhe njerëzore, ngase çdo qytetar i çdo vendi duhet ta ndiejë vetën të lirë, që ta zgjedhë vendbanimin ku mund të arrijë më shumë për vete, por edhe ku mund të kontribuojë më shumë për familjen dhe përgjithësisht për shoqërinë e vendit të vetë e edhe më gjerë.

Problemi krijohet vetëm nëse qytetari, nuk e lajmëron si dhe nuk e s'lajmëron, institucionin e vetë kompetent në vendin e vetë, për veprimet që i bënë në këtë aspekt, e që në fakt, ky institucion është Ministria e Punëve të Brendshme, pra obligimi i tij është që, ta japë adresën e saktë, si dhe të dhënat e tjera të nevojshme dhe të sakta. Sa i përket rregullativit për çështje të tilla në Kosovë, deri tani ka pasur mangësi të shumta legislative, të cilat mangësi me siguri që do të eliminohen në masë të duhur, me finalizimin e këtij projektligji si edhe me funksionalizimin e tij në praktikë. Në mungesë të ligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin, shumë qytetarë të Kosovës e kanë bërë ndërrimin e vendbanimit nëpër kohë të ndryshme dhe të rënda për ne, por ngase nuk kanë ditur se ku të orientohen, për tu informua nuk e kanë lajmëruar dhe çlajmëruar ndërrimin e kohë dhe kjo pastaj ju ka shkaktuar probleme të ndryshme dhe të shumta si atyre, ashtu edhe të tjerëve që kanë qenë të obliguar për tu marrë me çështje të tilla.

Në këtë projektligj që ka 5 kapituj dhe 29 nene janë përcaktuar rregullat ligjore edhe për vendqëndrimin e qytetarëve në një vend të caktuar e që nuk mund të jetë në afat më të gjatë se një vit dhe që për vazhdimin e mëtutjeshëm të vendqëndrimit, duhet përtrirë pa tjetër lajmërimin ose duhet bërë çlajmërimin e ti. Detyrimin për këtë e ka vetë qytetari, por edhe qiradhënësi ku është vendosur për vendqëndrim qytetari.

Në nenin 2. ku bëhet fjalë për objektet turistike hoteliere, përmenden edhe kasollet, respektivisht stanet për fjetje dhe që më tutje në nenin 9.9, sikur kundërshtohet paraprakja e thënë, si në vijim: Dispozitat e këtij ligji, nuk përdoren për lajmërim respektivisht për çlajmërimin e qytetarëve, të pranuar për fjetje apo për pushim, në kasolle bjeshkore, apo në stane. Mendoj se ky ligj duhet vlejë edhe për këto bujtina bjeshkore, sidomos kur kemi të bëjmë me turistë të mundshëm të huaj, të cilët duhet lajmëruar gjithsesi në organet kompetente, ndër të tjera dhe për çështje sigurie, të natyrave të ndryshme për ta edhe për vendin.

Këtë e them me mendimin dhe me bindjen e plotë, ngase zhvillimi i Kosovës do të përfshinë në planin zhvillimor, si ndër hapat paqësor të saj edhe turizmin malor, që ka munguar për herë si organizim i nevojshëm tek ne. Rëndësia e organizimit dhe e vlerësimit meritator të kasolleve bjeshkore do të jetë një lloj i veçantë i turizmit dobiprurës për ne. Prandaj mbi bazën e kësaj kisha propozua një nen të veçantë për organizim sa më të mirë të kësaj veprimtarie.

Në fund po them se, Ministria e Punëve të Brendshme dhe grupi punues, që na kanë ofruar në këtë Kuvend të nderuar, këtë projektligj me vlerësim, për vlerësim dhe për miratim, kanë bërë një punë të qëlluar, si dhe kanë kryer një obligim të vetin të domosdoshëm, për qytetarët dhe përgjithësisht për Kosovën. Ky projektligj është në harmoni me ligjet në rajon dhe është sipas modelit slloven dhe në harmoni me kornizën kushtetuese. Mirëpo, nuk mund të le pa cekur se ky projektligj, krahas të mirave që ka, ka edhe gabime të shumta gjuhësore dhe teknike. Mendoj se grupi punues para se t'ia jepte dorën e fundit dhe para se ta bënte shumëzimin, duhej që të ja kishte dhënë një lektori, që ta redakttoj dhe ta lekturoj, e jo të na sjellë me këto gabime të shumta dhe ky nuk është

projektligji i vetëm kësi soji dhe do të thoja se të rrallë janë projektligjet që i janë ofruar këtij parlament, që ishin me përgatitje meritore, gjuhësore dhe teknike.

Konkretisht pos gabimeve të tjera p.sh. fjala çlajmërim, nuk duhet shkruar me ç, të ndarë të ndarë me apostrof, por duhet shkruar ngjitur, por si fjalë e lidhë, çlidhë, lodhë, çlodhë, mbledhë, çmbledhë, vendos, zhvendos, që janë fjalë me kuptime të kundërta, por që shkruhen ngjitas. Kur është fjala nuk do të ndalem në atë që të sqaroj cilat fjalë përdoren me apostrof, p.sh. Kur e kanë ç, përpara se shpenzohet shumë kohë dhe do ta lëmë për herët tjera. kur është fjala për dispozitat ndëshkuese neni 20, dënimi me gjobë 500 € deri në 1500 € është dhënë në mënyrë përgjithësuese për ata që nuk i lajmërojnë mysafirët, kujtoj se duhet bërë dallim për mysafirët, kujtoj se duhet bërë dallim për mysafirët nëpër hotele me qiradhënesit për banim të studentëve, të nxënësve si dhe të tjerëve me kushte të njëjta, se edhe është gjobë e madhe.

Mendoj se pas këtij neni duhet shtuar një pikë për këtë çështje, për ta precizuar në mënyrë të qartë dallimin. Në fund e përkrahë në parim këtë projektligj me mendimin se Komisioni funksional do të merr parasysh vërejtjet e dhëna. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI KOLË BERISHA- ju faleminderit, meqenëse nuk ka kandidat të interesuar më për diskutim shkojmë në votim, në parim të ligjit në tërësi,

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim,
Votojmë tash:

Për.....	73
Kundër.....	0
Abstenim.....	3

Me 73 vota për, 0 vota kundër, dhe 3 abstenime kalon në parim Projektligji për vendbanimin dhe vendqëndrimin.

Konstatohet se aprovohet ose miratohet ky ligj, në bazë të rregullës 23, pika 7 dhe rregullës 35 pika 4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për siguri, si Komision Funksional referues,
2. Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë kushtetuese,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj, nga shqyrtimi i parë Kuvendit duhet ti paraqesin raportin me rekomandime. Ju faleminderit.

Pauzë dreke deri në ora 2,00

KRYESUESI SABRI HAMITI – I lus deputetët që të ulen në vendet e veta.
Kolegë të nderuar vazhdojmë punën në seancë, në rend e kemi pikën e pestë të rendit të ditës

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor.

Projektligji i është shpërndarë deputetëve me 19 shkurt 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. E ftoj zëvendësministrin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor z. Merxhan Avdyli, që në emër të Qeverisë të Kosovës ta paraqes Ligjin para deputetëve. Urdhëro Merxhan.

MERGJAN AVDYLI, ZËVENDËSMINISTËR – I nderuari Kryesues, të nderuar deputetë.

Meqë Ligji për Planifikim Hapësinor i miratuar në shtator të vitit 2003 janë vërejtur lëshime, mangësi dhe vështirësi që kanë ndikuar drejtpërdrejtë në funksionalizmin dhe zbatimin e tij, grupi punues ndërministror i udhëhequr nga ekspertët e MMP-së ka arritur të hartoj Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikim hapësinor.

Grupi punues i cili e ka pasur për detyrë ta hartojë këtë Projektligj, pasi ka arritur të identifikojë mangësitë ligjore në funksionimin dhe zbatimin e Ligjit për planifikim hapësinor ka vlerësuar se ndryshimet dhe plotësimet që do t'i bëhen Ligjit për Planifikim Hapësinor do të ndikojnë në sqarimin dhe qartësimin e përgjegjësive të pushtetit të nivelit qendror dhe të atij lokal.

Duke u bazuar në funksionin e rregullimit më të mirë të planifikimit hapësinor, disa nga dispozitat e Ligjit të planifikimit hapësinor, i cili është ende në fuqi, janë plotësuar, disa nga ato janë ndryshuar, disa dispozita të tjera janë shtuar për të hequr fare disa.

Kështu ndryshimet dhe plotësimet më esenciale që i janë bërë ligjit për planifikim hapësinor e të cilat do të ndikojnë në zbatimin e këtij Projektligji që po paraqitet sot para jush për, të nderuar deputetë janë si vijon:

- është ndryshuar emërtimi dhe përmbajtja e nenit 1, meqë lënda e rregullimit të Ligjit nuk ishte përshkrim përkatës dhe nuk ishte i përkufizuar qëllimi i ligjit,
- te neni 6 janë shtuar tre paragrafë të cilët e plotësojnë këtë nen. Është definuar përbërja e anëtarëve të Këshillit të ekspertëve në nivel lokal. Janë përshkruar detyrat e Këshillit, si dhe është lejuar mundësia e formimit të një Këshilli të tillë të përbashkët për disa komuna,
- te neni 7 është propozuar që Kuvendi i Kosovës ta formoj Këshillin për planifikim hapësinor me propozimin e Qeverisë me ç'rast do të shfuqizojë nenin ekzistues sipas të cilit Qeveria e Kosovës e formon këtë këshill. Gjithashtu

është definuar se kush mund të jetë anëtar i Këshillit për Planifikim Hapësinor në nivel qendror,

- te neni 8 është ndryshuar paragrafi 8.3 i cili ka të bëjë me provimin profesional në fushën e planifikimit hapësinor,
- te neni 13 është ndryshuar dhe është zgjatur afati për planin zhvillimor të komunës për dhënien e pëlqimeve prej 15 ditësh sa ka qenë në 30 sa është propozuar tani,
- te neni 14 është shtuar paragrafi sipas të cilit, para se të miratohet plani zhvillimor urban duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit publik,
- te neni 16, paragrafi 16.4, nën pikën a) me ndryshim është qartësuar se qeveria e bënë propozimin për marrjen e vendimit për hartimin e Planit hapësinor të Kosovës dhe planeve hapësinore për zonat e veçanta, ndërsa Kuvendi i Kosovës e bënë miratimin përfundimtar të planit. Për planet e nivelit komunal propozimin e bënë organi kompetent komunal për çështjet e planifikimit hapësinor, kurse miratimin e bënë Kuvendi i Komunës. Neni 16 i është shtuar edhe paragrafi 16.6 sipas të cilit iniciativën për hartimin e planit rregullues urban mund ta marrin edhe personat fizik apo juridik të cilët kanë interes për shfrytëzimin e territorit që do të përfshijë plani,
- te neni 22 shtohet një paragraf për trajtimin e vendbanimeve jo formale sipas të cilit komunat detyrohen, bazuar në llojin e planit të përfshijnë edhe trajtojnë vendbanimet joformale me qëllim të rregullimit të tyre,
- te neni 24 me ndryshim të ligjit është përcaktuar se çka do të përfshijnë kushtet e përkohshme për rregullimin e hapësirës si dhe obligimin që kushtet e përkohshme për rregullimin e hapësirës të inkorporohen në planin rregullues urban përkatës,
- te neni 26 është propozuar të shtohet një paragraf sipas të cilit me akt të veçantë nënligjor do të përcaktohen objektet me rëndësi për Kosovën, për të cilat Ministria do të lëshoj lejen urbanistike. Objektet e tilla janë definuar sipas Ligjit për ndërtimin për të cilat, gjithashtu lejen ndërtimore e lëshon Ministria,
- te neni 32, afati për hartimin e planeve komunale e jo për aprovimin e tyre siç është paraparë në nenin ekzistues, në të vërtetë siç ka qenë, është zgjatur edhe për 18 muaj, është hequr dispozita për hartimin e planeve të nivelit komunal nga ana e Ministrisë, dhe
- te neni 34 është paraparë që Qeveria e Kosovës dhe Ministria të nxjerrin akte nënligjore dhe të harmonizojnë aktet ekzistuese të nxjerra më së voni brenda afatit prej 6 muajsh prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij Projektligji.

Të nderuar deputetë,

Këto ishin ndryshimet dhe plotësimet më kryesore të Ligjit për Planifikim Hapësinor, ndryshimet dhe plotësimet të cilat janë të parapara në 19 nenet e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Planifikimin hapësinor, i cili pas miratimit nga ana e juaj do ta komplettojë duke i bërë më funksional dhe të zbatueshëm në praktikë Ligjin për Planifikimin Hapësinor.

Duke konsideruar të plotë edhe në aspektin procedural përfshirë edhe koston e shpenzimeve si dhe të të hyrave të paraqitura në formularë për vlerësimin e ndikimit financiar i cili bazohet në zgjidhjen e problemit të vendbanimeve joformale si dhe në lëshimin e lejeve urbanistike për objektet me rëndësi për Kosovën, Projektligjin për ndryshime dhe plotësimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor e konsiderojmë të miratueshëm nga ana e Kuvendit të Kosovës. Respekt për vëmendjen tuaj.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. zëvendësministër. Do të fillojmë diskutimin në parim të këtij Projektligji. Unë këtu kam të avancuar disa emra, por unë nuk e di a janë në emër të grupeve parlamentare, unë thërras Grupin parlamentar të LDK-së që të ... Shaban Halimi e ka fjalën.

DEPUTETI SHABAN HALIMI – Ju faleminderit z. Kryesues, të nderuar kolegë deputetë, Ligjin për të cilin e kemi fjalën me memorandumun shpjegues për arsyet e plotësimit dhe të ndryshimit të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike konsideron se janë të arsyeshme, veçantë kur kemi parasysh vërejtjet dhe sugjerimet që janë dhënë nga pushtetet lokale të cilat janë drejtpërsëdrejti implementuese të këtij ligji, dhe këto vërejtje dhe sugjerime nga ana e pushteteve lokale janë marrë parasysh, gjithashtu dhe e dhëna e dytë për rregullimin e vendbanimeve jo formale, çështje e cila po ashtu do të sjellë të hyra për buxhetet e pushteteve lokale. Prandaj, duke pasur parasysh këto dhe ndryshimet në tërësi të këtij ligji Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike jep votën e vet pro Ligjit në lexim të parë me qëllim që t'i hapet rruga në procedim të mëtejshëm në komisionet funksionale ku edhe do të plotësohet më mirë. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI- Ju faleminderit z. Halimi. Në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës fjalën e merr Selvije Halimi

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI - Ju faleminderit z. Kryesues, të nderuar deputetë. Ndoshta është mirë që Qeveria e Kosovës të fillojë me një praktikë të re, dhe kur bënë propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të cilat janë në fuqi, të aprovuara nga Kuvendi të paraqet së pari një raport se, pse duhet të ndryshohen ligjet dhe dëmet që janë shkaktuar me ligjin aktual për shembull siç është rasti me Ligjin e Planifikimit hapësinor, dëmet që i janë shkaktuar Kosovës, gjegjësisht qytetarëve me ligjet e aprovuara pa një profesionalizëm të duhur.

Sa i përket propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor, kryesisht përmbajtja e plotësimit që ka të bëjë me rregullimin e hapësirave gjegjësisht me trajtimin e vendbanimeve jo formale, është më se e domosdoshme dhe mund të themi se jemi edhe të vonuar.

Është shqetësuese kostoja financiare ku me arsyeshmëri jepet një përgjigje nga Qeveria e Kosovës, se për këtë Projektligj do të sigurohen mjete në donacion në vlerën prej 12 milionë euro duke startuar për vitin 2007 - 2 dy milion euro të cilat parashihen. Është diçka tjetër të thuhet parashihen se do t'i kemi e diçka tjetër kur ki mjetet, kurse në buxhetin e vitit 2007 nuk ka mjete të ndara për këtë pozicion.

Çështje tjetër të cilat unë do t'i paraqesë shqetësimet e mija dhe të Grupit parlamentar lidhur me propozimet për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji, ka të bëjë me arsyeshmërinë. Ky ligj tashmë i bënë katër vite që është në fuqi dhe vetëm pas katër viteve Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e pa të arsyeshme të kërkoj ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji duke u thirrur se disa dispozita të ligjit në fjalë paskan qenë pengesë në implementimin e ligjit, gjë që nuk është e vërtetë. Kjo arsyeshmëri nuk është asgjë tjetër vetëm është një tendencë për të bërë amnestimin e kaosit urbanistik në të gjithë qytetet e Kosovës duke fajësuar ligjin të cilin vetë e kanë sponsorizuar dhe Kuvendi e ka aprovuar.

Çështje tjetër, e që duhet të përmbaj ligji me qëllim që të mos paraqiten prapë arsyeshmëri se dispozitat po bëkan pengimin e zbatimit të ligjit, dispozitat nuk bëjnë pengim, sepse ato dispozita të cilat nuk kanë bërë pengim ato janë shkel nga vetë Qeveria dhe institucionet tjera përcjellëse. Është, kur ka të bëjë se, kërkohet të shtohet një nen, gjegjësisht paragraf ku i jepet Ministrisë e drejta që me akt nënligjor të caktoj objektet me rëndësi të veçantë për Kosovën në mënyrë që të marrë të drejtën për të dhënë lejet urbanistike dhe lejet ndërtimore. Këtu kemi një konflikt interesi me Ligjin për ndërtimin.

Andaj, për të sqaruar dhe të mos kemi një konfuzitet në të cilin ligj duhet të thirremi dhe për ta lënë gjithmonë fajin pa adresë të përgjegjësisë, unë mendoj se në këtë ligj duhet të hyjnë kriteret, çfarë kritere duhet të plotësoj një objekt i cili mund të konsiderohet se është me rëndësi të veçantë për Kosovën dhe leja urbanistike çfarë interesa prekë më pastaj leja ndërtimore duhet të bie në komunën përkatëse ku ai objekt ndërtohet, e jo të shkaktohet një konfuzitet.

Çështje tjetër është një diçka shumë shqetësuese ku te neni 2 te përkufizimet në gjuhën angleze hyn edhe fjalia për parkun nacional, kurse në gjuhën shqipe nuk kemi, kjo hynë aty te pjesa ku bëhen ndryshimi për planin hapësinor, nënkupton planin për rregullimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin e hapësirës siç është territori i komunës, zonës së veçantë dhe territorit të Kosovës.

Në gjuhën angleze e kemi edhe shprehjen: Nacional park që do të thotë Parku nacional kurse në gjuhën shqipe nuk është. Unë mendoj se edhe praktika që është bërë deri sot kur kemi mospërputhshmëri mes gjuhës atëherë merret gjithmonë shprehja që është në

gjuhën angleze. Unë mendoj se duhet të kemi shumë kujdes në gjëra të tilla nga se këto mund të merren edhe si tendencioze me apo pa qëllim të sponsoruesit, me apo pa qëllim të përkthyesve.

Sa i përket ndarjes së përgjegjësive në nivelet lokale dhe nivelet qendrore. Edhe një here e potencojë: dispozitat e ligjit që nuk janë aplikuar deri sot dhe ndryshimet dhe plotësimet që kërkohen të bëhen janë të mirëseardhura, mirëpo nuk mund të amnistojnë shkeljen e ligjit, gjegjësisht moszbatimin e tij deri tash dhe kemi rezultuar me kaos në dëm të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe në dëm të të gjitha grupeve të interesit. Pa i cekur këto edhe disa gabime të shprehjeve dhe të përkufizimeve në aspektin profesional. Në parim i përkrahim ndryshimet dhe besoj se nuk do të lejojmë lëshime të tilla. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. Deputet Halimi. Fjalën e merr Mazllom Kumnova në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA – Z. Kryesuesi Ju faleminderit. Grupi i AAK-së në këtë Kuvend e ka mirëpritur angazhimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor, Ligj i miratuar nga ky Kuvend para katër vite, i cili në rrethanat e atëhershme pretendonte ta rregullonte mjaft çështjen në fushën e planifikimit hapësinor, por njëkohësisht këto pretendime mbetën të shkëputura dhe jo të zbatueshme.

Shumë dispozita të këtij ligji sidomos niveli komunal i qeverisjes për shumë arsye nuk tregoj gatishmëri për të pranuar dhe zbatuar, ndërsa në nivelin qendror nuk rregullonte probleme sidomos të vendbanimeve joformale, lejeve të ndërtimit për objekte me rëndësi të veçantë, ndarja e përgjegjësive të nivelit qendror dhe atij komunal e të tjera. Ne, mendojmë se duhet veçuar dy arsye, përse duhet përkrahur këto ndryshime, plotësime dhe përmirësime të këtij ligji.

E para është se me dokumentet që i kemi sot në dorë ka pretendime serioze të rregullohet çështja e vendbanimeve joformale, çështje e cila është mjaftë e diskutueshme dhe për shumë arsye mbi të gjitha ligjore ka mbetur e pezulluar, po ashtu në leximin e parë këto ndryshime të ligjit kanë një kosto financiare që e ngarkon buxhetin e Kosovës, parametrave të janë orientues, mirëpo ne pajtohemi me propozuesin e këtij Projektligji se çështja e vendbanimeve joformale kërkon një trajtim serioz, por edhe që kushton.

Grup jonë mendon se çmimi papërbalueshëm për buxhetin e Kosovës mund të zgjidhet ashtu si është propozuar për një periudhë të caktuar katër ose shtatë vjet, si dhe mundësia për marrjen e donacioneve të huaja çfarë është edhe një mundësi shumë reale. Padyshim ne si Kuvend nuk kemi pasur rast që të debatojmë për vendbanimet joformale, që është një problem i pashmangshëm. Më sa e di unë, nuk kemi një studim të tillë, nëse e ka Ministria është mirë që ta ngremë këtë çështje një ditë në një kohë të caktuar sepse, si problem reflekton edhe në ligjet tjera të atij të ndërtimit, ndërtimit pa leje, çështja e pronës e shumë çështje tjera.

E dyta, Ligji ekzistues nuk ka rregulluar drejt dhe qartë përgjegjësitë e nivelit qendror dhe atij komunal në fushën e planifikimit hapësinor, prandaj edhe dështimet ngecin, abuzimet që bëhen në fushën e planifikimit hapësinor, në komuna janë reflektim i mos qartësisë të dispozitave dhe i interpretimit jo të drejtë të tyre, ndërmjet nivelit komunal dhe atij qendror. Qenia jo e mirë e krijuar edhe nga Ligji në fuqi është edhe në fushën e kompetencave për leje ndërtimi për objekte me rëndësi të veçantë. Këtë bazë ligjore jo të qartë, jo të zbatueshëm mirë e kanë shfrytëzuar ndërtuesit pa leje. Mendimi jonë si grup është se edhe kjo çështje është pretenduar të rregullohet me këto ndryshime, plotësime dhe përmirësime të Ligjit ekzistues duke i rrëzuar dispozitat që kanë mundësuar abuzime të ndryshme në planin e rregullimit të territoreve e sidomos në komuna.

Në fund po ashtu definim i Këshillit për planifikimin hapësinor në këtë propozim, që aktualisht na mungon dhe disa çështje tjera që janë përmirësuar në këtë propozim të Ligjit për planifikimit hapësinor të përmirësuar, të ndryshuar dhe të plotësuar e ka bindur Grupin tonë të japim përkrahje përkundër disa vërejtjeve konkrete që do t'i procedojmë në komisione. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. Kumnova. Në emër të Grupit parlamentar ORA, fjalën e merr Gazmend Muhaxheri.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit z. Kryesues. Është praktikë e qeverive të përgjegjshme, që ligjet të cilat kanë zbrazëtira ose edhe mangësi në implementimin e tyre t'i shqyrtojë dhe të propozoj amendamente ose ndryshime të ligjit. Qeveritë që kanë përgjegjësi dhe shohin se nuk mund të aplikohet një ligj, ndër marrin masa që këtë ligj ta ndërrojnë sa më shpejtë. Ligji në fjalë i miratuar në vitin 2003 i obligon komunat e Kosovës, që në afat prej 18 muajsh të nxjerrin planet hapësinore komunale, planet zhvillimore urbane dhe planet rregllative. Deri në këtë moment gati asnjë komunë e Kosovës nuk i ka miratuar këto ligje. Me propozim ndryshimin e ligjit, neni 17 vetëm sa edhe për 18 muajt e ardhshme zgjatet kjo praktikë e mos implementimit të ligjit.

Në ligjin ekzistues neni 33, afatet kohore për përgatitjen e planeve hapësinore, Ministria e ka pasur të paraparë, që nëse komunat nuk i përmbahen afateve kohore për nxjerrjen e këtyre planeve Ministria do të ndërmerr masa dhe do t'i nxjerrë këto plane me parat e komunës. As Ministria nuk e ka zbatuar këtë dispozitë ligjore, mirëpo as komunat nuk ju kanë përmbajtur këtij afati kohor, dhe çka ka ndodhur, kemi parajsë në drejtoritë e urbanizimit që lulëzon korrupsioni në nivel marramendës, sepse në mungesë të hapësirës për ndërtim kemi vullnetarizëm edhe nevojë për ndërtime ku t'i teket dhe ku dëshiron qytetari.

Dëmi është i shumëfishtë; dhe pasojat do të shihen edhe në të ardhmen. Ajo çka është dashur me paraparë ky ndryshim në ligj është edhe ndarja e përgjegjësi në nivelet komunale, të saktësoj qartë se drejtoritë për urbanizëm në nivelin komunal duhet t'i kenë

sektorët e ndarë në mënyrë të qartë: sektorin për respektim të ligjit, planifikim hapësinor dhe sektorin për dhënie të lejes. Nga mos implementimi i kësaj rrjedhë se në drejtoritë për urbanizëm një njeri i cili merret me planifikim mundet edhe të lëshojë leje edhe menjëherë të bie në konflikt të interesave.

Ne si Grup parlamentar jemi që të ndryshohen ligjet, mirëpo Qeveria të jetë më efikase dhe t'i sjellë propozimet për ndryshim në afat shumë më të shkurtër e jo të pres katër vite për me mundur me e zbatuar një ligj. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. Muhaxheri. Ne emër të Grupit 6+ fjalën e ka Xhezair Murati

DEPUTETI XHEZAIR MURATI - Hvala g. Predsedavajući, poštovani kolege. Evo pred nama je po prvi put i Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona kojeg smo usvojili preko 4 godine, i tekst koji nam je stigao i o čitavoj jednoj formi kao da je to neki novi predlog Nacrta zakona.

Obrazloženje da je ovaj Zakon u formi u kojoj bio usvojen bio kočnica njegovor sprovođenja što se zaključuje na osnovu mnogih zahteva opština kako se kaže, tako da su neke njegove odredbe izmenjene ustvari da ih treba izmeniti bio je razlog da se ovo ponovo analizira i razmatra što je dovelo i do toga da se izvrše pripreme, da se on dopuni i izmjeni novim adekvatnim rešenjima koja su ponudjena u formi, ponovo kažem gotovo jednog čitavog novog Nacrta zakona. Obrazloženje ovog predloga je dosta sadržajno i argumentovano i bavi se mnogim detaljima sa ciljem da bude adekvatniji, praktičniji i efikasniji, po gotovu ako se uzme u obzir značanje prostornog i urbanističkog rešenja što je zahtev u kojem mnoge zemlje već imaju dugu tradiciju i praktična rešenja.

Nije mi poznato koliko su uzeta u obzir pozitivna iskustva drugih, sigurno da je moralo da se bude ažurnije kada su u pitanju predlozi da u ovoj formi on izadje mnogo ranije, što su i moji kolege ovaj neki do sada istakli. To primećujemo u svakodnevnom životu i praksa sa kojim smo suočeni na Kosovu u to nas uvjerava, a ako je na bilo kom polju ili u bilo kojoj oblasti potrebna stručnos, objektivnost i izdad svega profesionalnost onda je to upravo oblast urbanističkih i gradjevinskih rešenja. S toga mi u Parlamentarnoj grupi 6+ u načelu se slažemo sa izmjenama ovog zakona ali i sa prelazcima mnogih kmpetencija u ovoj oblasti od opštinsko na nivo Ministarstva sredine i prostornog planiranja.

Na kraju ću navesti da ima dosta jezičkih konfuzija u mom maternjem jeziku bez pravnog značanja nekada i nelogičnih, verovatno bukvalno prevedenih pa se nadam da će se to u nastavku procesuiranja ovog Zakona otkloniti. Hvala vam.

KRYESUESI SABRI HAMITI- Ju faleminderit z Murati. Fjalën e merr deputeti Xhelal Canziba

DEPUTETI XHELAL CANZIBA - I nderuar kryesues, të nderuar kolegë deputetë. Ne e pamë që komunat kanë kërkuar që të ndryshohet Ligji e në realitet nuk di sa ka kërkuar Ministria që të implementohet ky ligj në praktikë ku komunat nuk i kanë kryer detyrat e veta.

Nëse shkojmë në nenin 2, e kemi definicionin e planit hapësinor ku thotë: Nënkupton planin për rregullimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin e hapësirës siç është territori i komunës, zonës së veçantë dhe territorit të Kosovës. Plani hapësinor sipas këtij ligji është Plani Hapësinor i Kosovës. Nëse nenin 2, paragrafi nr. 1 e kemi ripërsëritjen e definicionit. I kemi te përkufizimi në “ngastrën ndërtimore” të zëvendësohet me fjalët “parcela ndërtimore”. Përkufizime shfrytëzimi i tokës, dokumentacioni urbanistik në ngastër kadastrave, sipërfaqe e mbrojtur, zonë e mbrojtur, punët përgatitore si dhe kushtet e ndërtimit fshihen.

Nëse shkojmë më tutje te paragrafi 18, ngastra ndërtimore është tokë e parashikuar për ndërtimin e objekteve të përfshira me plan që përbëhet nga një ose më shumë ngastra kadastrale ose pjesë të tyre, këndeje thotë fshihet ngastra, e këndeje përbëhet prej ma shumë apo ngastrës kadastrale.

Paragrafi 20, vija e rregullimit nënkuptojmë vijën kufizuese në mes të ngastrës – prapë ngastër andej fshihet ngastra. Vija e ndërtimit nënkupton vijën kufizuese, e cila definon se ku është lejuar ndërtimi në ngastrën ndërtimore, atje e kemi fshi ngastrën ndërtimore.

Nëse shkojmë te neni nr. 4, në nenin 6 shtohen edhe këto tri paragrafë: paragrafi 6.4 anëtarët e Këshillit nuk mund të jenë zyrtarë, menaxher, pronarë ose të punësuarit të personit juridik të cilët gjatë kohës së hartimit të planit përkatës do të jenë të angazhuar në plan. Të njëjtin definicion e kemi edhe në nenin 5 që thotë paragrafi 7.4 anëtarët e Këshillit nuk mund të jenë që thotë përsëritet.

I kemi edhe te vendbanimet joformale. I definuar në planin për zbatimin e standardeve për Kosovën, që thotë jo për zbatimin e ligjeve, por për zbatimin e standardeve të Kosovës. Edhe nëse e marrim me standardin e 6 ka të bëjë me pronën, e cila është e pakicave, ndërsa për pronën e shumicës në Kosovë nuk lodhet askush. E dinë që në Kosovë sa reforma agrare ka pasur, sa konfiskime, sa eksproprijime, ndërsa ne kujdesemi vetëm për pronën e pakicës, e për pronën e shumicës nuk kemi nevojë të merremi se shqiptarët kanë hapësirë të mjaftueshme. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. Canziba. Fjalën e merr deputetja Nekibe Kelmendi

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Ju faleminderit z. kryesues. Unë dëgjova këtu shumë arsye të cilat e kanë imponuar që Ministria të iniciojë procedurën për ndryshimin e këtij ligji. Nuk duhet të harrojmë se nuk janë ato arsyet të cilat e kanë shty Qeverinë ta ndryshoj këtë ligj siç janë p.sh. vërejtje e mos zbatueshmërisë së këtij ligji. Arsyet e vërteta janë ato se ngjarjet jetësore gjithmonë zhvillohen dhe ecin para ligjit dhe ligji i përcjellë ngjarjet jetësore dhe u përshtatet atyre, prandaj edhe ligjet nuk janë statike, por

janë të ndryshueshme. Unë në këtë aspekt e shikoj edhe arsyeshmërinë e iniciativës për ndryshimin e këtij ligji që tash po e shqyrtojmë.

Nga ana tjetër, ky ligj në njëfarë mënyre me rregullativat që i ka do ta komplementojë edhe ligjin për shpronësimin, sepse pa pasur plan zhvillimor, urban nuk mund të iniciohet edhe procedura e shpronësimit e ndonjë prone të personit fizik, prone private.

Ajo që më së shumti më ka ra në sy dhe më pelqen në këtë ligj është, se planet zhvillimore urbane sipas nenit 9 duhet të nxirren në debat publik, do të thotë duhet të diskutojnë për këto qytetarët që siguron edhe njëfarë mënyre transparencën në nxjerrjen e planeve zhvillimore urbane dhe për nxjerrjen e vendimeve nga ana e asambleve komunale për t'i miratuar ato plane zhvillimore.

Kjo është një risi që deri me tani qytetarët nuk janë pyetur dhe kjo mi ngjanë një lloj referendumi dhe është shumë pozitive, që mendoj se duhet, kur janë në pyetje rregullimet hapësinore përkatësisht planet zhvillimore në nivel komunash duhet të pyetën qytetarët. Nuk duhet lejuar që për shembull në një mjedis urban të ngritet ndonjë pikë e karburantit apo pompë e benzinës e cila do t'i pengonte të gjithë qytetarët. Prandaj, si deputete në parim e përkrahi këtë ligj, e mbështes këtë ligj dhe konsideroj se ka arsyeshmërinë që të ndryshohet. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI - Kolegë të nderuar meqë nuk ka diskutues të tjerë rreth këtij ligji në lexim të parë, unë e lus regjinë të bëhet gati që ta votojmë në parim. Regjia ju lutem.

Votojmë tash

Për..... 75
Abstenime..... 2

Kalon Ligji në lexim të parë. Vetë t'u jap njoftimin që në bazë të rregullave legjislativë të Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe referues,
2. Komisionin për Çështje Gjyqësore Legjislativë dhe Kornizë Kushtetuese,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisioni duhet që në afatin jo më të gjatë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, t'i paraqesin Kuvendit rekomandimet sipas rregullës.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës që është pika e gjashtë

5. Shqyrtimi i Informatës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit lidhur me përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë

Me kërkesë dhe propozim të Grupit prej 9 deputetëve në pajtim me rregullën 6.5 të Rregullores së punës, Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga kryesuesi i ART-së të përgatisë dhe Kuvendit t'i paraqesë një informatë lidhur me përzgjedhjen e operatorit të telefonisë mobile në Kosovë.

Kërkesa e deputetëve po ashtu edhe informata e kryesuesit të ART-së u është shpërndarë të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Në këto raste ju e dini që i pari duhet ta marrë fjalën ai që e paraqet mocionin, në këtë rast është deputeti Demir Lima që është në krye të listës së deputetëve që e kanë bërë kërkesën.

Nën dy duhet ta marrë fjalën njeriu i cili thirret në këtë rast është kryesuesi i ART-së Anton Berisha, Kuvendi ka në dorë një letër ku kryesuesi i ART-së Berisha thotë që ART konsideron se Qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u kanë kompetencën e raportimit për çështjen në fjalë dhe më tutje shton z. Berisha për sqarimet eventuale në shqyrtimin e Informatës ART, në seancë do të paraqitet z. Lulzim Kurtaj, unë nuk di se a është këtu e nëse është le të thotë se është, unë nuk e di a është, nuk e shohë, anëtar i Bordit Rregullativ të Telekomunikacionit, njëkohësisht udhëheqës i Departamentit të telekomunikacionit dhe kryesues i Komisionit vlerësues për vlerësimin e ofertave, rrush prej funksioneve, tri i paska, po ky njeri nuk është këtu.

Tani sipas rregullit duhet të artikulohet në bazë të këtyre të dyve: deputetëve dhe Qeveria. Unë tani si drejtues i kësaj seance, duke njohur rregullat dhe problemin, kërkoj nga paraqitësi i kërkesës për diskutim.

A pajtohet që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës në seancë tjetër kur do të jetë shefi i ART-së dhe përgjegjësit e resorëve në Qeveri apo do të diskutohet, unë ju pyes juve që keni bërë kërkesën?

Fjalën e ka z. deputeti Demir Lima

DEPUTETI DEMIR LIMA – Ju faleminderit z. kryesues, Unë konsideroj se debati për këtë çështje dhe për këtë pikë të rendit të ditës duhet të debatohet nga deputetët, sepse z. Anton Berisha, kryetar i ART-së nuk është Kuvend i Kosovës, nuk është Qeveri e Kosovës dhe nuk është mbi institucion. Ai e ka pasur një procedurë zyrtare, ka pasur një kërkesë në emër të Grupit të deputetëve për të dhënë një raport lidhur me ecurinë e procesit të përzgjedhjes së operatorit të dytë dhe të nderuar kolegë deputetë, shefin e ART-së z. Anton Berisha e ka zgjedhur ky kuvend dhe është dashur të jetë sot, të paraqitet. Z. Berisha del edhe mbi Qeverinë edhe mbi UNMIK-un edhe mbi Kuvendin dhe nuk ka nevojë z. Berisha të qoj nëpunës civil për Raport për arsye se ai e ka marrë mandatin nga ky Kuvend dhe ai është dashur të jetë këtu së bashku me kryeministrin

Agim Çekun dhe kabinetin qeveritar, kështu që pa u vonuar dhe pa humbur kohë, i nderuari z. kryesues unë do të vazhdoj me hapjen e këtij debati.

E kemi ndërmarrë këtë iniciativë të nderuar kolegë deputetë, iniciativë kjo që është përkrahur nga një numër i konsiderueshëm i deputetëve të këtij Parlamenti. Kjo iniciativë ka për qëllim që Parlamenti i Kosovës, deputetët dhe komisionet përkatëse t'i shfaqin reagimet e veta konform kompetencave që kemi. Po qe se e marrin dhe e analizojmë veprimin e disa agjencive të specializuara qeveritare të pavarura del se ato bindshëm kanë harruar se janë në kuadër të institucioneve tona dhe se ne i kemi themeluar për t'i kryer punët e veçanta në favor të interesit publik.

Sot do të flas konkretisht për ART-në që shpesh na del mbi çdo institucion siç thashë edhe më lart, pra sot do t'i prezantoj analizat e shkeljes në fushën e telefonisë mobile në Kosovë, shkeljen e interesit publik dhe propozime konkrete se si të dilet nga kjo krizë, Kësaj duhet shtuar edhe publikimet e bëra në mediumet e shkruara dhe elektronike që flasin për korruptim të autoritetit të ART-së.

Siç e dimë prej vitit 1999 e këndej as UNMIK-u e as Qeveria e Kosovës e veçanërisht institucioni i ART-së ka dështuar t'i evitojë operatorët ilegalë të Serbisë 063 dhe 064 të cilët me operimin e tyre i kanë shkaktuar dhe i shkaktojnë direkt dhe indirekt dëm të pakrahasueshëm prej miliona eurosh buxhetit të Kosovës si dhe pengojnë operimin dhe zhvillimin e telefonisë së vetme vendore Vala si operator legal i licencuar dhe nga vetë ART-ja.

Më pas shpallet nga ART-ja tenderi për operator të telefonisë mobile të 3 nëntorit 2006, shpallje kjo që u përcoll me vendosjen jo të drejtë të procesit e paqartë, jo transparente dhe në kundërshtim me standardet e Bashkimit Evropian, për çka edhe erdhi edhe deri te anulimi i tij, proces ky që është kundërshtuar nga Qeveria e mëhershme po ashtu kjo kundërshti ishte përkrahur edhe nga PSPP-ja ku pas një auditim të pavarur nga një kompani irlandeze e quajtur HEL ishin gjetur shkelje të rënda ligjore të mjaftueshëm për anulimin e procesit. Për këto dështime të ART-së patën reaguar edhe zyrat e Kuintit në Kosovë ,siç e dini të gjithë ju.

Thyerjet e ligjit gjatë procesit të tenderimit të ART-së gjatë tentativës së dytë. Mos transparenca e brendshme për ofertuesit dhe për publikun, lidhur me identitetin e personave fizik dhe juridik ku për shembull janë vërejtur kombinime antiligjore të një personi fizik apo juridik, për shembull duke konkurruar me dy konsorciume me emra të ndryshëm dhe me pronar e investues të njëjtë. ART për këtë fakt ka dështuar të menaxhoj dhe të evitoj konkurrencën fiktive që është paraqitur dhe jo rastësisht z. Anton Berisha dhe Agim Çeku nuk janë prezentë në këtë debat, në këtë diskutim a për shkak të abuzimeve të bëra.

Ky dështim i ART-së përbënë thellësisht shkelje të nenit 22 të Ligjit të Kuvendit të Kosovës për Telekomunikacionin e Kosovës si dhe shkelje të dokumentit të tenderit, pika 3.1, vetëm një ofertë mund të dorëzohet në tender. Kreu i ART-së duhet t'i

shpjegoj Kuvendit të Kosovës se si ka ndodhur kjo shkelje, pse ka ndodhur, dhe kush është përgjegjës për këtë parregullsi.

ART ka dështuar të menaxhoj një proces të drejtë, të saktë, jo diskriminues dhe përshkrues të përzgjedhjes së licencës në kuptim të nenit 22 dhe 36 të Ligjit mbi Telekomunikacionin e Kosovës. ART ka dështuar apo nuk ka qenë transparente as me ofertuesit dhe as me publikimin për publikimin e rezultateve të vlerësimit ku e ka zgjedhur fituesin e parë, por ma tepër ia ka refuzuar edhe ofertuesve që janë ankuar gjatë procesit. Ky veprim i ART-së përbënë shkelje drastike të parimeve bazë të ekonomisë së hapur, konkurrencës së lirë dhe parimeve demokratike të një shteti.

Kreu i ART-së duhet që Kuvendit të Kosovës t'i ofroj shpjegime të sakta dhe të argumentuara se si dhe pse kanë ndodhur këto lëshime kaq të rënda dhe me pasoja për gjithë procesin. ART ka dështuar, përkatësisht ka shkelur edhe nenin 56 të Ligjit për prokurim publik kur nuk ka bërë një hapje publike të tenderit si kusht dhe kërkesë edhe ligjeve dhe e rregullave të BE-së. Kreu i ART-së gjithashtu duhet të jep shpjegime lidhur me shkeljet e tilla pse dhe si kanë ndodhur.

ART-ja me ligj ka qenë dhe mbetet e obliguar ta arkëtojë taksën prej ofertuesit të përzgjedhur e i cili ka dështuar të paguaj çmimin e licencës. ART-ja ka dështuar, që në emër të dështimit të ofertuesit të parë të arkëtojë pagesën prej miliona eurosh në buxhetin e Kosovës. ART të paktën deri tash nuk ka dhënë prova se ofertuesi përkatës që nuk ka paguar licencën i ka arkëtuar këtë taksë, kreu i ART-së duhet t'i jap shpjegime Kuvendit të Kosovës në lidhje me këtë lëshim të radhës si dhe pse ka ndodhur.

Të nderuar kolegë deputetë,

Këto ishin disa nga shkeljet e ligjit, mirëpo çështje shumë e rëndësishme të shpjegoj është se në ç'masë është dëmtuar interesi publik, buxheti i Kosovës dhe autoriteti i institucioneve tona. Ne e dimë se institucionet e kanë themeluar autoritetin Rregullativ të telekomunikacionit që të sigurojë politikat e mira, konkrete dhe të sigurta që fusha e telekomunikimit, përkatësisht telefonia mobile të zhvillohen mbi themelet bazë të parimeve të ekonomisë së lirë, transparencës për publikun, llogari dhënies dhe sipas standardeve ndërkombëtare edhe evropiane. Me këtë ART-ja gjithë veprimtarinë është e obliguar ta bazojë në kushtet e ligjit, të transparencës së plotë të publikut të Kosovës dhe institucioneve të saja. Duke e parë këtë si interes jetik-strategjik për zhvillimin e ekonomisë së vendit, Kuvendi i Kosovës nuk duhet dhe nuk guxoj që të lejojë që kjo fushë të dështoj në zhvillimin e saj, përkundrazi është obligim themelor i pakontestueshëm që Kuvendi të jetë mirë i informuar dhe ka nevojë të ndërhyjë në këtë proces. Për më tepër Kuvendi ka obligim dhe është në mandatin e tij që t'i garantoj qytetarët e Kosovës që përmes kontrollit parlamentar të Qeverisë dhe segmenteve të saj të ART-së të sigurojë se Qeveria dhe mekanizmat e saj respektojnë ligjin në të gjitha proceset që duhet të zhvillohen rrjedhimisht edhe në procesin e zhvillimit të telekomunikimit të telefonisë mobile në këtë rast.

Të kesh operator të dytë është gjë e mirë dhe komform standardeve të telekomunikimit, sepse konkurrenca krijon vlera, ngritë shkathtësi dhe zbrit çmimin e shërbimeve që shkon në interes të qytetarëve tanë. Këtu ka ndodhur e kundërta, është shkuar me operator të dytë, me një çmim i cili është më i ulët i cili është shumë më i ulët në tërë vendet e rajonit dhe të Ballkanit. Prandaj, ky është një gabim i rëndë strategjik dhe në dëm të interesit nacional, sepse sikur të ishte shkuar në variantin të cilin e kanë aplikuar gati të gjitha shtetet e rajonit, që fillimisht të privatizohet operatori vendor, e në këtë rast operatori ynë publik është i vetmi operator Vala, e pastaj të shkohet me operatorin e dytë do të ishte një situatë dukshëm më i favorshëm për buxhetin e Kosovës.

Vala është pasuri e Kosovës dhe e qytetarëve të saj dhe sikur të shkohet, dhe po që se merren dhe analizohen parametrat e tenderimit sipas standardeve të ekonomisë së tregut, duke krahasuar numrin e abonentëve dhe banorëve të Kosovës, Vala do t'i sillte të hyra të Kosovës rreth 700 milion euro e jo siç është bërë me operatorin e dytë me një çmim të turpshëm 76 milion euro. Dhe, pastaj nga të hapet dera për operatorin e dytë ku buxheti i Kosovës do të fitonte mjete shtese me çka Buxheti i konsoliduar i Kosovës fare lehtë të nderuar kolegë deputetë do të kishte një vlerë prej 1 miliardë eurosh, mirëpo përfaqësuesi i ART-së, gjegjësisht Anton Berisha së bashku me Qeverinë me qëllim nuk e kanë bërë këtë me çka e ka dëmtuar interesin nacional për shkak të interesave të tyre personale dhe grupe.

Gjithashtu me përzgjedhjen e operatorit të dytë ART dhe Qeveria kanë dëmtuar operatorin vendor vala në rënien drastike të vlerës së saj dhe çmimit shitës, sepse ART dhe Qeveria kanë krijuar terrenin për operatorin e dytë, që do të bëjë treg në të ardhmen e afërt dhe automatikisht kjo është normale dhe krejt e logjikshme që e zbrit edhe vlerën e valës e cila do të privatizohet një ditë.

Sa për informatë të nderuar deputetë, vendet e rajonit të cilat kanë privatizuar së pari operatorët vendor, i kanë sjell fitim të mëdha buxhetit vendor si në vijim: operatori mobil i Sllovenisë që është shitur rreth 141 milion është shitur fillimisht operatori vendor; operatori mobil turk Telekomi është shitur 6 miliard e 55 milion; operatori i Kroacisë është shitur 500 milion; operatori çek është shitur 2 miliard e 75 milion; kurse mobil 063 i Serbisë është shitur 1 miliardë e gjysmë vetëm operatori, kurse tek ne lejohet të hyjë operatori i dytë me 76 milion.

I nderuari z. kryesues më në fund të debatit që do të zhvillohet nga deputetët do të dal me rekomandimet gjegjësisht propozimet të cilat do t'i mbështesë mbi bazën e diskutimeve të deputetëve. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit. Kryesuesi i grupit që ka kërkuar diskutimin .Tash në bazë të rregullit i thërras shefat e grupeve parlamentare të japin mendimet e tyre. Thërras deputetin Alush Gashi, shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

DEPUTETI ALUSH GASHI - Ju faleminderit z. Kryesues. Grupi apo Partia Demokratike e Kosovës përmes procedurave të rregullta parlamentare ka iniciuar që kjo

çështje sot të debatohet. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në respektim të plotë të procedurave të Kuvendit të Kosovës e ka mbështetur që në një prej seancave që do të thotë sot të kemi një informatë lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Siç shihet nga dokumentacioni që na është ofruar sot personi i ftuar për këtë seancë në pamundësi të pjesëmarrjes së tij e ka dërguar si rekomandim edhe një anëtar të Bordit që këtu sot paraqitet. Ne nga fjala hyrëse e përfaqësuesit të PDK-së për këtë çështje dëgjuam akuza shumë të rënda për Qeverinë dhe për kryeministrin në veçanti, si edhe për ART-në në përgjithësi, dhe mendojmë se kjo çështje nuk është e dobishme që të debatohet pa praninë e tyre këtu. Nuk e mohojmë të drejtën e bashkëbisedimit, rekomandimeve, debatit, por mendoj se një debat kish me qenë i frytshëm nëse institucionet që këtu zihen në gojë të jenë të pranishme në seancë. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. Gashi. Në emër të Partisë Demokratike, gjegjësisht grupit të Partisë Demokratike Jakup Krasniqi flet

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – z. Kryesues, të nderuar deputetë, vetë mospjesëmarrja e Bordit të ART-së dhe të Qeverisë që ka qenë e tëra e implikuar sipas Raportit që e kemi në shqyrtim në këtë proces tregon se ata e kanë kryer punën e vet dhe nuk kanë nevojë më për Parlamentin dhe për besimin që duhet t’ia vazhdojmë ne atyre, si duket i kanë kryer obligimet që i kanë marrë nga vendimi për tenderin e operatorit të dytë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës më se një here ka kërkuar nga kjo foltore që Qeveria e Kosovës ta hartojë strategjinë e zhvillimit të Kosovës duke definuar edhe interesin nacional të vendit. E pamë me interes që ta shfrytëzojmë rastin kur po debatohet për një interes tjetër nacional siç është telefonia mobile, një sferë mjaft profitabile, t’ia përkujtojmë Parlamentit dhe Qeverisë se institucionet e Kosovës nuk janë duke treguar përgjegjësinë e tyre në raport me pasurinë kombëtare. Se për shfrytëzimi e kësaj pasurie nuk e kanë siguruar infrastrukturën e nevojshme ligjore. Në mesin e tyre as Ligjin për koncesione. Në shumë raste nuk është respektuar as infrastruktura ligjore ekzistuese dhe ka munguar transparenca sidomos në procesin e privatizimit dhe siç është rasti në këtë proces të tenderimit.

Ne me kohë kemi tërhequr vërejtjen për jo transparencën dhe keqpërdorimin e pozitave zyrtare me rastin e privatizimit të Feronikelit. Tani me rastin e privatizimit të operatorit të dytë të telefonisë mobile, Buxheti i konsoliduar i Kosovës është dëmtuar më së paku për 700 milion euro. Pra, Qeveria e Kosovës është dashur të planifikojë së pari shitjen e Valës e pastaj të mendonte për të futur në treg operatorin e dytë e të tretë, që në këtë fushë të kishim një konkurrencë të vërtetë. Këtu do të ishte edhe interesi i qytetarëve të Kosovës. Me dy operatorë nuk ka konkurrencë të vërtetë, pasi ata mund të vendosin monopol dhe kjo i dëmton qytetarët e Kosovës, na dëmton edhe neve të nderuar deputetë.

Pas telefonisë mobile, të nderuar deputetë janë duke u përgatitur edhe dy pazarllëqe të tjera të mëdha në dëm të interesit nacional dhe kjo në mënyrë të paligjshme. Është

fjala për privatizimin e fushave të linjtit dhe të minierës së Trepçës. Ne jemi të bindur se në këtë fazë të transicionit duhet të pushoj privatizimi i pasurisë nacionale dhe bërja e saj rrush e kumbulla siç do të thoshte populli edhe për faktin se mungon infrastruktura përkatëse ligjore. Shtrohet pyetja: Pse kjo nguti? Apo pse dikush dëshiron që në këtë mjegull – thuhet: ujku do mjegull për të futur në xhepa ndonjë milion euro për t'i humbur qindra milion euro nga Buxheti Kosovës.

Praktika e instaluar në institucionet e Kosovës për t'i mbushur xhepat privat dhe jo buxhetin e Kosovës është në duart dhe mundësitë e këtij Parlamenti për të ndërprerë. Nëse ky parlament nuk e ka vullnetin me e ndërpre këtë praktikë të pasurimit privat e të paligjshëm të zyrtarëve të lartë të institucioneve të Kosovës. Kjo parregullsi, kjo paligjësi do të vazhdon dhe një ditë ata që do ta marrin pushtetin nuk dinë me çka do të qeverisin. Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është i mendimit se duhet të anulohet privatizimi i telefonisë mobile dhe kjo për këto arsye:

1. Pse me këtë privatizim Buxheti i konsoliduar i Kosovës po humbë së paku 700 milion euro;
2. Pse ka shkelje të rënda në procedurat e tenderimit,
3. Pse rrezikohet të paguaj për parregullsitë rreth 100 milion euro buxheti i Kosovës, dhe
4. Janë shkelur tri ligjet: Ligji i telekomunikacionit, Ligji i Prokurimit publik, Ligji i menaxhimit të financave publike dhe natyrisht këtu duhet të ketë punë edhe për Ligjin antikorrupsion.

Të gjitha këto në një formë a tjetër i dëshmon edhe kryesuesi i ART-së z. Anton Berisha në Raportin që e keni në shqyrtim dhe për këtë sinqerisht duhet falënderuar pasi ai ka treguar se në tërë procesin kanë qenë vëzhgues në vend që të ishin vendimmarrës. Po njëkohësisht me këtë raport, kryesuesja e ART-së dhe i gjithë Bordi tregon se nuk e kanë ushtruar funksionin e tyre që e kanë me ligj.

Dështimi i dytë për t'i udhëhequr procedurat e rregullta, për të respektuar ligjin dhe ushtruar përgjegjësinë e tij konform ligjit Kuvendi i Kosovës duhet t'ia marrë besimin Bordit të ART-së që sot. Përveç kësaj, ne kërkojmë vlerësim profesional nga ndonjë agjenci e pavarur ndërkombëtare dhe njëkohësisht kërkoj formimin e një komisioni hetimor parlamentar për ta verifikuar rregullsinë apo parregullsinë e përzgjedhjes së operatorit të dytë të telefonisë mobile. Komisioni do të duhej të verifikonte edhe shkallën e ndërhyrjes së kryeministrit dhe të ministrit përkatës në këtë tender.

Të nderuar deputetë, kontrata e nënshkruar duhet të anulohet deri të verifikohen të gjitha faktet. Qeveria duhet të jep sqarime nëse jo edhe përgjegjësi politike e juridike për shkeljet e procedurave në këtë proces, pra në vendimin që ka marrë për privatizimin e operatorit të dytë të telefonisë mobile. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e merr Gjylnaze Syla, shefe e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit i nderuari z. kryesues, i nderuari ministër, deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Aleancës është shumë i interesuar për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe sidomos për sektorin e telekomunikacionit meqenëse ndikon në mirëqenien e popullatës së Kosovës dhe pikërisht për shkak të këtij interesi, ne konsiderojmë se duhet patjetër me qenë prezentë edhe kryesuesi i ART-së, edhe kryeministri, ministri, por dhe përfaqësuesi i UNMIK-ut në mënyrë që ne të kemi një informatë të hollësishme por edhe të drejtë nga ajo se si është zhvilluar i tërë procesi i tenderimit, pavarësisht prej dokumentacionit të cilin e kemi marrë. Megjithatë unë me shumë vëmendje i dëgjova përfaqësuesit e PDK-së, shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së foli për shkeljet e ligjeve. Unë dëshiroj të kujtoj shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së se pikërisht i është përmbajtur Ligjit ART-ja duke marrë parasysh se Ligji për Telekomunikacionin neni 36 thotë se Ministria do të përgatisë dokumentet e tenderit ndërsa ART-ja do të implementojë tenderin jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, d.m.th. gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit është dashur me u shpallur tenderi. Ndërsa, sa i përket formimit të komisionit hetimor

gjë gjithashtu është e rregulluar me ligj, neni 11, pika 8, thotë : Aktet dhe aktet dhe vendimet zyrtare të ART-së, do të shqyrtojnë nga gjyqet dhe do të jenë subjekt i çfarëdo apelimi nga palët e pakënaqura përmes procedurave administrative gjyqësore, siç përshkruhet në ligjin e Kosovës. Me fjalë të tjera grupi parlamentar është për zbatimin e ligjshmërisë së mirëfilltë të rregullave por edhe të transparencës, i nderuari zoti kryesues. Ne kërkojmë që njërën nga seancat e ardhme, të vijë përfaqësuesit të cilët i përmenda më parë dhe pastaj të debatohet për këtë pikë. Ju faleminderit!

KRYESUESEI, SABRI HAMITI, është zonja deputete, po ma merr mendja që Nazim Jashari në emër të ORË-s,

DEPUTETI, Nazim Jashari, i nderuari zoti kryesues, zoti ministër, mirë se ke ardhur, të nderuar kolegë deputet!

Sot vetja në këtë foltore po më duket se ai dhëndri në gjerdek që nuk kishte pas ditur kah me ja nisur, edhe unë nuk po di kah me ja nisur, aq shumë ka shkelje, aq shumë ka parregullsi, aq shumë ka nëpërkëmbje të ligjit, sa që nuk po di kah me ja nisur.

Por, po e nisi prej këtij zarfi, ky zarf ka ardhur dje në Kuvendin e Kosovës, nga organizata për demokraci dhe antikorrupsion dhe dinjitet çou, me emra të përveçshëm për çdo deputet, të adresuar dhe Kuvendi ynë nuk e ka pa të arsyeshme ta shpërndajë. Nuk është rëndësia ndoshta shumë e madhe te zarfi si zarf, por është rëndësia te përmbajtja e zarfit, sepse në përmbajtje të zarfit ka pasur dokumentacion tuajin koleg deputet me siguri që do të kishin mundë tua tërheqin vërejtjen edhe t'iu bëjnë të mendoni lidhur me temën që po e diskutojmë sot.

Në kuadër të kësaj e kemi ankesën e zotit Gnad, nga firma austriake e cila është një firmë e cila ka përvojë të madhe në kontestet juridike, me sa di unë mos qofsha gabim Serbisë ia ka marrë një të tretën e Mobtelit, për shkak të pazarit që e ka bërë më herët me Kariqin, kështu që në këtë kontekst ta dini që Kosova po pretendon që po i fiton 75 milion €, por

unë po dyshoj që po i humbë 100 milion €, prandaj, në qoftë se jemi në nivelin e detyrës, a duhet të jemi në nivelin e detyrës, se nuk bënë, ne duhet të merremi më seriozisht me këtë problematikë, tashti çështja tjetër që, po ashtu është në atë morinë e çështjeve që nuk po di kah me ja nisë.

Ky zotëriu që është përfaqësues i bordit të ART-së, i cili ngritet jo vetëm mbi Qeverinë, jo vetëm mbi ministrinë, por mbi Qeverinë mbi Kuvendin, dhe është i paprekshëm, dhe është i pa kapshëm. E sheh të arsyeshme të na i qon atje neve një kolegë të vetin, e sheh të arsyeshme që as kolegu i tij të mos vijë, dhe tash ne vijmë në situatë kur duhet ta ndalim debatin për shkak se ai zotëria nuk donë me i përfillë institucionet tona. Tash kjo mospërfillje e institucioneve tona, lind pyetja çka është, a është shenjë guximi te mihja apo është shenjë frike. Të bëhem psikolog si një gazetarë i televizionit të RTK-së, edhe të them që është shenjë frike dhe është shenjë frike sepse shkeljet janë të nderuar kolegë deputet aq të mëdha, sa që kur e kamë thënë në një medium tonin të shkruar, që shihen edhe nga hëna. Dhe shihen nga hëna për arsye të thjeshtë, sepse ligji për prokurimet publike në Kosovë e thotë qartë, neni 56, hapja e tenderëve bëhet në mënyrë publike, çka do të thotë, që të gjithë të interesuarit, që janë të interesuar të marrin pjesë që kanë hyrë në atë tender për të garua, duhet të jenë aty ku hapet tenderi e jo tenderi të hapet diku prapa perdes dhe kjo pikërisht ka ndodhur.

Mund që edhe shtypi ka mundur të mos jetë, disi është e kuptueshme të mos jetë ose mund të kuptohet disi mos të jetë shtypi aty ku hapet tenderi. Po të mos jenë të interesuar ata që kanë dhënë nga 15. mijë €, kesh para, vetëm për të dorëzuar aplikacion, secili aplikantë është dashur ti paguaj 15. mijë €, që ti merret dokumenti në trajtim, që të filloj negocijimin me këtë ART-në e famshme. Dhe hapja e tenderit në mënyrë të fshehur i krijon të gjitha rrethanat që gjyqin Kosova ta humbas.

Kosova nuk e fiton këtë gjyq, Kosova këtë gjyq e humb, tash sa ka me qenë dënimi për Kosovën është çështje tjetër, a do të jetë ajo 100 mijë sa ka lypë kjo firma austriake, a do të jetë më shumë se e ka lypë edhe ky burri i botës, ky që ka qenë në konzorcium Kosmoceli, i cili ka ardhur me regjistrua firmën vendore me 15 shkurt, edhe sistemi në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për të regjistrua firma, ka dështua nuk ka punua, dita e enjte, nuk ka punua sistemi është dashtë tek me 20 me regjistrua firmën që me muajt me iniciua procedurën me i lëshua paratë, prandaj nuk ka muajt me i lëshua paratë, nuk po hy andej a ka pasur të drejtë me fitua a nuk ka pasur të drejtë me fitua, thelbi është që sistemi në Ministri të Tregtisë dhe Industrisë, ka dështua dhe ai nuk ka muajt me regjistrua firmën me datën 15. është dashtë tek me 20 me regjistrua firmën KEJSELL, sepse ai kolegu i tij i konsorciumit që ka pasur Kosmocelin përmbi veti, në bashkëpronësi me sllovenët ai nuk ia ka lejua me përdorë tjetrën firmë më se, ka thënë kjo firmë është e imja personale unë e kamë për veti.

Si do të jetë, një gjë duhet ta kemi parasysh, jemi deputet të Kuvendit të Kosovës, jemi njerëz që duhet të kujdesemi për paranë e këtij populli dhe në qoftë se lejojmë që ky tender të shkojë përpara në këtë mënyrë si është duke shkuar, të jeni të sigurt që, gjithë mbajmë përgjegjësi. Çdonjëri prej nesh që jemi të ulur këtu, prandaj duhet ta stopojmë këtë proces një orë e përpara. Unë e kamë një beng shumë të madhe të nderuar kolegë

deputet, unë e di që ju të gjithë jeni njerëz të ndershëm, punoni edhe sikur unë me pagën e deputetit ekzistoni, por këtu është problemi që ky shtet që po pretendon të bëhet shtet është në një situatë si Sali Berisha në Kuvendin e Shqipërisë, tërë kohën bërtet, “**stejd – kapqër**”, “**stejd –kapqër**”, ky shtet është i zënë për gushe, e kanë rrokur lobet e interesit ekonomik të mos them lobet e interesit të krimin ekonomik edhe e kanë ngulfatur, Vetëm ta kujtojmë pak kronologjikisht tenderin e parë të shpallur më herët, 6 muaj si tha zonja Syla, mbasi që është shpallur ligji. Loti Lluka fitues, prej vlerësimi zoti Lluka fitues, Kosmoceli zoti Lluka fitues, prapë zoti Lluka fitues.

Anton Berisha, mua më qon mallin e lulediellit, po jo lulediellit, por lulellukes, kah shkon Lluka, shkon Antoni. Kthehet rrafsh sikur luledielli rreth diellit, ky rreth Llukës. E ka pas thanë kolegu ynë i nderuar Xhavit Haliti herët, që shumë kush i ka hanger qebapët e Llukës, mua po më duket që edhe Jakim Rykeri i ka hanger qebapët e Llukës dhe dua ta them publikisht, sepse Jakim Rykeri si shefi i shtyllës së IV-rt të UNMIK-ut, ose si ish shef i shtyllës së IV-rt të UNMIK-ut, e dinë saktë sa herë i ka qua ato kutit përpjetë kur janë hapë tenderët, ofertat publike për privatizim në Kosovë. E dinë saktë sa herë ka dalë para kamerave dhe ka kallxua që filani fitoj, filani nuk mbet më asnjë ofertë, të gjitha hapjet kur ai ka qenë shef i shtyllës së IV-rt, kanë qenë publike në AKM, dhe gjithmonë AKM, hapjet janë publike.

Tenderi i ART-së është 20 milion, shpesh ndodhë që një raund i privatizimit në AKM, nuk e mbërrin vlerën e 20 milionëshit, pra minimumi ka qenë 20 milionëshi, maksimumi ka qenë 81 milion. Dhe hapja bëhet në mënyrë papa perdes fshehur. Tash lind pyetja a e din zoti Ryker që është bërë hapja e fshehët apo jo, a e din ai që ligji e thotë qartë, jo vetëm i ynë por edhe i Evropës, që hapja duhet të bëhet në mënyrë publike. Prandaj dyshoj që edhe ai ka hangër qebapët e Llukës. Unë po e përfundoj me kaq, shpresoj që do të ngriteni në përgjegjësinë tuaj, si deputet që para popullit të dilni me faqe të bardhë, sepse Kosova ka me pagua para, e jo që ka me marrë para prej këtij tenderi.

KRYESUESI, SABRI HAMITI – Tashmë në emër të Grupit për Integrimi, nuk ka integrim, Mahir në emër të 6+, Mahiri e ka lypë fjalën, urdhëro Mahir,

DEPUTETI, MAHIR YAGCILAR – Po zoti kryesues, ne si grup 6+, mendojmë që, procesi i tenderimit është shumë i rëndësishëm për Kosovën. Siç e dimë të gjithë, tenderi i parë ka dështuar dhe ka dëmtua imazhin e Kosovës, kështu që edhe këtë herë, ndoshta duhet të diskutojmë, pak më analitike në këtë aspekt edhe na propozojmë, këtu duhet të, me qenë prezent edhe zotëri kryeministër, zotëri ministrin e kemi këtu, por duhet edhe kryesuesi i ART-së. Në këtë aspekt do të mundemi me ardhë deri te një konkluzion. Por sot në këtë moment, unë mendoj që nuk mundemi me ardhë, por procesi i tenderimit është shumë i rëndësishëm. Nuk duhet të dëmtojmë imazhin e Kosovës, ju faleminderit.

KRYESUESI, SABRI HAMITI – ju faleminderit, zoti Yagcilar, Ferid Agani e merr fjalën, Ferid në emër të grupit apo, ku e ke atë grupin tënd?

DEPUTETI, FERID AGANI – Ne e kemi diskutuar këtë çështje, brenda grupit tonë parlamentar. Ajo që është me rëndësi se akuza që u dëgjua sot në mënyrë publike, cilat

argumente më kanë shty edhe mua që të jem njeri prej nënshkruesve të kërkesës për këtë pikë të rendit të ditës sot janë shumë të rënda, me të vërtetë dhe diskutimet e parafolësve në qoftë se dëgjohen me kujdes, atëherë implikojnë çështje shumë serioze, filluar nga Kryeministria, Autoriteti Rregullativ i telekomunikacionit, e deri te ky Kuvend. Po ashtu jam koshient se, duke e pa parasysht disponimin e grupeve parlamentare që formojnë koalicionin qeveritar, ne sot vështirë do të jemi në gjendje që të marrim një vendim meritor në lidhje me këtë çështje. Do të ishte mirë që Kryesia e Kuvendit të na sqarojë a pasur ndonjë informatë, ndonjë arsytim ndoshta për mungesë të kryetarit të Autoritetit Rregullativ, ndoshta një arsytim për, tash do të thotë një sqarim për mungesën e tij në ditën e sotme, sepse për ndryshe në qoftë se nuk ka pasur arsytim për një gjë të tillë, atëherë kjo implikon edhe përgjegjësinë e tij të drejtë për drejtë lidhur me këtë çështje.

Nga informata të cilën e ka sjellë zotëri Berisha në Kuvend të Kosovës, unë këtë informatë, më tepër e kuptoj si një lloj shfajësimi dhe si lënje e fajit në dyert e Qeverisë. Në qoftë se është kjo e rastit, atëherë duhet që Qeveria të deklarohet, në lidhje me këtë çështje. Propozimi im konkret është që, në parashtrësën të cilën e bëri zotëri Limaj, në emër të grupit të deputetëve, kryeministri Çeku dhe zotëri Berisha, në mënyrë konkrete të përgjigjen në secilën prej argumenteve, fakteve të parashtruara, për keqpërdorimet gjatë procedurës së tenderimit.

Kjo shkresë me shkrim, të përgatitet për seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës, tu shpërndahet paraprakisht të gjithë deputetëve dhe në atë seancë të merren vendimet meritorë lidhur me këtë çështje, ju faleminderit!.

KRYESUESI, SABRI HAMITI – Ju faleminderit zoti Agani. Fjalën e ka ministri i resorit urdhëro zoti Ahmeti.

MINISTRI, QEMAJL AHMETI – Ju faleminderit zoti kryesues, të nderuar deputetë!

Unë nuk kam pasur ftesë zyrtare, për këtë pikë të rendit të ditës, që të vijë dhe të bisedoj, por e ndieja obligim të them dy- tri çështje që i dëgjova këtu. Procedurat, secili subjekt në pjesën e këtij procesi duhet ta japë përgjegjësinë e vetë pra, duke fillua secili në nivelin përkatës. Unë dëshiroj të ju njoftoj vetëm për këtë, se me vendimin e PSP-së tenderi i parë është anulua, Qeveria e ka pasur obligim të fillon procesin e dytë dhe sipas ligjit për telekomunikacion shpalljen e tenderit, përgatitjen e pakos tenderuese, paraqitjen e metodës së vlerësimit e bënë Ministria. Këtë e ka bë, dhe prej momentit të konkurrimit të kandidatëve kalon në zbatimin e kësaj pjese nga subjekti, nga autoriteti rregullator i telekomunikacionit. Kjo procedurë ka shkuar në rregull, ne ndoshta, por dua të ju them dy tri çështje, i tërë ky proces edhe në ligjin për telekomunikacion thotë se tenderi duhet të zhvillohet në bashkëpunim me UNMIK-un, përkatësisht me PSP, sepse ju e dini se frekuencat janë pjesë e rezervuar dhe nuk kemi pasur mundësi dhe vetë autoriteti, vetë ky fakt ka dhënë edhe autoritetin për anulimin e tenderit të kaluar.

Kur kam ardhur në këtë pozicion, ky tender veç ka qenë gjysmë i anuluar, po them kështu, në bashkëpunim me UNMIK-un, dhe me sugjerim kemi arrit, kemi fillua procesin e përbashkët, pra PSSP-ja, Qeveria, ART-ja, secili në resorin, në pjesën përkatëse, është

sugjerua nga PSP-ja të formojë një komitet ose një komision mbikëqyrës, në përbërje të përzier ose ku dy anëtarët kanë qenë të, janë të UNMIK-ut, dy anëtar të Qeverisë dhe një i ART-së, dhe kjo është miratuar, është propozua, është arritur marrëveshja, kemi caktua njerëzit dhe ky komitet e ka pasur për detyrë për me e mbikëqyrë procesin, nuk ka qenë vendimmarrës, pra ky Komision.

Pastaj për të përgatitë një pako tenderuese është thënë se ne nuk kemi përvojë, normalisht kemi paraqitur procedura të rregullta, kemi kërkuar një kompani konsulente, është përzgjedhë kompania konsulente, ka përgatitë pakon tenderuese, është miratua ajo pako tenderuese dhe me këtë pako tenderuese kanë konkurruar kompanitë përkatëse. Nëse ka shkelje në procedurë, unë jam këtu në atë pjesën që më takon mua, për atë jam këtu, secili duhet ta marrë përgjegjësinë, meqë nuk, u pa edhe nga diskutimet, nuk janë të gjithë subjekte këtu, sepse tema është adresua kryesuesit të ART-së, unë kisha sugjerua, që jo kryesuesit të ART-së por të jetë bordi i ART-së, komplet në një takim të ardhshëm, kur do të diskutohet më shumë, ju faleminderit shumë!

KRYESUESI, SABRI HAMITI – Ju faleminderit, zotëri ministër, kolegë të nderuar, ju njoftoj që, pos kësaj që dëgjuat deri tash, në regjistrin tim përpara i kamë nëntë emra të deputetëve, unë vetëm duhet të merremi vesh çka do të bëjmë, si do të punojmë, a do të punojmë, a do të punojmë në këtë temë sot më tutje apo jo. Pritni pak tani ju ves, ne kemi proceduar në Kuvend, unë kamë tash kur po flas po i përgjigjem me emër zotëriut Agani. E ka merak ky me ia shpjegua procedurat e Kryesisë, e unë dua të ia shpjegoj edhe për këtë temë.

Një grup deputetësh ligjërisht kanë kërkuar të shqyrtohet kjo temë në parlament, i kanë plotësua kushtet dhe ne jemi drejtua organit, të caktuar që të japë përgjigjen. Kjo është ART-ja. ART-ja ka qua këtë dokument të cilin e keni ju të gjithë, që unë e quajë katalog të vendimeve, nëse unë kamë të drejtë të bëjë klasifikim të shpejtë. Gjitha janë vendime dhe keni kujdes, këtu pos kësaj parathënies së vogël, askund Anton Berisha nuk ka nënshkruar asgjë. Njeriun të cilin ju e lypni të bisedoni me te. Ky është dokument që kemi marrë në Kryesi, normalisht, formalisht janë plotësuar kushtet që, kjo pikë të vihet në rend dite në Kuvend dhe Kryesia nuk ka pasur çka të bëjë tjetër pos formalisht ti përcjellë kushtet dhe të vijë në Kuvend. Kryesia as nuk paragjykon gjë, as mbas gjykon gjë, as nuk është e drejtë e asaj, prandaj çështjet që dalin në Kuvend, është Kuvendi ai që vendos me fuqinë e vetë të votës, me fuqinë e vetë logjikes, të argumentimit, bisedon dhe vendos.

Unë me qëllim në fillim u përpoqa t' ju sugjeroj, a është e dobishme,, a është në nderin dhe në vlerësimin, vetëvlerësimin e Kuvendit që të bisedohet në këto kushte për këtë temë, Nëse ju thoni po, unë them vazhdojmë, sa më përket mua unë them, nuk është mirë, nuk është mirë sepse do të bisedojmë në ajër, pa marrë parasysh a kemi a nuk kemi argumentime, ana tjetër nuk ekziston hiq, ministri i resorit erdhi dhe foli bardhë, d.m.th. foli neutralisht që merr përgjegjësinë gjithkush për punët që i ka bërë. Mbi të gjitha ne nuk jemi të zotët këtu as të bëhemi gjykatës, as mbrojtës, as avokat, as kurrfarë rrolit të tipit të gjykatësit.

Nëse ekziston interesimi që sot të vazhdojmë të bisedojmë për këtë temë, në këto kushte ku njerëzit që i kemi ftuar të bëjmë bisedë me ta nuk ekzistojnë hiq, unë e vazhdoj bisedën. Shumë më logjike më duket që këtu të jetë jo vetëm kryetari, si e tha zoti ministër, por krejt bordi i ART-së dhe përfaqësuesi i Qeverisë, kryeministri ose zëvendëskryeministri në pikën më të lartë. Nëse ju thoni jo, nuk duhet kështu dhe UNMIK-u, natyrisht dhe UNMIK-u që merr një pjesë të përgjegjësisë, sepse implikohet fuqishëm, e thotë se nuk jam duke implikuar, atëherë unë mendoj po të ishin të gjithë është shumë më e dobishme. Ju thoni, nëse thoni shumica po vazhdojmë dhe unë nuk do të bëjë komente rreth kësaj, është punë juaja. Ndërhyrje-

Unë edhe një herë në emër të atij që e ka paraqitur kërkesën, zoti Lima.

DEMIR LIMA – I nderuari zoti kryesues, për këtë çështje ndoshta ka edhe shefi i grupit parlamentar zoti Krasniqi më gjerësisht, vetëm unë e ndaj mendimin tim, lidhur me këtë debat. Pajtohem plotësisht, siç e thatë ju, se nuk ka kuptim të diskutohet përderisa nuk janë prezentë, vetëm nuk është hera e parë që Anton Berisha në këtë rast nuk vjen dhe nuk i përfillë ftesat e këtij Kuvendi. Është hera e dytë apo e tretë dhe që të gjithë në mëngjes ka qenë edhe kryeministri këtu, ka qenë edhe kabineti qeveritar dhe zoti Anton Berisha së bashku me kryeministrin dhe kabinetin qeveritar. Unë ju siguroj që të gjithë janë duke e përcjellë debatin në zyrat e tyre. Dhe kjo nuk është në rregull.

ART-ja në këtë rast Anton Berisha del, po del përmbi 120 deputetë, nuk është në rregull ne ta kërkojmë, ta lusim Anton Berishën vazhdimisht, sepse dy herë nuk na ka ardhur në seancat tona që e kemi kërkuar. Dhe te e fundit i nderuari zoti kryesues, ne e kemi zgjedhur atë dhe ne i marrim vendimet tona. Ai nuk ka nevojë tek e fundit dhe kurrë mos me ardhë, në qoftë se nuk duan. Ju faleminderit!

KRYESUESI, SABRI HAMITI – Ju faleminderit. Këqyr, a na shikojnë a nuk na shikojnë unë lidhje nuk kam, se nuk mundem me e ditë atë punë, nëse u interesojnë sigurisht na shikojnë, nëse jo nuk na shikojnë hiq. Problemi është që, unë edhe një herë ju thashë, zoti paraqitës i kërkesës, nëse jam unë zakonisht jam tepër i qartë kur flas dhe u pengon njerëzve që flas pak si tepër qartë, nëse jam i qartë. Unë po them, ne mund të vazhdojmë në kushtet ekzistuese, nuk ka produktivitet të bisedimit, ju nëse thoni ka produktivitet ne vazhdojmë. Unë mendoj për këtë seancë, për këta deputetë, jo për paraqitësin e kërkesës, për krejt seancën. Unë mendoj që në këtë formë nuk është produktive, për pa i pasur aktorët themelorë, me të cilët duhet të bëjmë biseda për një temë.

A deshe Jakup Krasniqi fjalën? Jakup Krasniqi..Po,

DEPUTETI, JAKUP KRASNIQI – I nderuari kryesues, fillimisht dua t'ia tërheq vërejtjen kryetares së Grupit Parlamentar të Aleancës se ligjin vërtet e njoh në një masë se është miratuar në kohën kur kam qenë ministër dhe i kam pasur kërkesat e mia që atëherë disa çështje me u ndryshua. Do të thotë e njoh mirë edhe të gjitha procedurat i kam përcjell, se jam në Parlament dhe përqipem seriozisht t'i përgjigjem detyrës që kam marrë, edhe nga qytetarët por edhe vetë kam qenë përgjegjës për detyrat që i marrë.

Shikoni, mendoj që punëdhënësi, i bordit të ART-së, është ky Parlament dhe që sot duhet ta marrë vendimin për shkarkimin e këtij bordi. Nëse nuk ka ndonjë implikim tjetër të natyrave të tjera në grupe të ndryshme politike, që janë në Parlament. Përndryshe Parlamenti është punëdhënësi i bordit të ART-së dhe bordi i ART-së, me këtë lojë që e ka bërë dëshiron që ne ta lëmë, ta shtyjme debatin, dëshira e tyre është me e shty debatin, pse është detyra e tyre me e shty debatin nuk e di, po ekziston një arsye. Po mos të kishte arsye, ata do të ishin sot këtu. Prandaj, ne mund ta lëmë në procedura tjera për një seancë tjetër, se mendoj që këtu parlamenti ka shumë detyra, shumë obligime.

Po ky Parlament do të ishte në nderin tonë që këtyre njerëzve që i kemi veshë me përgjegjësi dhe e kanë kryer keq përgjegjësinë, nuk e kanë respektua ligjin, tija marrin mandatin dhe procedurën e vazhdomë me Qeverinë, se sipas raportit tërë përgjegjësia për shkelje në procedura, nuk janë të ART-së, janë të Qeverisë dhe kjo pjesa tjetër mund të vazhdon për seanca tjera. ky është një propozim i imi megjithatë këto janë votat ato që vendosin. Ju faleminderit!

KRYESUESI, SABRI HAMITI – Ju faleminderit, zoti Krasniqi unë e dëgjova qartë kërkesën tënde, unë të përcolla aq sa munda të përcjellë saktë, dhe besoj që saktë të kamë përcjellë edhe me një mori kërkesash që i the në paraqitjen e parë. Ka pak shumë një kakofoni në dy kërkesat të fundit dhe të parën, sido që të jetë edhe po të jetë kërkesë e zbatueshme kjo që ju e paraqitni, keni të drejtë legjitime ta paraqitni kështu siç e shtruat ju sot, unë mendoj megjithatë nuk i di arsyet dhe nuk po dua të merrem me arsyet e ART-së apo e kujt do qoftë pse nuk është sot këtu, unë po mendoj për parlamentin, unë po mendoj besoni o jo, në këtë moment mbi të gjitha për dinjitetin e këtij parlamenti. Unë mendoj që ky parlament është në nivelin e tij dinitoz, nëse nuk bisedon për temat me njerëzit që nuk janë këtu. I thërret në mënyrë të obliguar në herën tjetër, edhe bordin edhe Qeverinë, atëherë kalon në fazën e asaj që do të quhej vendimi i shpejtë, vendimi pa-pardon.

Po përpiqem ti marr gjitha arsyet, po përpiqem ta kuptoj krejt situatën, mua po më duket që, sot ne nuk mund të marrim, - menjëherë ta japë fjalën, Jakup Krasniqi po më replikon

DEPUTETI, JAKUP KRASNIQI – zoti kryesues nuk ka kakofoni, unë propozimin e dytë e dhashë mbi bazën e të drejtës që e ka Parlamenti dhe vetëm për një pjesë të kërkesës për tu debatuar, pjesa tjetër duhet të vazhdon në një seancë tjetër që mund të jetë të hënën, mund të jetë të enjten, nuk di cilën ditë do të jetë, po është obligimin dhe përgjegjësinë sot, për shkak të lojës që e ka bërë bordi i ART-së, ai të shkarkohet se ky parlament e ka punësuar atë bord, dhe jo bordi Parlamentin.

KRYESUESI, SABRI HAMITI – Është në të drejtën e deputetëve zoti Krasniqi me vendos dhe unë duke u përpjekë me ju dhënë atë të drejtë dhe arsyen në rrezonin dhe argumentet, po bisedoj në këtë mënyrë, për ndryshe nuk do të bisedoja nga kjo pozitë në këtë mënyrë hiq.

Pra duhet argumenti për ta marrë një vendim se, Kuvendi është organ shumë serioz dhe Kuvendi nuk guxon të marrë vendime të shpejta pa argumentime. Ky është mendimi im personal. Po flas si deputet tani, jo si kryesues,

Për të qenë argumentet, unë tjetër nuk kamë çka ju them, janë edhe 12 vetë urdhëroni vazhdoni flitni. Unë askujt nuk do tija marrë fjalën, u përpoqa të fusë rezon, ju mendoni që është kështu, unë nuk do tija marrë fjalën askujt, do të do të flasë secili çka të dojë në këtë syzhe. Veç një moment, Krasniqi se ky nuk ka fol ende, masandej ti. Deputetit Krasniqi jepjani Agim.

DEPUTETI, AGIM KRASNIQI – Këtu jeni shumë Kasniq dhe kjo është problem.

Zoti kryesues, desha vetëm të intervenoj, ose të jepet një propozim, se çka duhet të bëjmë ose të mos diskutohet tash për diskutimin e secilit veç e veç, duhet ose një propozim, ose të vazhdojmë siç jemi paraqitur për diskutim. Ju faleminderit!
Unë e jap propozimin, unë kisha me thënë ose të vazhdojmë, të vihet propozimi në votim, ose të vazhdojmë.

KRYESUESI, SABRI HAMITI – A po e sheh Agim ti, po lypë vendim e po thua ose-ose, ose-ose nuk është vendim. Zoti Jashari shkurt,

DEPUTETI, NAZIM JASHARI - Zoti kryesues në emër timin personal, si njeri prej nënshkruesve të kërkesës për debat, ju kisha lutë për 5 minuta pauzë të mblidhemi grupi dhe ta diskutojmë problemin dhe të dalim në propozim konkret, se si me dalë prej kësaj situatë, jem shumë dakord me ju, me shumë momente që ju po i trajtoni dhe si po i trajtoni, po edhe të tjerët kanë të drejtë prej aspektit të vetë. Prandaj është e mira e së mirës në nëntë që i kemi nënshkrua, Feridi, Unë, Demiri, që nuk është kjo kërkesë vetëm e PDK-së, por është kërkesë e më shumë përfaqësuesve të Kuvendit ta diskutojmë bashkërisht një propozim konkret edhe real.

5 minuta pushim besoj që na bëjnë mirë se edhe ashtu qe dy orë jemi duke punuar boll.

KRYESUESI, SABRI HAMITI – Unë japë 5 minuta ju i bëni 7. sigurisht, d.m.th. 5, minuta grupi propozues le të dalë me një ide të përbashkët.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju lutem t’i zini vendet.

Fjalën e ka z. Jashari në emër të grupit të paraqitjes së kërkesës, do të na kumtoj kërkesën.

6. Shqyrtimi i informatës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit lidhur me përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë.

NAZIM JASHARI – I nderuari kryesues, z. ministër, të nderuar kolegë deputetë.

Grupi iniciues i këtij debati të sotshëm pas një diskutimi dolëm me një propozim që kjo pikë e rendit të ditës, duke pasur parasysh edhe sugjerimet e kryesuesit të seancës që Kuvendi për ta pasur një dinjitet dhe një nivel të punës duhet të jetë në përbërjen e plotë të ti ,pra edhe Qeveria duhet të jetë e pranishme, të vazhdohet të martën në orën 10,00. Mirëpo sipas sqarimeve që u dhanë nga ana e kryesuesit Kryesia qenka në rrugë atë ditë,

kështu që u pajtuam që kjo pikë të vazhdohet të enjten në orën 10,00 dhe Bordi i ART-së është i obliguar nga ky Kuvend që ta plotësoj këtë informatë që e ka pru, e që është përmbledhje vendimesh, nuk është raport i vendimit të Bordit, por është përmbledhje e vendimeve të Qeverisë, duhet ta plotësojë me informatën për pjesëmarrësit në tender kush kanë qenë, ta plotësoj me kriteret e dhënies së pikëve si dhe me numrin e pikëve që i kanë marrë secili ofertues. Informata duhet të plotësohet dhe të enjten në orën 10,00 vazhdohet debati për këtë çështje. Sigurisht që kërkesa e kolegëve ishte që kryeministri të jetë këtu prezent, ministri si dhe bordi komplet.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Kolegë të nderuar. Dëgjuam kërkesën sipas marrëveshjes, kërkesën e komisionit që e ka paraqit fillimisht temën për diskutim. Unë besoj se pajtohemi të gjithë sepse këtu kishim arritur faktikisht para se ta jepshim pauzën e shkurtë që kjo temë të diskutohet në një seancë të ardhshme që i bie kërkesa të enjten e ardhshme me argumente plotësuese dhe me apel të pranishëm në Kuvend, vazhdojmë tutje.

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për rishqyrtim të ankesave

Qeveria e Kosovës i është drejtuar Kuvendit me propozim-vendimin për emërimin e 6 anëtarëve të bordit të pavarur për rishqyrtim të ankesave. Propozim-vendimit të Qeverisë së bashku me të dhënat biografike të kandidatëve të propozuar i është shpërnda të gjithë deputetëve.

Përfaqësuesi i Qeverisë e merr fjalën rreth këtij propozimi.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – I nderuari kryesues të nderuar deputetë. Do të paraqes arsyetimin e këtij propozim-vendimi.

Duke u bazuar në urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2000/7 dhe ligjin mbi procedurat e administratës tatimore nr. 2004/48 dhe të dekretuar me rregulloren e UNMIK-ut 2005/17 të datës 9.02.2005, neni 57 i këtij ligji parasheh themelimin e bordit të pavarur për rishqyrtim të ankesave dhe emërimin e anëtarëve të bordit.

Në dispozitat e tjera të këtij neni thuhet: “57.1 Bordi i pavarur për rishqyrtimin e themeluar sipas urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2000/7 do të vazhdojë si bord i pavarur për rishqyrtimin sipas këtij ligji. Neni 57.2 anëtarët e bordit propozohen nga Qeveria të bazuar në aftësitë për kryerjen e funksioneve të tyre, atëherë emërohen nga Kuvendi, pos dy anëtarëve të bordit që emërohen nga PSSP-ja pas konsultimit me Qeverinë”. Në emërimin e parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji emërohen 7 anëtarë me mandat 1 vjeçar dhe 8 anëtarë emërohen me mandat 2 vjeçar ,që mund të ripërtërihet edhe për një mandat 2 vjeçar, prandaj secili anëtarë do të ketë mandat 2 vjeçar.

57.3 Bordi do të përbëhet prej një anëtari kryesues dhe 14 anëtarë të tjerë ku të gjithë janë të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, së paku 7 anëtarë do të jenë nga komuniteti i biznesit të Kosovës. Duke u bazuar në këtë ligj në mbledhjen e rregullt të Qeverisë së Kosovës të datës 26 janar 2007 është bërë propozimi për rizgjedhjen e

anëtarëve të bordit të pavarur për rishikim të ankesave me mandat 2 vjeçar. Me datën 21 shkurt 2007 është nxjerrë vendimi nr. 02/238 me propozim për Kuvend të Kosovës për emërimin e 6 anëtarëve të bordit të pavarur për rishqyrtim të ankesave me mandat 2 vjeçar. Këta anëtarë të propozuar janë: **Bahri Hyseni, Hajdin Ramadani, Islam Çeku, Nazmi Pllana, Qemajl Smajli dhe Ljubisha Shipiq .**

Më lejoni që në pika të shkurtra t'i jap disa të dhëna të tyre biografike.

Bahri Hyseni është i lidhur në Zhabar të Mitrovicës më 20.08.61. Ka të mbaruar Fakultetin Ekonomik në Prishtinë në vitin 1985.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Z. Ministër unë mendoj që nuk është e nevojshme për shkak se këto biografi ne i kemi në dorë.

MINISTRI QEMAJL AHMETI –Më vjen keq se tash e kam marrë autorizimin për ta lexuar këtë raport. Nëse biografite e këtyre kandidatëve i keni para veti nuk do t'ju ngarkoj. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. ministër.

Kolegë deputet ju e keni përpara edhe listën, i kenë përpara edhe biografite e tyre. Nëse dikush e do fjalën do ta marrë. Deputeti Kryeziu, urdhëroni.

DEPUTETI FADIL KRYEZIU – Ju faleminderit z. kryesues. Unë po vërej që në vendimin që e kemi për propozim të Qeverisë në gjuhën shqipe nën numrin rendor 6 kemi një dallim, prandaj nuk e kamë të qartë edhe pse ministri në autorizim e ceku në gjuhën shqipe flitet për Lubisha Shipiqin, në gjuhën serbokroate flitet për Liljana Shipiqin, prandaj duhet të përmirësohet kjo sepse nuk mund të jetë gabim teknik.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ashtu është, a ka dikush tjetër. Znj. Halimi.

DEPUTETJA SEVDIJE HALIMI – Z. kryesues ju faleminderit. Unë nuk kam vërejtje konkrete për anëtarët e propozuar për bord, por e ndjej të arsyeshme ta them një mendim timin personal që të jetë publik edhe për kolegët deputet edhe për opinionin publik. Unë si deputete e këtij Kuvendi asnjëherë nuk do të votoj për borde të cilat duhet t'i emëroj Kuvendi derisa deputetët e Kuvendit nuk ndërgjegjësohen dhe tolerojnë që bordet që emërohen nga vetë Kuvendi të sillen si të duam pa e dëgjuar asnjëherë kërkesat apo zërin e Kuvendit i cili i emëron, andaj abstenoj dhe asnjëherë nuk do të jem pro bordeve, jo që kamë të bëjë me individ, por bordet si të tilla nuk do t'i votoj asnjëherë.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit, i nderuar kryesues, i nderuari ministër, të nderuar deputetë. Unë flas në emër timin personal, por edhe në emër të grupit të LDD duke i parashtruar disa sugjerime parimore.

Natyrisht se përkrahi qëndrimin e bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave, por kam një vërejtje shumë parimore, në biografite e tyre janë disa të dhëna mjaft diskutabile. Në biografinë e një kandidati shkruan: “ anëtari i bordit të pavarur për rishqyrtimin tatimor

viti 2000” Institucione të tilla nuk ka pasur në qytetin e Mitrovicës, shkojmë më tutje. Kandidati i dytë thotë: “anëtari i grupit punues për emërtimin e vendbanimeve” institucion të tillë nuk ka pasur dhe nuk është mirë të figuroj në biografi të seriozitetit që konkurron.

Kandidati i tretë thotë: “anëtar i shoqatës Auto-moto Pejë” të shoqatave të cilat vërtet nuk përshkajnë me vendin të cilin konkurrojnë dhe një vërejtje tjetër mjaft përmbajtjesore thotë se ka qenë konsulent për financa dhe kontabilitet duke mos përcaktuar dhe përcaktuar dhe treguar kohën dhe ku në cilin vend dhe çka është ky konsulent dhe çfarë funksioni dhe e fundit vërejtja që është ndoshta më përmbajtjesorja që në raste të tilla duhet t’i kemi parasysh ku thotë: “Pomoqnik direktora preduzeqe Mehanizacija K. Mitrovica” ju zotohem se në vitin 2004 nuk ka pasur organizatë të tillë në Mitrovicë as në veri dhe as në jug dhe vijmë në lajthitje një Qeveri e tillë me institucione të tilla, prandaj si Qeveri dhe si deputet duhet t’i kemi dëshmitë këtu, a ka ekzistuar, nuk kanë ekzistuar, me gjithë atë ne do të votojmë që këta të emërohen. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI - Deputetja Safete Hadrgjonaj

DEPUTETJA SAFETE HADRGJONAJ – Të nderuar deputetë. Në këto vendime që na i dërgon Qeveria e zakonisht thuhet se Kuvendi i miraton bordet të cilat janë të pavarura dhe në bordin e pavarur për shqyrtim të ankesave ku në fakt ky Kuvend që nga fillimi ka miratuar borde plotësisht të varura nga politika dhe asnjëherë borde të pavarura. Ndërsa edhe kësaj here ky kuvend do ta përdor makinerinë e votimit në favor të këtyre kandidatëve politik dhe shumë pak profesional ashtu siç e kërkon ligji por jo me votën e grupit parlamentar të PDK-së. Ne jemi dëshmitarë se ky bord i ankesave është emëruar me datën 15 shkurt të vitit 2006 nga Kuvendi me një vonesë prej 9 muajsh pas hyrjes në fuqi të ligjit për administratën tatimore dhe procedura.

Së pari këtij Kuvendi i është ofruar një listë nga Qeveria për ta miratuar në muajin qershor të vitit 2005 e cila listë është kthyer nga koalicioni qeverisës për ta pastruar nga profesionalistët me të vetmin kriter për t’i hequr anëtarët të cilët ishin pjesëtarë të subjekteve të tjera politike dhe këtij koalicioni qeverisës i janë edhe 7 muaj të tjerë për ta formuar një listë e cila do të vijë në miratim para Kuvendit. Ky bord që është politik dëshmon edhe fakti sepse kryetari i këtij bordi të pavarur për rishqyrtimin e ankesave është edhe deputet i Parlamentit të Kosovës dhe anëtar i komisionit për Buxhet dhe Financa. Këtyre kandidatëve u ka kaluar mandati me dt. 15 shkurt. Për të qenë anëtarë të bordit dhe ne nuk e dimë nëse puna e këtyre anëtarëve është pezulluar nga ky bord apo ata vazhdojnë punën ende në këtë bord.

Neni 57.2 thotë: “Anëtarët e bordit duhet të propozohen nga Qeveria vetëm mbi bazën e aftësisë së tyre për të funksionuar, për të kryer funksionin në bazë të aftësisë së tyre profesionale, afati për secilin anëtarë do të jetë 2 vjet, gjysma e anëtarëve do të zëvendësohen në fund të çdo viti kalendarik”. Bazuar në vendimin e Qeverisë shihet se gjysma e anëtarëve nuk është zëvendësuar, por është sjell në miratim lista pothuajse e njëjtë, ne nuk kemi informata nëse këta kandidat i kanë kryer punët ashtu siç duhet dhe nuk kemi informata pse nuk është në listë një anëtar, sepse nga kjo listë mungon vetëm

një anëtar, anëtari i këtij bordi është tërhequr vet, nuk ka pranuar të hyjë në listë me vetë dëshirë, apo Qeveria e ka përcaktuar si të papërshtatshëm të plotësoj funksionin e tij apo është në pozitë të konfliktit të interesave.

Deputetët nuk i kanë informatat e nevojshme se si ka funksionuar ky bord sepse nuk ka ekzistua,transparenca.

Unë i ftoj kolegët e mi deputet të mos i votojnë këta kandidat sepse nuk i kanë informatat e duhura nëse këtij bordi i janë adresuar ankesa dhe sa prej këtyre ankesave janë shqyrtuar. Deputetët nuk i kanë informatat sa ankesa ka pranuar ky bord nga tatimpaguesit kundër vendimit të departamentit të ankesave dhe disa informata të tjera të domosdoshme. Ne si komision për buxhet dhe financa sot kemi pranuar një raport që nuk është shqyrtuar ende dhe deputetët tjerë nuk e kanë fatin që ta kenë këtë raport përpara.

Administrata Tatimore e Kosovës nuk ka qenë transparente ndaj Kuvendit siç e obligon ligji, asnjëherë nuk i ka raportuar Kuvendit sipas nenit 8.2 dhe ministri i Financave nuk e ka parë të arsyeshme as pyetjes parlamentare t'i përgjigjet në lidhje me transparencën dhe raportimin nga administrata tatimore e Kosovës.

Çdo ditë në mjetet e informimit nga drejtori i administratës tatimore të Kosovës dëgjojmë se borxhet ndaj administratës tatimore janë diku 160 milion euro, të hyra të cilat nuk realizohen nga administrata tatimore e Kosovës, prandaj të nderuar deputet unë apeloj që kjo listë të mos miratohet pa u shqyrtuar raporti i punës së këtij bordi, për ndryshe nëse aprovojmë lista symbyllurazi do t'i japim legjitimitet territ informativ, do të krijojmë terren të pasurohen individët dhe grupet e caktuara dhe kështu do ta dëmtojmë buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Grupi parlamentar i PDK-së nuk e miraton këtë listë, kërkon transparencë nga administrata tatimore e Kosovës, kërkon nga komisioni për buxhet dhe financa të bëjë monitorimin e ligjit për administratën tatimore dhe procedurat dhe t'i raportoj këtij Kuvendi. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit znj. Hadergjonaj. Dëgjuam mendimet rreth këtij propozimi.

Ftoj regjinë që të bëhet gati për votim.

Në sallë janë 72 deputetë.

Votojmë tash:

Për46

Kundër 24

Konsideroj se me shumicë votash kalon lista

Vazhdojmë me pikën e 8 të rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i rekomandimit për listën e kandidatëve për gjyqtarë.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka shqyrtuar të dhënat shtesë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për emërimin e disa kandidatëve për gjyqtarë dhe Kuvendit i ka paraqit raportin me rekomandime.

Deputetët i kanë këto rekomandime.

Fjalën e kërkon deputeti Sadudin Berisha.

DEPUTETI SADUDIN BERISHA – I nderuari kryesues i Kuvendit, i nderuari ministër, të nderuar kolegë deputet. Lidhur me rekomandimin e komisionit për emërimin e 3 gjyqtarëve ju njoftoj se nuk është fjala për kandidat të rinjë, por ka të bëjë me kandidatë për të cilën Kuvendi në seancën e mbajtur me 6 tetor 2006 ka kërkuar informatë shtesë. Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 8 shtator të vitit 2006 ka shqyrtuar listën prej 22 kandidatëve të propozuar nga këshilli gjyqësor i Kosovës për të emëruar 21 gjyqtarë dhe një prokuror, duke i rekomanduar Kuvendit emërimin e 16 gjyqtarëve dhe një prokurori, kurse për kandidatin Baton Dërguti i rekomanduar për gjyqtarë në Gjykatën komunale të Prizrenit dhe Samire Mushkolaj e rekomanduar për gjyqtare në Gjykatën Komunale në Gjakovë ka konstatuar se u mungon përvoja e punës e paraparë me rregullore në fuqi për derisa kandidatura e Rrahman Aslani i rekomanduar për gjyqtarë në Gjykatën Komunale në Prizren nuk është përkrahur nga Komisioni për shkak të dyshimit të bazuar se nuk e plotëson njërin nga kushtet e parapara të nenit 6 të Rregullores nr. 52 të vitit 2005 të këshillit gjyqësor. Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit që për kandidatin z. Rrahman Aslani të kërkoj informacion shtesë nga këshilli gjyqësor. Gjorgje Aksiq i rekomanduar për gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës nuk është përkrahur për arsye se gjatë luftës në Kosovë në periudhën prej 25 mars 1999 deri me 15 qershor të vitit 99 ka qenë i mobilizuar si zëvendësprokuror ushtarak pranë komandës ushtarake të Qarkut në Prishtinë si dhe në të kaluarën ka marrë pjesë në zbatimin e ligjeve diskriminuese dhe në rrënimin e sistemit juridik në Kosovë.

Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit që për kandidatin Gjorgje Aksiq të kërkoj informacion shtesë nga këshilli gjyqësor lidhur me të kaluarën e tij.

Kandidati Vasilje Aksiq i rekomanduar për gjyqtarë në gjykatën komunale në Gjilan nuk është përkrahur nga komisioni për shkak të dyshimit të bazuar e duke u mbështetur në aplikacionin e kandidatit nga se edhe pas vendosjes së administratës ndërkombëtare në Kosovë dhe formimit të institucioneve të Kosovës ai ka vazhduar të punoj në strukturat e ish ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, Sekretariatit të Punëve të Brendshme në Gjilan. Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit që për kandidatin Aksiq të kërkojë informacion shtesë nga këshilli gjyqësor lidhur me të kaluarën si dhe angazhimin e tij aktual.

Kuvendi në seancën e mbajtur me 6 tetor të vitit 2006 ka shqyrtuar dhe miratuar rekomandimet e Komisionit Legjislativ.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës pas kërkesës së Kuvendit për informacione shtesë ka rishqyrtuar kandidaturën dhe ka propozuar që kandidati Baton Dërguti të emërohet gjyqtar në Gjykatën Komunale të Prizrenit, Rrahman Asllani gjyqtar në Gjykatën Komunale Prizren dhe Vasilje Aksiq për gjyqtar në Gjykatën Komunale në Gjilan.

Arsyetimi për kandidaturat e propozuara është dhënë nga këshilli gjyqësor i Kosovës dhe u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit me datën 20 shkurt të vitit 2007. Në arsyetimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës thuhet se për kandidatin Baton Dërguti për të cilin është dyshuar se nuk ka përvojë pune profesionale është vërtetuar se i ka 4 vite përvojë pune profesionale dhe i plotëson kushtet për t'u emëruar gjyqtar.

Kandidati Rrahman Asllani, i dyshuar se ka paraqitur dokumente të falsifikuara në mbështetje të kërkesës së tij, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka verifikuar biografinë e tij dhe ka konstatuar se të gjitha dokumentet e paraqitura janë të sakta dhe se i plotëson kushtet për t'u emëruar gjyqtar.

Kandidati Vasilje Arsiq, kandidaturën e të cilit nuk e ka miratuar Kuvendi për arsye se është anëtar i strukturave paralele të MPB të Serbisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës pas shqyrtimit të mëtejme ka vërtetuar se kandidati e ka paraqitur këtë informatë në kërkesën e tij, por nëse emërohet si gjyqtar ai do ta jap betimin për t'i përmbushur detyrat si gjyqtar në Kosovë dhe për të zbatuar ligjet në fuqi të Kosovës.

Kandidati Gjorgje Aksiq, kandidaturën e të cilit nuk e ka miratuar Kuvendi për arsye se gjatë periudhës mars – qershor të vitit 1999 ka punuar si zëvendësprokuror ushtarak, Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk e ka përfunduar hetimin lidhur me të kaluarën e tij dhe pas përfundimit të hetimit të mëtejshëm të biografisë do të vendosë se a do të rekomandohet për t'u emëruar gjyqtar.

Kandidatja Samile Mushkolaj, kandidaturën e së cilës nuk e ka miratuar Kuvendi për arsye se i mungon përvoja profesionale edhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka konstatuar se i mungon përvoja profesionale dhe ka tërhequr rekomandimin për të emëruar gjyqtare.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur me 19 shkurt të vitit 2007 shqyrtoi informatat shtesë të dhëna nga përfaqësuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me propozimin për emërimin e 3 gjyqtarëve dhe i rekomandon Kuvendit të Kosovës që ta shqyrtoj dhe miratoj listën e kandidatëve të propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për emërimin e gjyqtarëve si vijon:

Baton Dërguti, për gjyqtar në Gjykatën Komunale Prizren,
Ramadan Asllani për gjyqtar në Gjykatën Komunale Prizren, dhe
Vasilje Arsiq për gjyqtar të Gjykatës Komunale në Gjilan.
Ju falemoidnerit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit. Këtu është i paraqitur deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryesues, unë në këtë rast e mora fjalën edhe si anëtar i këtij Komisioni ku në komision e kamë ndarë mendimin tim dhe kamë votuar kundër kandidaturës së këtyre kandidatëve, gjegjësisht gjyqtarëve për ta ushtruar funksionin mëtutje, gjegjësisht për t'i emëruar nga fakti se nuk i plotësojnë kriteret e parapara:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës në rastet konkrete, propozimet e propozuara për zgjedhjet e gjyqtarëve në të gjithëve anëtarëve të Komisionit, por edhe deputetëve po na vënë në pozita të vështira dhe të palakuara dhe në lajthime të plota juridike, nga fakti se nuk e kemi biografinë e plotësuar për të cilat foli në mënyrë detaje.

2. Nuk e kemi përvojën profesionale për ta ushtruar funksionin e gjyqtarit në biografinë e tyre dhe në dokumentacion sikurse edhe në rastin paraprak.

3. Nuk i kemi vërtetimet e vërteta, vërtetimet fiktive të punës që kanë kryer, sepse po e keqpërdorim mundësinë dhe

4. Propozimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës duhet të ishte i arsyeshëm dhe të kishte arsyetime me shkrim dhe të nënshkruar për secilin rast konkret dhe vetë arsyetimi i tyre është në kundërshtim me propozimin, unë do t'i lexoj vetëm dy raste dhe secili le të voton ashtu si do vet.

Rasti i parë është te Vasilije Arsiq, thotë se ka qenë pjesëtar i strukturave paralele në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe nëse e zgjedhim do ta japë betimin se do të bëhet burrë i mirë, unë po e them këtë që është mendim imi, nuk është me rëndësi se a do të bëhet ky burrë i mirë apo jo, por Këshilli Gjyqësor i Kosovës lejon rekomandimin nga Përfaqësuesi Special që të emërohet dhe këtë nuk e ka të drejtë sepse dokumentacioni i tij tregon qartë se është pjesëtar i strukturave paralele në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë dhe në rastin e dytë se vërtetë ai nuk e ka përvojën e duhur dhe neve nuk na ka argumentuar se ka përvojën, ndoshta në administratë gjendet, në Komision nuk ka qenë. Bazuar në këto fakte unë i kisha lutur të gjithë deputetët që vërtet secili me ndërgjegjen e vetë, por mos të votojmë asnjërin sepse edhe kështu – ashtu sistemi gjyqësor jo vetëm që po çalon, por është ngarkuar me gjyqtar që kanë respektuar dhe po respektojnë paligjshmërinë. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Kelmendi. Fjalën e kërkon z. Berat Luzha.

DEPUTETI BERAT LUZHA – Të nderuar kolegë deputetë. Këshilli Gjyqësor i Kosovës që nga mbledhja e 6 tetorit të Kuvendit të Kosovës, kur janë refuzuar këta kandidat nuk ka sjellë të dhëna shtesë për asnjërin prej tyre, d.m.th e ka përsëritur kërkesën e tyre që Kuvendi t'i miratojë kandidaturat e tyre. Unë çuditë se ky këshill gjyqësor sjell njerëz të tillë sikur ishte rasti i Gjorgje Aksiqit që ishte prokuror ushtarak gjatë luftës dhe të Vasilije Arsiqit, i cili ka punuar në strukturat paralele të Serbisë, konkretisht të MUP të Serbisë pas luftës në Kosovë dhe tash siç tha edhe kolegu po u bëka burrë i mirë nëse jep një betim formal para se të bëhet gjyqtar. Unë mendoj se këso rekomandime as të komisionit të Kuvendit dhe as të Këshillit Gjyqësor nuk duhet t'i marrë parasysh Kuvendi dhe duhet t'i refuzoj për shkak se janë vërtet shumë të dëmshëm dhe Kuvendi nuk duhet të bijë në ato pozita sa t'i avancoj nëpër funksione njerëzit e tillë.

Nëse PSSP-ja do t'i emëroj ata me çdo kusht atëherë le t'i emëroj pa miratimin e Kuvendit dhe jo me miratimin e Kuvendit, do të ishte skandalozë që ne t'i japim leje dhe ta miratojmë emrin e Vasilje Arsiqit. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. Luzha. Fjalën e ka z. Alush Gashi shef i Grupit Parlamentar të LDK-së.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Faleminderit z. kryesues. Grupi Parlamentar i LDK-së me shumë kujdes e ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit funksional, kryetar i të cilit është z. Hydajet Hyseni nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, ndërsa nënkryetari është nga radhët tona. Ne i kemi marrë parasysh arsyet e këtij rekomandimi dhe si grup parlamentar ne do ta votojmë rekomandimin e dhënë. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Gashi, unë nuk shoh që ka interesim dikush tjetër të jap komente ose të flas rreth kësaj liste.

Deputet të nderuar ne e kemi një rekomandim që e ka bërë Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese. Ju dëgjuat edhe komente rreth kësaj, mua tjetër nuk më mbetet pos ta hedh në votim këtë listë, vetëm po ju lus nëse ju kërkoni që të votohet një për një, mund ta bëjmë edhe atë ose listën e plotë të Komisionit.

Në seancë janë 77 deputetë. E lus regjinë që të bëhet gati për votim.

Votojmë tash për listën e komisionit.

Për32

Kundër36

Lista nuk votohet.

Kalojmë në pikën e 9 të rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i Propozim programit të punës së Kuvendit për vitin 2007, si dhe të kalendarit vjetor.

Ka një agjendë legjislative si dhe një skemë të mbledhjeve të Kryesisë, të Komisioneve parlamentare, të seancave plenare dhe të Kryesisë me komisionet, kryetarët e grupeve parlamentare. Unë nuk dua t’ju jap hyrje të veçantë rreth kësaj, unë besoj që është mirë që Kuvendi ta aprovoj një agjendë legjislative në seancë plenare, nuk e kemi bërë gjithherë këtë, por është koha që të jemi më sistematik, unë e hap diskutimin rreth kësaj pike.

Kush e do fjalën.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI - Faleminderit shumë. Është për t’u mirëpritur programi i punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2007. Mendoj se ka nevojë për disa plotësime që ne i kemi vërejtur.

Në numrin 63 të Programit parashihet projektligji për simbolet shtetërore. Ky projektligj si dhe vetë këto simbole transitorë janë produkt i kohës dhe ato do të ndodhin, Në program nuk është paraparë, në programin e këtij viti Projektligji për përdorimin e simboleve kombëtare dhe të pakicave. Për mendimin tonë, agjenda dhe procedura lidhur me këtë projektligj duhet të harmonizohet me agjendën për përdorimin e simboleve kombëtare, për më tepër Projektligji për përdorimin e simboleve kombëtare duhet të jetë në agjendë para apo së paku paralelisht me Projektligjin për simbolet shtetërore, pse.

Këtë propozim që po e bëj kishte me i shmang frustrimet te shumica shqiptare, por edhe te pakicat, konfrontimet e panevojshme të qytetarëve të rrymave të ndryshme politike në mes veti dhe në anën tjetër të qytetarëve me IPVQ-të, me forcat e rendit, përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare dhe kështu me radhë. Besoj se idea çka dua të them është e qartë dhe asnjë nga ne nuk dëshirojmë të kemi skena dramatike çfarë jemi mësuar t'i shohim.

Tash do të flas për një projektligj tjetër. Në programin e Kuvendit duhet përfshirë edhe Ligji për emigracionin e Kosovës jashtë vendit. Mendoj që jo vetëm që ishte vullnet i Kuvendit të Kosovës, por kur u debatua për emigracionin pak më parë në Kuvend kishte garë në mes grupeve parlamentare dhe deputetëve për të kritikuar Qeverinë për vonim të këtij projektligji për rregullimin e statusit të emigracionit me ligj. Andaj ju lutem që ky projektligj të përfshihet në këtë program, është për t'u habitur, u dhanë zotime të mëdha, ishin qeveritarët, ky program nëse është hartuar prej Kuvendit që e ka shumicën është për t'u habitur se si nuk është këtu prezent. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. Xhemajli, fjalën e ka Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Faleminderit z. kryesuese. Ne si grup parlamentar e mbështesim programin për vitin 2007, është program i cili na ofrohet sot pas konsultimit me Qeverinë e Kosovës, me komisionet parlamentare të Kuvendit tonë, me Kryesinë dhe me grupet parlamentare dhe mendoj se kësaj duhet t'i jepet mbështetje në parim dhe ne si grup mbështesim Kryesinë e Kuvendit që t'i shikojë mundësitë e rritjes së kapaciteteve për përsheptim të procedurave për miratim të tërë këtij regjistri ligjesh të domosdoshme, qoftë me mbështetje financiare për rritje të orëve të punës për të punësuarit aktualë, qoftë përmes kontaktimit apo punësimit nga distanca e ekspertëve vendorë në veçanti për lekturën e këtyre teksteve, në mënyrë që këto tekste të jenë të kohës. Po ashtu i mbështesim institucionet e Kuvendit, respektivisht Kryesinë dhe administratën që në rast të nevojës së shtimit të numrit të përkthyesve nga gjuhët e ndryshme që kjo të bëhet sa më parë që lidhur me këtë çështje të mos humbim kohë. Natyrisht shprehim gatishmërinë tonë që për realizim të këtij programi ne nëse e do nevoja të punojmë edhe gjatë vikendeve. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Gashi, fjalën e ka Gjylnaze Sylja.

DEPUTETEJA GJYLNAZE SYLA - I nderuari z. kryesues, të nderuar deputetë. Grupi Parlamentar i Aleancës e ka mirëpritur këtë program, sepse është një bazë e mirë për funksionimin më të mirë dhe më efikas të punës së Kuvendit dhe të trupave të Kuvendit. Duke marrë parasysh përvojën e sotme që patëm në mëngjes lidhur me agjendën, unë kisha dashur ta tërheq vërejtjen që në të ardhmen e kemi një agjendë prej 106 ligjeve brenda vitit 2007, shumica janë të leximit të parë, vetëm disa prej tyre në leximin e dytë, kurse plus është aneksi, ligjet prej vitit 2006 që janë 26 ligje për shqyrtim të dytë. Duke e marrë parasysh këtë agjendë mendoj që puna e Kuvendit duhet me qenë më efikase dhe më racionale që të mos shpenzojmë një orë. Por me qenë efikasë dhe konform Rregullores që e kemi, hartimi i agjendës të bëhet me një praktikë tjetër e cila do të shkurtonte dhe do ta shfrytëzonim në mënyrë më të mirë kohën. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit znj. Gjylnaze. Fjalën e ka kërkuar Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryesues, të nderuar deputetë të çmuar.

Grupi Parlamentar i LDD-së e ka shqyrtuar këtë program pune për vitin 2007 dhe ka vendosur ta përkrahë në parim. I kemi disa vërejtje se duhet krijuar prioritetin e tyre duke ditur se sistemi gjyqësor në Kosovë në periudhën e kaluar është ballafaquar me shumë probleme, andaj ligjeve të kësaj fushe duhet dhënë prioritet si p.sh ligjit për gjykata, Ligjit për prokurim publik, Ligjit për procedurën kontestimore, Ligjit për procedurën jashtë- kontestimore etj, në veçanti Ligjit për kufijtë, sepse kemi konteste në Veriun e Kosovës, në atë të Vitisë, në anën e Pejës, Ligjin për kufijtë kadastralë, komunalë etj. Pastaj Ligji për nxitjen e punësimit dhe të ndihmës së punëkërkuesve, numri i të cilëve rritet dita më ditë.

Projektligji për pensionimin dhe për sigurimin pensional, Projektligji për simbolet e shtetit etj. Në veçanti kërkoj që vërtet në këtë program pune të përfshihen Ligji për pronën, që nuk është përfshirë fare, Ligji për migrimin që nuk është përfshirë fare, Ligji për shpalljen e personave të zhdukur. E dinë vetëm familjarët cilat janë pasojat për familjarët, Ligji për dyshtetësinë dhe Ligji për refugjatët. Mendoj se këto 7 propozim-ligje të reja duhet të inkorporohen në këtë program pune për këtë vit. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit. Fjalën e ka Nurishahe Hulaj

DEPUTETJA NURISHAHE HULAJ – I nderuari kryesues i Kuvendit të Kosovës, të nderuar ministra dhe deputetë të respektuar.

Para nesh kemi marrë një program për punën e Kuvendit dhe kalendarin vjetor të Kuvendit të Kosovës i ilustruar mirë dhe me kontura të qarta dhe me prioritete. Legjislatura kryen një numër të funksioneve të rëndësishme në demokraci, ato aprovohen që të funksionojnë të vihen në jetë dhe të administrohen në mënyrë efektive dhe ekonomike për të plotësuar kërkesat dhe nevojat e të gjithë qytetarëve për një mirëqenie më të mirë. Ne e mbështesim në parim këtë program, por kisha me i dhënë disa komente lidhur me Programin e Kuvendit të Kosovës.

Programi i punës i Kuvendit të Kosovës paraqet rritje të dinamikës së ligjvënies gjatë vitit 2007 duke respektuar afatin kohor në mes të shqyrtimit të parë dhe të dytë në Kuvendin e Kosovës, por pa u cekur afati përfundimtar i nënshkrimit dhe i shpalljes së ligjit si të zbatueshëm. E themi këtë sepse bazohemi në analizën e ligjvënies gjatë periudhës kohore 2002 deri 2006 në bazë të listës së ligjeve që kanë kaluar në shqyrtim të parë, të dytë, nënshkrimit respektivisht shpalljes nga ana e PSSP-së. Analiza ka rezultuar se është bërë vonësë kohore në mes të shqyrtimit të dytë në Kuvend dhe shpalljes së ligjeve për të qenë të zbatueshme, prandaj konsideroj se programit të punës së Kuvendit për vitin 2007 duhet t'i bashkëngjitet edhe programi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve që e bëjnë komisionet parlamentare të fushave përkatëse duke bërë në të njëjtën kohë edhe

raportimin e shkallës së zbatimit të ligjeve dhe të akteve ligjore e nënligjore. Ligjvënja dhe zbatimi i ligjeve duhet të jenë në korrelacion në mes veti, sepse vetëm me këtë punë programore mund të maten aktiviteti ligjvënës dhe zbatimi e tyre në Kosovë. Sigurisht se kjo dinamikë kërkon edhe programin financiar për ligjvënien, prandaj ne konsiderojmë se të gjitha këto do të plotësohen dhe do ta kemi një dinamikë të shtuar edhe në zbatimin e ligjeve në Kosovë. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit znj. deputete. Fjalën e ka deputeti Kamber Kamberi.

DEPUTETI KAMBER KAMBERI - Në programin e punës të Kuvendit të Kosovës janë një varg projektligjesh që presin për ndryshim dhe plotësim. E kam fjalën për Projektligjin për arsimin fillor dhe të mesëm, meqenëse ky Projektligj është miratuar në Kuvend në vitin 2002 me disa nene ka shkaktuar konfuzitet dhe ka krijuar efekte negative, prandaj kisha kërkuar që ato projektligje që janë edhe në leximin e parë edhe ato që presin për plotësim dhe ndryshim, disave prej këtyre t'u jepet prioritet dhe sa të jetë e mundur mundshme të avancohen. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e ka Ibush Jonuzi.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Faleminderit i nderuari kryesues, të respektuar deputetë. Është mirë që sot para vetes e kemi programin apo planin e punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2007. Pra tani është një pasqyrë e qartë për të gjithë ne se çka është paraparë të punohet për këtë vit kalendarik. Do të isha ndalur shkurt në ato pjesë të planit në ato fusha që i mbulon Komisioni parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Miniera, Transport dhe Telekomunikacion. Në këtë ministri është planifikuar të hartohen 10 projektligje që sigurisht gjatë punës do të paraqitet nevojë edhe për ndonjë ligj të miratuar më herët për plotësime dhe ndryshime. Edhe kjo është në rregull.

Një gjë që nuk është në rregull se deri në muajin prill nuk planifikohet apo nuk parashihet nga ministrinë përkatëse t'i dorëzohen Kuvendit Projektligjet e planifikuara, prandaj për Komisionin është një planifikim jo i mirë, me gjithë atë unë në emër të komisionit ju kisha bërë thirrje ministrive të lartpërmendura edhe pse është planifikuar të startohet tek në muajin maj të mos ketë vonesa të tjera sepse pastaj për komisionin nuk do të ketë kohë të mjaftueshme për realizim të planit të paraparë. Në parim e përkrah këtë plan të punës së Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. deputet. Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Faleminderit z. kryetar. Mendoj se edhe krahu i djathtë i parlamentit e mbështesim këtë plan pune dhe mendoj që duhet të kihet parasysh që pas ndryshimit të statusit mund të dalin kërkesa të reja, për ligje të reja, mos t'i miratojmë kështu dhe të shkohet që në mënyrë absolute të zbatohet ai plan që është propozuar, të merren parasysh edhe propozimet që u bën sot për ligje që janë të nevojshme në Kosovë dhe zhvillimet e reja ekonomike, politike, sociale etj, sigurisht që do të kërkojnë edhe

ligje të tjera ndërkohë që mund të dalin. Mendoj që ky Kuvend duhet të ketë parasysh që ta zgjeroj edhe hapësirën demokratike për debat dhe jo të kundërtën siç po kërkohet nga dikush shpesh, sepse hapësira demokratike nuk e dëmton punën e Kuvendit, përkundrazi e begaton edhe e thellon punën e Kuvendit dhe kualitetin e punës së Kuvendit. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit deputetit Bislimi. E ka kërkuar fjalën deputeti Agim Krasniqi.

DEPUTETI AGIM KRASNIQI – Faleminderit z. kryesues. Ky plan i punës së Kuvendit për vitin 2007 është vërtet ambicioz, kërkon përkrahjen, por më tepër kërkon punë për t'u realizuar sepse ka shumë projektligje dhe ligje të tjera që do të vijnë, plus ndryshime në ligjet e miratuara më herët. Unë desha ta përmend vetëm një projektligj që është në numrin rendor 81. fjala është për Projektligjin për Shërbimet e Sigurisë Private.

Ky emërtim nuk është adekuat, nuk është i drejtë, do të duhej të jetë Projektligji për Kompanitë Private të Sigurisë dhe vërejtjet tjera që i kamë rreth kësaj. Komisioni për Siguri i Kuvendit të Kosovës ka formuar grupin punues apo nën komisionin për hartimin e këtij Projektligji dhe në krye të këtij grupi punues jam unë dhe kemi filluar punën rreth përgatitjes për këtë Projektligj, kështu që nuk është në rregull që sponsore duhet të jetë Ministria e Punëve të Brendshme, propozues Qeveria e Kosovës, por sponsor edhe hartues i Projektligjit do të duhej të mbetet Komisioni për Siguri i Parlamentit të Kosovës dhe këto afate kohore që janë parapa me siguri që janë të vona deri sa këtu përmendet shqyrtimi i dytë 10 dhjetor 2007, kështu që unë dëshiroj që brenda pak muajve ligji do të hartohet dhe të aprovohet. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. deputet. Fjalën e kërkon deputetja Selviqe Halimi.

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – Faleminderit z. kryesues.

Duke u nisur nga fakti se hartimi i këtij programi nga ana e Sekretarisë së Kuvendit bazohet në dokumentin e Qeverisë për strategjinë legjislativë për vitin 2007. Unë mendoj se Qeveria ka harruar t'i shfletoj ligjet e veta të aprovuara dhe të shoh se ekzistojnë një varg strategjish të cilat duhet të hartohen nga Qeveria dhe të aprovohen nga Kuvendi dhe ashtu ka strategji të cilat është dashur të fillohen dhe kanë pasur bazë ligjore që të fillohen dhe të sillen në Kuvend para 4 viteve e këndeje dhe mendoj se duhet të shikohen ligjet dhe të futen edhe strategjitë të cilat disa janë në përfundim e sipër, disa që duhet të fillohet të hartohen dhe të hyjnë në këtë program të punës për vitin 2007 siç është rasti edhe me strategjinë për ujëra, administrimit të ujërave, strategjinë nacionale të zhvillimit të Kosovës e mos t'i përmendi të gjitha me radhë.

Mendoj se Qeveria duhet të ketë parasysh nxjerrjen e ligjit për kualitetin e ujit të pijshëm duke pasur për bazë faktin se po thuaj se çdo vit në të gjitha pjesët e Kosovës, urbane dhe ato rurale kemi endemi që shkaktohen nga uji jo kualitativ, i cili nuk i plotëson standardet. Mendoj se këto kërkesa duhet t'i ketë parasysh Qeveria dhe të hyjnë në programin e vitit 2007 nga ana e Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit znj. deputete. Fjalën e ka Xhezair Murati.

POSLANIK DŽEZAIR MURATI – Poštovani predsedniče, pred nama je čitava jedna ogromna masa zakona, kako u prvom tako i nasledenih koji su usvojeni u prvom čitanju a preстоji i druga čitanja. Svakako da među njima ima prioriteta i trebamo da vodimo računa da napravimo jedan hronološki raspored zakona kakvi su prema političkoj situaciji, statusa u kojim se nalazimo, kako bih pospešili taj proces. Ja bih ovde ponovio da se vodi računa izradih novih nacрта zakona kada se radne grupe formiraju. Imamo ponude od nezavisnog sindikata, penzionera, ima stručnjake koji su neraspoređenih a često..... mi podržavamo ovaj spisak rada, ali uz određivanje prioriteta jedne hronologije koja će biti ekološkično rešenje njihovog usvajanja. Hvala!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Murati. Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Faleminderit z. kryesues. Unë po e shoh para vetes një numër të madh ligjesh që ka planifikuar Kuvendi i Kosovës që t'i shqyrtoj dhe t'i miratoj gjatë vitit 2007, mirëpo nuk po shoh askund se çka do të ndodh me ligjet që janë miratuar para 3 vjetëve e nuk i ka nënshkruar përfaqësuesi special. Ndoshta do të duhej ky program të plotësohej edhe me ato ligje sepse koha e UNMIK-ut po afrohet për të përfunduar dhe nëse ato ligje mbesin si të tilla të panënshkruara çka do të ndodh me to. Ky program i punës i Kuvendit të Kosovës i parasheh shumë ligje, por nuk e sheh ligjin më të lartë, aktin më të lartë të Kosovës, hartimin e Kushtetutës së Kosovës, të gjitha këto ligje që këtu thotë sipas pakos së Ahtisarit duhet të bazohen në Kushtetutën e Kosovës, prandaj duhet të parashikohet diku edhe hartimi i projektkushtetutës së Kosovës.

KRYESUESI SABRI HAMIMTI – Faleminderit znj. Nekibe. Fjalën e ka Fatmire Mulhaxha Kollçaku.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA – KOLLÇAKU – Faleminderit z. kryesues. Ju bashkëngjitem edhe unë disa vërejtjeve që i dëgjuam deri tani, por dua ta veçoj vetëm një. Me qenë se siç u cek ky dokument është i bazuar edhe në dokumentin e Qeverisë për strategjinë legjislative për vitin 2007, më habit fakti si nuk është parapa edhe Projektligji për sigurimin pensional dhe invalidor, me qenë se nga të gjitha takimet me pensionist që i kemi pasur e kanë cekur që kryeministri ju ka premtuar që ai ligj do të procedohet shumë shpejt dhe jo vetëm që nuk është në strategjinë legjislative të Qeverisë, por as në Program të Kuvendit, prandaj është mirë nganjëherë premtime të kota mos me dhënë. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit. Fjalën e ka Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Faleminderit z. kryesues. Parafolësja e tha atë që e pata ndërmend të theksoj. Me të vërtetë është shumë e çuditshme se si Qeveria në Strategjinë e saj legjislative nuk e ka parapa Projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor dhe

nuk e ka parapa ligjin për qytetarët e Kosovës në mërgatë edhe pse kanë qenë tema të veçanta në debate në këtë Kuvend dhe në fund përfundime shumë të qarta në këtë aspekt. Unë mendoj se para nesh e kemi një program shumë ambicioz i cili në resurset e tashme profesionale brenda Kuvendit të Kosovës të cilat me të drejtë i potencoi prof. Gashi, pa fuqizimin e stafit të bashkëpunëtorëve profesional gjatë përpunimit të ligjeve do të jetë shumë e vështirë që ky program të përmbushet.

Në radhë të parë duke e përmirësuar edhe bashkëpunimin ndërmjet ministrive konkrete, ekzekutivit dhe grupeve parlamentare qysh në fazën e përgatitjeve të ligjeve para se të vijjnë në Kuvend fare. Me këtë rast e kisha potencuar edhe një fakt se me rastin e hartimit të këtij programi të punës nuk po shoh se janë marrë parasysh edhe rekomandimet e komisionit hetimor lidhur me të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës i cili i ka parapa nxjerrjen e një sërë aktesh konkrete juridike të cilat do të ndihmojnë funksionalizimin më të mirë të Kuvendit të Kosovës dhe parandalimin e paraqitjes së dukurive të cilat i kemi konstatuar në të kaluarën. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI- Ju faleminderit z. Agani. Fjalën e ka Berat Luzha.

DEPUTETI BERAT LUZHA – Z. kryesues me që po flasim për planin e punës së Kuvendit për këtë vit që për mua është një fontin dëshirash për shkak se ka dy vite e më tepër që nuk janë miratuar 100 ligje dhe jo të miratohen për 9 muaj. Mirëpo, unë mendoj se duhet të futet në planin e punës së Kuvendit raportim i bordeve të pavarura, për të cilat folëm pak më parë, të cilat nuk i raportojnë asnjëherë Kuvendit dhe sipas ligjit janë të detyruara t'i raportojnë dhe janë të detyruara që të përgjigjen para Kuvendit, jo domosdo duhet të hyjë në planin e punës së Kuvendit. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI- Me që nuk ka të tjerë të paraqitur për këtë pikë të rendit të ditës, kolegë të nderuar më lejoni që unë më tepër si plotësim t'i them dy tri fjalë. Programi i Punës i Kuvendit të Kosovës për vitin 2007. Titulli është tepër gjithëpërfshirës dhe prandaj vetë titulli shumë nga diskutuesit i shtyrë në mendim që është plan i plotë, në të vërtetë ky do të duhej të quhej, Programi i punës legislative, sepse këtu nuk ka asgjë më tepër se sa evidentim të ligjeve të cilat i ka propozuar Qeveria që të kalojnë në Kuvend dhe të aprovohen brenda këtij viti, pra kemi të bëjmë vetëm me programin legjislativ.

Ajo që u diskutua këtu secili ka të drejtë çka kërkon sepse nuk është paraparë fusha e kontrollit të bordeve dhe të Qeverisë që e përmendi Luzha d.m.th krejt puna e kontrollit të ekzekutiv dhe të organeve që i ka zgjedhur ky Kuvend nuk është në këtë program, nuk është puna e hartimit të strategjive të fushave të ndryshme, një fushë të problemeve tjera, me një fjalë ky është vetëm programi legjislativ i Kuvendit dhe unë mendoj që dikush e tha fontin dëshirash, dikush programim i planifikuar. Ne do të ishim fantastik nëse ne arrijmë që t'i kalojmë të gjitha këto ligje, por ne nuk e dimë si do të punojmë, me gjithë atë ne duhet të mendojmë që do të nxjerrim edhe më shumë se këtu dhe jam i bindur që nëse lëvizjet rreth statusit shkojnë sipas parashikimeve tona ose që kemi qef ne, me siguri se do të bëjmë një dinamik tjetër të punës së Kuvendit sepse java si ka dy dit, por i ka 7 dhe ky Kuvend mund të punoj 7 ditë, kjo mvaret si do ta dinamizojmë ne punën. Unë do

t'ju lutësja me që në princip ju e përkrahët këtë program legjislativ me plotësimet nga fushat tjera të punës së Kuvendit që ta votojmë formalisht që ta kemi të votuar në Kuvend.

Unë e lus regjinë që të përgatitet.
Votojmë tani:

Për58
Kundër.....6

Aprovohet programi legjislativ.
Kalohet në pikën e fundit të rendit të ditës.

10. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Qeverisë për emërtimin e 2 anëtarëve të Bordit Drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

Kjo është një pikë e rendit të ditës për të cilën kemi biseduar edhe në një seancë tjetër, unë nuk kam çfarë të shtoj të veçantë rreth kësaj, janë dy kandidat që i ka propozuar Qeveria për të hyrë në bordin drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës. Na është thënë dhe besoj që nuk na është thënë pa arsye që ne duhet ta kryejmë këtë zgjedhje për shkak se nuk është mirë që për neglizhenca tona të emërohen nga përfaqësuesi special njerëz për vende që janë të destinuara për ekspertët vendas, janë dy ekspert të propozuar nga Qeveria, nga fusha e financave. Nëse nuk ka kush kundër unë e hedh në votim listën. Fjalën e ka Xhevat Bislimi

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Nëse e kamë kuptuar drejt fjala është për propozimin e dy anëtarëve për këshillin e Bankës Qendrore. Unë kam vërejtjet e mia edhe për Isa Mustafën, e para ky njeri ka qenë një kohë përgjegjës për fondin dikur që quhej i Republikës edhe ka qenë në këshillin e Bankës Dardania dhe nuk dimë që ka dhënë shpjegime për qytetarët e Kosovës dhe veçmas për mërgimtarët tanë që kanë lënë djersën dhe paranë e tyre në ato fonde se çfarë ka ndodhur me menaxhimin e atyre parave, ku kanë përfunduar ato para, si janë shpenzuar, kush i ka shpenzuar etj.

Pastaj Banka Dardania sipas meje ka qenë e përfshirë në aferat e piramidave në Tiranë etj, më duket ka qenë edhe Naseri aty, pastaj edhe Afrimi më duket është shkarkuar nga puna për do konflikte interesash etj, por si të gjitha bordet tjera, si të gjitha agjentit tjera si duket këtu te ne çdo gjë po shkon sipas aspektit partiak edhe nuk është mirë që ndodh kështu, prandaj unë në këtë kuptim i kundërshtoj që të dy kandidaturat dhe besoj se kanë edhe të tjerët se çka me thanë, kush të dojë le t'i miratoj siç janë miratuar edhe tjerat, por nuk besoj se e ndihmojnë autoritetin qendror bankar këto dy kandidatura. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI- Unë nuk dua të komentoj askënd, por nuk është e ndershme të flitet për njerëz më duket, kam një ndoshta, ju lutem shumë, këtu jemi në Parlament nuk është mirë kam ndie s'kam ndie.

E hedh në votim listën, regjia përgatituni për votim.

Votojmë tash:

Për38

Kundër26

Abstenim.....4

Me shumicë votash kalojnë.

E mbyll këtë seancë.Mirupafshim në seancat e tjera.